

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 92-të i botimit
Qershor-korrik 2024 / Nr. 4

ARSIMIMI,
ARMA MË E
FUQISHME
PËR TË
NDËRTUAR
BOTËN



DREJTOR I QKMBMMFA
ARBEN SKËNDERAJ

**Shefe e Sektorit të Botimeve &
Kryeredaktore**
ANJEZA MUSOLLARI

GRAPHIC DESIGNER
AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE
SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI
PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI
PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
DR. ASLLAN ZEMANI
GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ
KOLONEL ARBEN DHULI, IKSHU
KAPITEN (P) VERI TALUSHILLARI

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 92-të i botimit
Qershor-korrik 2024 / Nr. 4

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të
riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa marrë
autorizim nga botuesit e saj.

Botues:


Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Mbrojtja

- Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Sot, Ju jeni gardianë të sovranitetit dhe integritetit të Atdheut 4
- Miratohet rritja e pagave për ushtarakët, ministri Peleshi: Jemi duke kaluar vendet e rajonit 6
- Ministri Peleshi: Viojmë mbështetjen politike dhe ushtarake ndaj Ukrainës 8
- Ministri Peleshi dhe ministri i Mbrojtjes i Sllovenisë Marjan Šarec, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit në rastet e katastrofave natyrore 9
- Ministri Peleshi: Brenda 2030, Shqipëria me produkte "Made in Albania" në tregun ndërkombëtar 10
- Ministri i Mbrojtjes Peleshi takohet me ndihmësekretaren për Politikën e Mbrojtjes dhe të Jashtme në DASH, znj. Jessica Lewis 11
- Peleshi: Shqipëria së shpejti do të ketë vendin e saj në industrinë ushtarake të Aleancës 12
- "Përpjekja e Përbashkët 2024", ministri Peleshi: Një test real i planeve kombëtare në mbështetje të NATO-s 14
- Nënshkruhet dokumenti për Lëvizshmërinë Ushtarake përgjatë korridorit VIII 15
- SHSHPPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Turqisë, gjeneral Metin Gürak 16
- Shefi i SHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji priti gjeneral brigade Jeton Dreshaj, komandant i KDS në FS së Kosovës 17
- Shqipëria mirëpret Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHOD's) 18
- Helikopterët "Black Hawk" fluturojnë për herë të parë me pilotë shqiptarë 21
- QPR, 17 vite mobilizim, përkushtim, bashkëpunim 23
- Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, pjesë e takimit të zëvendëseshfave të SEDM-it, të zhvilluar në Stamboll 26
- ZVSHSHPPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu zhvilloi vizitë zyrtare në Pentagon të Shteteve të Bashkuara të Amerikës 27
- Përballja me zjarret, Peleshi: Mirënjohje për përkushtimin e paçmuar të çdo efektivit të Forcave të Armatosura 28
- Qendra shëndetësore ROL-1 e BKL-së përfundon me sukses stërvitjen vetëvlerësuese "MEDEVAL" 30
- Në Distriktin Detar Jugor u zhvillua konferenca përfundimtare planëzuese për stërvitjen "GrupEx-24" dhe për stërvitjen "Imponimi-24" 32
- Baza Ajrore e Gjadrit, 5 vite histori suksesi 35
- Certifkohet personeli për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të radarit TPS 77 36
- Zhvillohet konferenca shkencore "Sfidat e Arsimit të Lartë në një mjedis që ndryshon" 39
- Diplomohen kursantët e KKSHP dhe KLO 40
- Atashetë Ushtarakë të akredituar në vendin tonë, zhvilluan vizitë njohëse në Komandën Mbështetëse 41
- "ZONA GRI" - Hapësira mes paqes së brishtë dhe luftës së mundshme 46
- Dezinformimi, tortë e helmatisur ndaj interesave Kombëtare! 50
- 3 gratë e fuqishme të Europës 53
- Rezervat materiale, në konceptin e integruar logjistik të NATO-s 54
- Kodikët e shenjtë të Beratit 60
- Shërbimi i Shëndetësisë, pararoja e shërbimeve elitare të ushtrisë shqiptare 62
- Samiti i NATO-s në Uashington, vendimet kryesore 68
- E ardhmja e ndryshimeve klimaterike 70
- Lufta kibernetike, një kërcënim real 72
- Familja shqiptare, sot apo dikur? 76
- Të rinjtë shqiptarë dhe 'çmimi' i jetës së luksit 78
- Lamtumirë, poeti, polemisti, zëri i potershëm, shpirti i temperuar në kudhrën e botës trazimtare in memoriam/ Ismail Kadare, testamenti i përhershëm i kombit shqiptar 81
- Përfjetë mirënjohës veprës tuaj sublime! 82
- Almanaku i historisë Shqiptare në rugëtimin e tij për liri dhe pavarësi 88

18

Shqipëria mirëpret Konferencën
e Shefave të Shtabit të
Përgjithshëm të Vendeve të
Ballkanit (BCHOD's)

04

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Sot, Ju jeni gardianë të sovranitetit dhe integritetit të Atdheut


06

Miratohet rritja e pagave për ushtarakët, ministri Peleshi: Jemi duke kaluar vendet e rajonit

08

Ministri Peleshi: Viojmë mbështetjen politike dhe ushtarake ndaj Ukrainës

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takimin e 23-të të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës, i cili u zhvillua në Bruksel, nën drejtimin e Sekretarit për Mbrojtjen i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Lloyd J. Austin. Vendet rikonfirmuan edhe një herë mbështetjen e tyre politike dhe ushtarake ndaj Ukrainës, duke ruajtur qëndrimin unanim kundër agresionit të paligjshëm, të pajustificuar të Rusisë. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi ritheksoi se Shqipëria do të vijojë të mbështesë politikisht Ukrainën. Gjithashtu nuk do të...



“ZONA GRI” - Hapësira mes paqes së brishtë dhe luftës së mundshme

Termi “zonë gri” u krijua nga Komanda e Operacioneve Speciale të Shteteve të Bashkuara dhe u botua në 2015. Koncepti i “zonës gri” është ndërtuar mbi strategjitë ekzistuese ushtarake; megjithatë, teknologjia e informacionit ka krijuar hapësira të reja radikale, të cilat kanë zgjeruar...

Faqe 46



Familja shqiptare, sot apo dikur?

Përmirësimi i cilësisë së marrëdhënieve dhe çelësi i një jete të qetë, janë sjelljet e mira, fjalori i një gjuhe të ‘kruar’ me norma dhe parime njerëzore, të cilat janë kaq të thjeshta dhe kaq të harruara në komunikimin e përditshëm. Në shoqërinë tonë, është normale që të dy prindërit të punojnë, sepse e kundërta e këtij realiteti do ta bënte jetesën...

Faqe 76



Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Sot, Ju jeni gardianë të sovranitetit dhe integritetit të Atdheut

Në sheshin "Italia", aty ku para 30 vitesh të rinj dhe të reja shqiptare protestonin për liri, demokraci e arsimim europian, sot pasardhësit e tyre kremtojnë përmbylljen e ciklit të tyre universitar me standardet europiane dhe të barabartë, si moshatarët e tyre kudo në Europën e civilizuar. Një tjetër vlerë dhe kuptim merr kjo ceremoni, nga të rinjtë dhe të rejat e FA-së, të cilët nga nesër do të nisin një udhëtim të ri, të bukur dhe sfidues, atë të oficerit të ushtrisë shqiptare. Pjesë e kësaj ceremonie të veçantë, jo vetëm për studentët, familjarët e tyre, stafit akademik, komanduesit, ish-in edhe qytetarë e kalimtarë të rastit, të cilët në përshtypjet e tyre u ndien të befasuar dhe njëkohësisht optimistë për të ardhmen e sigurisë së vendit tonë. Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, zëvendësministërja e Arsimit Ana Kapaj, ambasadori i Republikës së Kosovës, Sh. T. z. Skënder Durmishi, gjeneralë, atashe, drejtorë e familjarë. Fjalën e hapjes së kësaj dite të veçantë për studentët e AFA-së, e mbajti komandanti i Akademisë, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, i cili do të theksonte:

"Sot është dita juaj! Ndaj ne jemi mbledhur këtu për të nderuar punën, arritjet, përkushtimin e sakrificat tuaja, të cilat kanë bërë të mundur mbërritjen e këtij momenti të shumëpritur, duke hapur dyert e karrierës tuaj ushtarake.

Gjatë këtij udhëtimi, keni kaluar mjaft sfida, si në anën intelektuale, fizike, ashtu edhe psikologjike, por ju ia dolët më së miri! Ky ishte testi dhe misioni juaj, të cilin ju e përbushët me sukses.

Prandaj, ne jemi besimplotë se ju sot jeni gati, pasi Akademia e Forcave të Armatosura, përfaqëson një institucion unik të arsimit të lartë. Ajo ka qenë dhe mbetet mbartëse dhe reflektuese e



moralit, vlerave dhe frymës atdhetare e patriotike të vendit tonë, zëdhënese e traditave të pasura të Forcave të Armatosura, qendër e rëndësishme e formimit intelektual, e mendimit shkencor, kulturës dhe historisë ushtarake, me mision të saj kryesor arsimimin e përgatitjen e brezit të ri të ushtarakëve për t'i shërbyer



atdheut në çdo kohë dhe situatë.

Ndaj sot, përshëndes ju e të gjithë gjeneratat e studentëve, të pedagogëve, punonjësve dhe drejtuesve që kanë studiuar dhe shërbyer në këtë akademi, për kontributin e veçantë në arsimimin, përgatitjen dhe formimin e mijëra oficerëve për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, por edhe përtej tyre”, - kështu do ta hapte fjalën e rastit komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj në ditën e diplomimit të oficerëve të rinj, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave të Armatosura. “Akademia e Forcave të Armatosura tashmë vijon një proces të thellë transformimi, duke iu qasur modeleve më të mira dhe duke i dhënë asaj frymën, formën e përmbajtjen e Akademisë së “West Point-it”. Ky transformim përfshin çdo aspekt të punës që nga modernizimi i kurrikulës, hapja e programeve të tjera, rritjen cilësore të trupës akademike dhe motivimi i saj.

Gjenerata e re që do të ndjekë studimet në AFA, do të ketë fatin që

të kryejë studimet në një prej kampuseve më modernë të arsimit të lartë në vend, falë një investimi serioz nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes. Ndaj, sot gjej rastin të falënderoj Ministrin e Mbrojtjes, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, për mbështetjen që i kanë dhënë dhe vazhdojnë t’i japin Akademisë së Forcave të Armatosura, si një prioritet i veçantë për përgatitjen e oficerit të ri. Të dashur studentë, nëntogerë të rinj, përreth jush do të gjeni ata që kanë besuar dhe besojnë tek ju, dhe e kanë bërë këtë udhëtim jo vetëm të përballueshëm, por edhe të këndshëm: pedagogë e komandantë që ju kanë hapur horizonte të reja, shokë e shoqe klase që janë bërë tashmë familja juaj dhe sigurisht, të dashurit tuaj, mbështetja e të cilëve ka qenë pjesë e pandarë në mozaikun e suksesit tuaj. Kjo gjeneratë që diplomohet mbart edhe një simbolikë shumë të veçantë, pasi sot diplomohen gjithashtu për herë të parë edhe katër studentë nga Republika e Kosovës, të cilët përfunduan ciklin e plotë të studimeve në AFA. Motivimi, performanca dhe rezultatet e tyre kanë shërbyer si burim frymëzimi për të gjithë ne. Shpreh bindjen e plotë se ky shembull do vazhdojë edhe me brezat e tjerë në vijim. Në karrierën tuaj, ju do të udhëhiqeni nga vlerat morale më të larta të përkushtimit ndaj Nderit, Detyrës e Atdheut, vlera të cilat do t’i mbani e zhvilloni me kujdes e do të shërbejnë si busull orientuese për të ardhmen.

Sot, ju jeni më të guximshëm nga sa besoni, më të fortë nga sa dukeni, e më të zgjuar nga sa mendoni. Ky kapitull i ri përbën të ardhmen e karrierës tuaj. Ishte privilegj dhe krenari e veçantë të shërbeja si komandanti juaj!”, - mbylli fjalën e rastit gjeneral brigade Nuredinaj.

Më tej, ministri i mbrojtjes Niko Peleshi, mes emocioneve të kësaj dite të veçantë do të shprehej: “Pas një rrugë të gjatë e të vështirë, ju arritët të realizoni sfidat e kadetit, duke hapur një kapitull të ri në jetën tuaj si oficer i Forcave të Armatosura. Mes sfidave dhe stërvitjeve të pazakonshme për moshatarët tuaj, ju keni mundur t’ia dilni. Zgjedhja juaj ishte e vështirë por me një arsye dhe motiv të lartë për t’u bërë krenarë për të mbajtur mbi shpatulla uniformën ushtarake. Për ju “Nderi, Atdheu, Detyra” tanimë është motoja e jetës tuaj. Ju sot po filloni karrierën më dinjitoze si nënoficer i FA-së, përkrah pedagogëve dhe komanduesve tuaj dje, sot si kolegë. Udhëtimi juaj i ri, një udhëtim frymëzues për brezat që do të vijnë”. Më tej ministri i Mbrojtjes tha se konsolidimi dhe reformimi i arsimit të Akademisë së Forcave të Armatosura ka qenë dhe do të mbetet një prioritet kryesor, në partneritet me Akademinë Ushtarake të SHBA-ve “West Point” dhe Gardën Kombëtare të New Jersey-it. “Akademia jonë është bërë sot një ofertë serioze për të gjithë të rinjtë e të rejtat, të cilët kanë shprehur interesin nëpërmjet numrit të lartë të aplikimeve”. Në fund të ceremonisë studentët morën në duart e tyre konkludimin e punës trevjeçare, diplomat të cilat u dorëzuan nga lideri politik dhe ata ushtarakë dhe në fund, fishekzjarrët dhe ovacionet e tyre përmbyllën këtë natë magjike të jetës së tyre të re.





Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi njoftoi rritjen e re të pagave për Forcat e Armatosura dhe personelin civil të administratës publike. Në deklaratën e bërë pas mbledhjes së qeverisë, ministri Peleshi tha se kjo është një rritje domethënëse që prek të gjitha nivelet, nga ushtari l e deri te gjeneralët, ndërsa theksoi se pagat e ushtarakëve do të rriten çdo vit, deri sa të arrijnë nivelin e pagave të vendeve të Aleancës.

“Kjo rritje filloi në vitin 2022, me rritjen më të madhe të historisë të pas viteve '90 në Shqipëri, me 30% dhe është një premtim dhe angazhim i kryeministrit që pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit deri sa ne të arrijmë nivelin mesatar të vendeve të Aleancës, ku bëjmë pjesë. Pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit! Jemi shumë afër, duke kaluar vendet e rajonit, duke shkuar drejt vendeve dinjitoze”, - u shpreh Ministri i Mbrojtjes.

Në deklaratën e tij, ai specifikoi edhe nivelin e rritjes që nis nga 1 korriku. “Për ushtarin IV, paga bazë do të shkojë në 71.000 lekë sipas gradës dhe viteve të shërbimit, nga 42.000 lekë në vitin 2019, pra një rritje në këto vite prej 29.000 lekësh. Të gjitha pagave që do të lexoj, iu shtohet dhe trajtimi me ushqim që jepet në formën e kompensimit ushqimor prej 16.000 lekësh.

Pra një ushtar VI nuk do të marrë 71.000 Lek, por do të marrë 87.000 Lek. Këtë duhet të dëgjojnë të gjithë të rinjtë, pasi kushdo që do të bëhet pjesë e Forcave të Armatosura e nis me një pagesë 87.000 Lek. Politika e këtij viti, e këtij vendimi është nga 7 deri në 22%, ku në ndryshim nga dy vitet e fundit, këtë vit do i japim më shumë prioritet gradave më të ulëta.

Rreshteri në vitin 2019 e ka patur pagën 48.200 lekë, me rritjen prej 30% shkoi në 62.660 lekë dhe me rritjen e sotme shkon në 80.000 lekë, duke shtuar plus 16.000 lekë të trajtimit ushqimor”, - sqaroi ministri Peleshi.

Z. Peleshi tha më tej se: “Majorit, nga 68.800 lekë, paga i shkoi në 89.440 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 107.000 lekë pa trajtimin ushqimor.

Diferenca në pesë vite është 38.200 lekë. Koloneli në 2019 paguhej 110.000 lekë, shkoi në 143.000 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 163.500 lekë pa trajtimin ushqimor. Gjenerali e ka patur pagën 127.500 lekë në vitin 2022, shkoi në 165.000 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 190.000 lekë. Pra një rritje prej 62.500 lekësh”, - theksoi ministri Peleshi.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi theksoi se qeveria ka rritur buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes në 2% të GDP-së, duke e bërë Shqipërinë një nga 22 vendet aleate në NATO, që përmbushin angazhimin e Aleancës. Dhe sipas z. Peleshi, në buxhetin e pagave lëvizën 11 milion dollarë, duke patur parasysh që edhe personeli civil do të ketë rritjen e pagave.

Ministri i Mbrojtjes bëri të ditur se rritje pagash do të ketë edhe personeli zjarrfikës, i cili sipas tij bën një punë shumë

“Kjo rritje filloi në vitin 2022, me rritjen më të madhe të historisë të pas viteve '90 në Shqipëri, me 30% dhe është një premtim dhe angazhim i kryeministrit që pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit deri sa ne të arrijmë nivelin mesatar të vendeve të Aleancës, ku bëjmë pjesë. Pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit! Jemi shumë afër, duke kaluar vendet e rajonit, duke shkuar drejt vendeve dinjitoze”.

të rëndësishme, të pazëvendësueshme dhe të çmuar. Kjo rritje, sipas tij shkon deri në 30% në varësi të gradave: “Asistent zjarri, që është grada më e ulët e zjarrfikësit, paga aktuale është 46.000 lekë, rritet në përqindje 30.43%, në vlerë 14.000 lekë, paga sot shkon në 60.000 lekë. Sapo hyn në Shërbimin Zjarrfikës, paga fillestare nga sot do të jetë 60.000 lekë. Zjarrfikësi, një gradë më e lartë, ka pasur pagën 52.500 lekë, sot shkon në 65.000 lekë; kryezjarrfikës nga 55.000 lekë shkon në 70.000 lekë; kryeinspektor zjarrfikës nga 74.500 lekë shkon në 85.000 lekë; inspektor zjarrfikës nga 64.200 lekë shkon në 75.000 lekë; komisar zjarrfikës nga 97.500 lekë shkon në 105.000 lekë; drejtues zjarrfikës nga 108.000 lekë shkon në 115.000 lekë; drejtues i parë zjarrfikës nga 120.000 lekë në 140.000 lekë dhe drejtues i lartë zjarrfikës nga 131.000 lekë shkon në 160.000 lekë”, - specifikoi ministri Peleshi, duke i cilësuar si nivele shumë dinjitoze pagash.

Ministri Peleshi pati edhe një thirrje për drejtuesit vendorë, në një kohë që temperaturat janë rritur dhe rrezikshmëria për rënien e zjarreve është më e lartë: “Jemi për fat të keq në prag të sezonit të zjarreve, vera e nxehtë sjell dhe qindra vatra zjarresh. Ju bëj thirrje kryetarëve të bashkive, natyrisht edhe një apel të gjithë forcës tonë zjarrfikëse, të qëndrojnë në krye të detyrës për eliminimin e pasojave, në një stinë që fatkeqësisht pritet të jetë më e nxehtë se vitet e tjera”, - u shpreh z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takimin e 23-të të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës, i cili u zhvillua në Bruksel, nën drejtimin e Sekretarit për Mbrojtjen i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Lloyd J. Austin.

Vendet rikonfirmuan edhe një herë mbështetjen e tyre politike dhe ushtarake ndaj Ukrainës, duke ruajtur qëndrimin unanimit kundër agresionit të paligjshëm, të pajustificuar të Rusisë.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi ritheksoi se Shqipëria do të vijojë të mbështesë politikisht Ukrainën. Gjithashtu nuk do të mungojë ndihma në materiale dhe logjistikë, ndërkohë që po hidhen hapa konkretë që ekspertët shqiptarë bashkë me aleatë të tjerë të përfshihen në programe trajnimi për personelin e Forcave të Armatosura të Ukrainës.

Ministri i Mbrojtjes deklaroi gjithashtu se Shqipëria do të vijojë të mbështesë Këshillin NATO-Ukrainë dhe do të respektojë çdo detyrim në kuadër të tij, ashtu si edhe vendet e tjera aleate.


Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes



MINISTRI PELESHI: Vijojmë mbështetjen politike dhe ushtarake ndaj Ukrainës

i Ukrainës, Rustem Umerov, bëri një përshkrim të hollësishëm të zhvillimeve në terren. Ai falënderoi vendet aleate dhe

mike për mbështetjen e jashtëzakonshme për popullin e Ukrainës si dhe përsëriti nevojën për vijimin e ndihmës.



Ministri Peleshi dhe ministri i Mbrojtjes i Sllovenisë Marjan Šarec, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit në rastet e katastrofave natyrore

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në kuadër ministerialit të Mbrojtjes, zhvilluar në Bruksel, u takua dhe me homologë të tij të vendeve anëtare të NATO-s.

Pjesë e këtyre takimeve ishte dhe ai me ministrin e Mbrojtjes së Sllovenisë Marjan Šarec, ku çështje kryesore e diskutimit ishte bashkëpunimi dypalësh në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe intensifikimi i marrëdhënieve në kuadër të NATO-s dhe bashkëpunimit rajonal.

Dy ministrat nënshkruan Marrëveshjen mbi Bashkëpunimin për Mbrojtjen ndaj Katastrofave Natyrore, marrëveshje e cila ka si qëllim të rregullojë kuadrin ligjor për një bashkëpunim sa më efikas në parandalimin dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive, për ofrimin vullnetar të ndihmës së ndërsjellë në rast katastrofash. Gjithashtu pjesë e takimeve të ministrit Peleshi ishte dhe ai me ministrin e Mbrojtjes së Suedisë, Pål Jonson, ku inicimi i një bashkëpunimi konkret në fushën e Mbrojtjes midis dy vendeve ishte në qendër të bisedës.

Ministri Peleshi i propozoi ministrit Jonson nënshkrimin e një marrëveshjeje dypalëshe në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes si një dokument ligjor që do të shërbente si bazë për bashkëpunim sa më të sigurt dhe konkret në të ardhmen. Gjatë takimit u diskutua gjithashtu mbi mundësinë e një bashkëpunimi në fushën e Industrisë Ushtarake, asistencën dhe mbështetjen që Suedia mund t'i ofrojë vendit tonë, apo dhe krijimi i një lloj bashkëpunimi me industrinë ushtarake të njohura suedeze.



Dy ministrat nënshkruan Marrëveshjen mbi Bashkëpunimin për Mbrojtjen ndaj Katastrofave Natyrore, marrëveshje e cila ka si qëllim të rregullojë kuadrin ligjor për një bashkëpunim sa më efikas në parandalimin dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive, për ofrimin vullnetar të ndihmës së ndërsjellë në rast katastrofash.





Ministri Peleshi: Brenda 2030, Shqipëria me produkte “Made in Albania” në tregun ndërkombëtar

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s, të zhvilluar në Bruksel. Gjatë këtij ministeriali u diskutuan çështjet më të mprehta të Sigurisë dhe Mbrojtjes në zonën euroatlantike, të cilat do të përbëjnë edhe bazën e bisedimeve të Samitit të Uashingtonit, i cili pritet të mbahet në muajin korrik.

Ministri Peleshi, në fjalën e tij nënvizoi se Shqipëria vijon të ketë një angazhim serioz financiar ndaj Aleancës, duke zyrtarizuar kontributin me 2,03% të GDP. Një pjesë e mirë e këtij kontributi do të investohet për modernizimin e Forcave të Armatosura në armatime dhe pajisje.

Ministri Peleshi njohu homologët me ambicien e Shqipërisë për të zhvilluar Industrinë e Mbrojtjes dhe planet që brenda vitit 2030 të hyjë në tregun ndërkombëtar me produktet “Made in Albania”.

Po ashtu, gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u fokusua në situatën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, të cilën e konsideroi të brishtë dhe jo të qëndrueshme. Sipas ministrit Peleshi, Kuvendi Gjithëserb i mbajtur në Beograd disa ditë më parë, është shqetësues për narrativën lidhur me pretendimet territoriale të ngritur prej tij, si dhe gjuhën e përdorur ndaj aleatëve perëndimorë.

Ministri i Mbrojtjes ritheksoi mbështetjen e Shqipërisë ndaj Kosovës në rrugën e saj të integritit euroatlantik, si dhe kërkoi ekuilibër dhe trajtim realist të fakteve



mbi dinamikat e Sigurisë dhe zhvillimet e Mbrojtjes në Kosovë. Në këtë ministerial, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg theksoi rëndësinë e miratimit

të Axhendës së Mbrojtjes dhe Shkurajimit të Samitit të Uashingtonit si edhe ftoi ministrat e Mbrojtjes të pranojnë Paketën e Asistencës dhe Trajnimit për Ukrainën.



Ministri i Mbrojtjes Peleshi takohet me ndihmëssekretaren për Politikën e Mbrojtjes dhe të Jashtme në DASH, znj. Jessica Lewis

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi gjatë Samitit të NATO-s, në Uashington një takim me znj. Jessica Lewis, ndihmëssekretare për Politikën e Mbrojtjes dhe të Jashtme, në Departamentin Amerikan të Shtetit.

Z. Peleshi siguroi znj. Lewis për angazhimin e Shqipërisë për të përbushur të gjitha detyrimet që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kanë në projektet e përbashkëta, të listuara në dokumentin “Lines of Efforts 2023-2027”, dokument ky i nënshkruar në shtatorin e vitit të kaluar në Tiranë, në përfundim të bisedimeve dypalëshe SHBA-Shqipëri në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes dhe zyrtarja e DASH diskutuan për situatën në Ukrainë dhe atë në Ballkanin Perëndimor. Z. Peleshi kërkoi vëmendje të shtuar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të tjerë kryesisht për Veriun e Kosovës, duke u shprehur shqetësimin për incidentet e herëpashershme të provokuara nga elementë me lidhje të ngushtë me Beogradin. Në lidhje me situatën në Ukrainë, ministri i



Mbrojtjes theksoi se Shqipëria do të mbetet thellësisht e angazhuar në ndihmën e

saj ndaj popullit ukrainas. Teksa detajoi ndihmën logjistike që vendi ynë ka dhënë nga janari 2024, ministri Peleshi foli edhe për punën që po bëhet për paketat e reja të ndihmës dhe pjesëmarrjen në misionin trajnues “Interflex” për Forcat e Armatosura të Ukrainës.

Gjatë takimit u diskutua edhe për projektet e Korridorit VIII, Porto Romanos dhe rijetësimin të industrisë ushtarake. Në lidhje me këtë të fundit ministri Peleshi theksoi ofertën për bashkëpunim drejtuar firmave të mëdha amerikane që operojnë në këtë fushë. Nga ana e saj, znj. Lewis rikonfirmoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për Shqipërisë, aleatit strategjik të vendit tonë dhe një nga partnerët më të besueshëm në Ballkan.





Peleshi: Shqipëria së shpejti do të ketë vendin e saj në industrinë ushtarake të Aleancës

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në një takim mes përfaqësuesve të Agjencisë së NATO-s për Komunikimin dhe Informacionin (NCIA - NATO Communications and Information Agency), të Mbështetjes dhe Prokurimit (NSPA - NATO Support and Procurement Agency) si dhe

të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes me përfaqësues të dhomave të tregtisë, industrisë, sipërmarrës, kompani e biznese. Ky aktivitet i titulluar “Dita e Industrisë” kishte si synim dhënien e një informacioni mbi procedurat e prokurimit, legjislacionit dhe kushtet që duhet të plotësojnë oper-

atorët ekonomikë në Shqipëri për të marrë pjesë në prokurimet ndërkombëtare, por edhe për të përcaktuar një bashkëpunim mes bizneseve shqiptare dhe agjencive të NATO-s.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi nxiti përfaqësuesit e biznesit të aplikojnë dhe të

përfitojnë nga këto projekte, duke shprehur nga ana tjetër gatishmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes për krijimin e urave të duhura të bashkëpunimit ndërmjet operatorëve privatë shqiptarë dhe përfaqësuesve të strukturave me përvojë të NATO-s. “Konfliktet kanë bërë që kërkesa të rritet shumë për armatime, për ushqime apo mallra të tjera që prokurohen në këto agjenci të NATO-s. Bota e madhe e konflikteve në rritje, ka sjellë edhe rritje të kërkesës dhe ne ju ftojmë të përfitonin nga këto kontrata. Tashmë keni më shumë se 30 vite eksperiencë. Kemi kompani të shkëlqyera që sa herë kanë dalë jashtë vendit kanë fituar besim për shkak se e kanë rritur standardin”, - u shpreh Ministri i Mbrojtjes.

Në këtë aktivitet që u mbajt në Qendrën e Inovacionit, ministri Peleshi evidentoi edhe disa nga projektet që po marrin jetë në këtë qendër e që do t'u vijnë në ndihmë sipërmarrjeve.

“Deri dje ka patur një mur mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe botës së biznesit. Dukej një tabu dhe një sektor i padepërueshëm për ç’ ka ndodh sot në botën e inovacionit dhe teknologjisë. E kundërta është e vërtetë. Ne kemi sot mundësi të mëdha, edhe kombëtare, por mbrapa nesh është një perde tjetër, e cila do të hapet sot dhe është shumë herë më e madhe, mundësia e NATO-s”, - shpjegoi ministri Peleshi.

Para sipërmarrësve, ministri foli edhe për nismën e re për rigjallërimin e industrisë ushtarake në vend: “Ne po punojmë fort për të ndërtuar kuadrin ligjor dhe më vonë edhe institucional të industrisë ushtarake në vendin tonë. Të gjithë e dini që ne vijmë nga një e kaluar e një gjigandomanie të ushtrisë, ku i gjithë populli ishte ushtar, pastaj u pasua nga një kohë



tjetër e detyrueshme, demilitarizimi dhe, sot, jemi në një kohë kur e kemi tejkaluar këtë pjesë të historisë. Jemi anëtarë të NATO-s, duam dhe duhet të luajmë edhe

të riaktivizohen. Por së pari na duhet një kuadër ligjor i përshtatshëm dhe incentive për investime. Kemi parasysh këtu jo vetëm investitorë të huaj, por kemi edhe



ne pjesën tonë në industrinë ushtarake të Aleancës. Kemi asete të së shkuarës, të cilat me investime të përbashkëta mund

investitorë shqiptarë, që mund të mos kenë përvojë në këtë fushë, por janë të gatshëm të jenë partnerë në këtë industri të re që do të fillojë të marrë jetë që këtë vit. Është një takim për të hapur perdet e mundësive dhe për të bashkëpunuar me sipërmarrjet shqiptare”, - u shpreh z. Peleshi. “Dita e Industrisë” lindi si një ide në Bruksel në muajin shkurt. Ndaj në këtë takim ministri i Mbrojtjes falënderoi edhe Dorina Canin, oficerë për kontratat pranë Agjencisë së NATO-s, për Komunikimin dhe Informacionit (NCIA), e cila kontribuoi në organizimin dhe dhënien e informacionit të nevojshëm për përfaqësuesit e biznesit.





“Përpjekja e Përbashkët 2024”, ministri Peleshi: Një test real i planeve kombëtare në mbështetje të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, përshëndeti përfundimin me sukses të stërvitjes më të madhe kombëtare të Forcave të Armatosura “Përpjekja e Përbashkët 2024”.

Në prani të gjeneralëve, komandantëve, oficerëve, nënoficerëve e ushtarëve pjesëmarrës, ministri Peleshi deklaroi se kjo stërvitje ka rëndësi të madhe për vendin tonë, pasi shërben edhe si një test real i planeve kombëtare në mbështetje të planeve rajonale të NATO-s. “Kjo stërvitje vuri në provë kapacitetet tona reaguese në rast të aktivizimit të Artikullit 5 të NATO-s, atë të mbrojtjes kolektive, gatishmërinë e forcave, aftësitë dislokuese, komandim-kontrollin, sigurimin e pikave të debarkimit detar dhe ajror, sigurimin e infrastrukturës kritike, si dhe zhvillimin e operacioneve mbrojtëse dhe mësymëse të trupave të deklaruara për t’u dislokuar jashtë vendit”, - u shpreh ministri Peleshi.

Referuar mjedisit të sotëm të sigurisë, ministri Peleshi vuri në dukje faktin se në përmbushje të angazhimeve kombëtare dhe atyre të deklaruara në NATO, vendi ynë ka ndërmarrë një sërë procesesh



të rëndësishme për zhvillimin e Forcave të Armatosura, për të qenë sa më moderne, profesioniste dhe të afta për të përmbushur misionin kushtetues dhe tërësisht të ndërveprueshme me vendet e Aleancës. “Ne jemi të vendosur për të konsoliduar dimensionin operacional dhe taktik, duke vendosur theksin te transformimi i pandërprerë i forcave dhe kapaciteteve ushtarake. Modernizimi i FA-ve me pajisje moderne, sisteme të mbrojtjes kundërajrore dhe kundërtanke, të vëzhgimit dhe monitorimit të hapësirës ajrore dhe detare, krahas projekteve për përmirësimin e infrastrukturës

ushtarake, e bëjnë vendin tonë një aset të rëndësishëm të Aleancës, në mbështetjen e operacioneve në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes kolektive”, - theksoi në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes. Ministri foli edhe për vendimin e fundit të qeverisë për rritjen e pagave për të gjithë efektivistët e Forcave të Armatosura. “Përfitoj nga rasti për të rikonfirmuar mbështetjen e qeverisë në drejtim të Forcave të Armatosura, nëpërmjet pagave të reja të miratuara së fundmi. Kjo rritje filloi në vitin 2022 dhe aktualisht shkon në 40%! Është një

premtim i mbajtur dhe angazhim i kryeministrit që pagat e Forcave të Armatosura të rriten çdo vit deri sa të arrijmë nivelin mesatar të vendeve të Aleancës”, - theksoi ministri Peleshi. Stërvitja “Përpjekja e Përbashkët 2024”, që u zhvillua në Bizë, sinkronizoi aftësitë ndërvepruese të niveleve komanduese e drejtuese si dhe ekzekutimin e veprimeve luftarake të trupave në terren. Në këtë stërvitje u angazhuan rreth 2000 trupa, qindra mjete tokësore, anije të Forcës Detare, helikopterë të Forcës Ajrore, si dhe për herë të parë dronët “Bayraktar TB2”.



Nënshkruhet dokumenti për Lëvizshmërinë Ushtarake përgjatë korridorit VIII

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi nënshkroi gjatë punimeve të Samitit të NATO-s në Uashington, Letrën e Qëllimit për Sigurimin e Lëvizshmërisë Ushtarake përgjatë Korridorit VIII pan-Evropian, me homologët e tij të Italisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut. Përmes këtij dokumenti, shtetet angazhohen të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar maksimumin e fleksibilitetit të lëvizshmërisë ushtarake në territoret e tyre, në mbështetje të implementimit të agjendës së NATO-s, për shkurajimin dhe mbrojtjen në zonën euroatlantike. Një angazhim i tillë do të shërbejë jo vetëm për misionet e NATO-s, por edhe ato në kuadër të Bashkimit Evropian. Në thelb ky dokument i firmosur nga ministri Niko Peleshi, ministri italian i Mbrojtjes Guido Crosetto, ministri bullgar i Mbrojtjes Atanas Zaprjanov dhe ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut Vlado Misajlovski, u jep mundësi trupave ushtarake NATO-s të zhvendosen shpejt dhe lirshëm nga deti Adriatik në Detin e Zi si dhe të depërtojnë në thellësi të Ballkanit, nëse do të jetë e nevojshme. Ideja për të patur një dokument të tillë, i cili do të garantojë lëvizshmërinë përgjatë vendeve që preken nga Korridori VIII pan-Evropian është



propozuar nga Shqipëria, e cila drejtoi të gjithë procesin e negociimit dhe koordinimit. Italia, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut, përgjatë të gjithë procesit ndërvepruan dhe u angazhuan për ta finalizuar këtë nismë gjatë punimeve të Samitit të Uashingtonit. Nënshkrimi i Letrës së Qëllimit vjen në mbështetje të vizionit që Shqipëria ka për

Korridorin VIII si edhe të master-projektit për ndërtimin e Bazës Detare NATO-s në Porto Romano, që do të shërbejë si porta kryesore hyrëse në Ballkanin Perëndimor dhe më tej, në Detin e Zi. Letra e Qëllimit do të rrisë vizibilitetin e projekteve të përbashkëta si dhe rëndësinë gjeostrategjike të tyre për të gjithë rajonin.

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Turqisë, gjeneral Metin Gürak

Me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve të Turqisë, gjeneral Metin Gürak. Gjeneral Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen gjeneralit Gürak dhe ekipit që e shoqëronte, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e kontributin që Forcat e Armatosura të Turqisë kanë dhënë ndër vite, duke luajtur një rol të rëndësishëm në reformimin, transformimin, dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura. Në mënyrë konkrete, gjeneralmajor Kingji theksoi mbështetjen me ekspertë nga Forcat e Armatosura të Turqisë për forcat tona komando, në bazën detare Pashaliman, mundësinë për t'u arsimuar në institucionet arsimore të Turqisë, mbështetjen logjistike dhe zhvillimin e kapaciteteve, trajtimin shëndetësor në Turqi, dhe angazhimin e përbashkët në operacione dhe stërvitje të ndryshme.

Po kështu, gjeneralmajor Kingji vlerësoi ndihmën e ofruar nga qeveria turke në menaxhimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 dhe përballimin e pasojave të pandemisë COVID-19. Më tej, bashkëbisedimi u fokusua në zhvillimet e fundit në Forcat e Armatosura, përmirësimet strukturore dhe ligjore, rishikimin e dokumenteve strategjike, ecurinë e projekteve të modernizimit, zhvillimin e infrastrukturës ushtarake, kontributin në misione dhe operacione, masat e marra në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes dhe planeve rajonale, etj. Gjeneralmajor Kingji u ndal dhe në zhvillimet e fundit në mjedisin e sigurisë në zonën Euro – Atlantike dhe sidomos në Ballkanin Perëndimor, ku influenca malinje dhe retorika konflikt ndjellëse e disa aktorëve synon tensionimin e situatës dhe pengimin e zhvillimit normal të proceseve integruese. Në këtë pikë, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të Turqisë për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, rolin e KFOR-it për sigurinë dhe stabilitetin



në Kosovë dhe kontributin domethënës të Turqisë në këtë operacion. Po kështu, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e iniciativave rajonale për promovimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit në rajon, ku dhe e falënderoi gjeneral Gürak për pjesëmarrjen dhe vlerën e shtuar që ai solli në konferencën e 17 të shefave të Shtabit të Ballkanit, të mbajtur në Durrës më datën 06 qershor 2024. Në fjalën e tij, gjeneral Gürak vlerësoi bashkëpunimin tonë dypalësh dhe angazhimin e tij për ta avancuar atë dhe më

tej në të ardhmen, në të gjitha fushat, ku FARSH ka interes.

Ai theksoi rolin konstruktiv të vendit tonë për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit dhe qëndrimin e palës turke se një Shqipëri e fortë është një kontributi më i mirë për një rajon të sigurt. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve të Turqisë, gjatë vizitës zyrtare në vendin tonë ka zhvilluar takime zyrtare me Presidentin e Republikës së RSH, SH.T. z. Bajram Begaj dhe me ministrin e Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.



Shefi i SHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji priti gjeneral brigade Jeton Dreshaj, komandant i KDS në FS së Kosovës

Komandanti i Komandës së Doktrinės dhe Stërvitjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral brigade Jeton Dreshaj zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë. Gjatë kësaj vizite, gjeneral brigade Dreshaj u prit në takim zyrtar dhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji. Gjeneralmajor Kingji pasi i uroi mirëseardhjen gjeneral brigade Dreshaj, vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet FARSH-së dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke e cilësuar atë si një prioritet parësor të tijin, dhe angazhimin për ta zhvilluar këtë bashkëpunim më tej në të ardhmen. Gjithashtu, gjeneralmajor Kingji theksoi performancën dhe përkushtimin e personelit të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë procesit arsimor në institucionet e arsimit ushtarak të FARSH-së dhe profesionalizmin e treguar nga personeli i FSK-së gjatë stërvitjeve të ndryshme, qofshin këto dypalëshe apo shumëkombëshe. Ai vlerësoi binjakëzimin e institucioneve arsimore ushtarake të FARSH-së dhe FSK-së, si shembull i thellimit të bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe stërvitjes, i cili do të ketë ndikojë në zhvillimin e personelit dhe shkëmbimin e përvojës, shfrytëzimin e hapësirave dhe poligoneve trajnuese, rritjen e ndërveprueshmërisë në sisteme dhe programe trajnuese, etj.

Më tej, gjeneralmajor Kingji ofroi një panoramë të zhvillimeve të fundit në Forcat e Armatosura, përmirësimet strukturore dhe ligjore, rishikimin e dokumenteve strategjike, ecurinë e projekteve të modernizimit, zhvillimin e infrastrukturës ushtarake, kontributin në misione dhe operacione, masat e marra në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes dhe planeve rajonale, etj. Po kështu, gjeneralmajor Kingji u ndal në rolin e iniciativave rajonale për promovimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit në



rajon, duke shprehur se tashmë ka ardhur koha që Kosova të jetë anëtare me të drejta të plota në Iniciativën e Kartës së Adriatikut, e cila do të zhvillojë konferencën e radhës në muajin shtator të këtij viti. Gjeneral brigade Dreshaj vlerësoi bashkëpunimin

tonë dypalësh në fushën e Mbrojtjes dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen e pakursyer që FARSH ka dhënë në proceset e transformimit dhe zhvillimit të FSK, dhe riafirmoi vullnetin e tij për ta avancuar këtë bashkëpunim dhe në të ardhmen.





Shqipëria mirëpret Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHOD's)

Nga data 5 deri më 7 qershor 2024, u zhvillua në vendin tonë konferenca e 17-të e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHOD's). Konferenca u organizua nga vendi pritës Shqipëria.

Në konferencë morën pjesë vendet anëtare të iniciativës rajonale të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Bullgaria, Turqia, Greqia, Bosnjë - Hercegovina dhe Serbia, si dhe 2 vende vëzhguese Sllovenia dhe Kroacia. Sllovenia u përfaqësua nga SHSHP, gjeneralletjënant Robert Glavas, ndërsa Kroacia nga drejtori i Drejtorisë së Operacioneve, gjeneralmajor Denis Tretinjak.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm të drejtuesve më të lartë ushtarakë të vendeve të Ballkanit morën pjesë edhe përfaqësues nga Komiteti Ushtarak i BE-së, drejtori i Kabinetit të Kryetarit të Komitetit Ushtarak të BE-së, gjeneralmajor Johann Frank dhe nga Komanda e Forcës së Bashkuar e NATO-s (JFC) Napoli, Itali, zëvendëskomandanti i JFC Napoli, gjeneralletjënant Stephen Kelsey (CAN Army).

Konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre të ftuar VIP, Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH. T. z. Bajram Begaj dhe ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.

Qëllimi i iniciativës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit është promovimi dhe forcimi i paqes dhe sigurisë rajonale nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak të vendeve anëtare.

Fjalën përshëndetëse të hapjes së konferencës e mbajti shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji.

Konferencën e përshëndetën Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH. T. z. Bajram Begaj, si dhe Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, z. Niko Peleshi.

Më tej konferenca vijoi punimet me Raportin vjetor të Grupit Koordinues, Nëngrupi Punues për Kërcënimet Asimetrike dhe Nëngrupi Punues për Trajnime dhe Ushtrime Arsimore. Vlerësimi nga CHOD mbi aktivitetet e GK dhe SWG.

Në konferencë pati diskutime nga CHOD-të mbi temën e konferencës që ishte "Angazhimi i të rinjve në mbrojtje dhe siguri: Promovimi i përfshirjes së të rinjve në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, nxitja e inovacionit dhe adresimi i sfidave të rekrutimit dhe mbajtjes në ushtri". Por gjithashtu u mbajtën prezantime kombëtare (Athinë, Ankara dhe Tiranë).

Fjala përmbyllëse e konferencës u mbajt nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, CHOD gjeneralmajor Arben Kingji.

Në fund u nënshkrua Deklarata e Përbashkët e Konferencës së 17-të BCHOD.

Teksa u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, ministri Peleshi u shpreh se ky vit e gjen Shqipërinë në ballë të një morie angazhimesh rajonale. “Roli i Shqipërisë në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, si dhe kontributi ynë i vazhdueshëm në garantimin dhe ruajtjen e sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon, qëndrojnë të palëkundura. Ne jemi paqedashës dhe të qartë në orientimin tonë drejt familjes perëndimore, ashtu siç jemi forcë shumëfishuese për vlerat dhe dinjitetin njerëzor, në një botë të udhëhequr nga rregullat”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Sipas tij, “Ministria e Mbrojtjes, në koherencë të plotë me politikën e jashtme të qeverisë shqiptare, vijon të ketë në fokusin e saj promovimin e fqinjësisë së mirë, pranimit të njëri - tjetrit, integrimin e plotë Euro-Atlantik dhe forcimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit rajonal, pasi së bashku mund të bëjmë më mirë dhe më shumë për vendet tona dhe rajonin”.



Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi tha se Ballkani i ka përjetuar të gjitha proceset, procese që kanë ndryshuar rrjedhën e historisë, dhe problematikën e të cilave ndihen qartësisht dhe sot. “Historia pa dyshim nuk ka qenë shumë e dashur me ne, por ndërkohë që e kujtojmë atë (pasi ajo nuk mund të harrohet dhe është pjesë e identitetit kombëtar), nuk duhet të mbetemi peng i së shkuarës. Është thelbësore të tejkalohen problemet etnike, kulturore dhe politike që kanë qenë vetëm burim konfliktesh. Unë mbetem shpresëplotë që mësimet i kemi nxjerrë, edhe pse periodikisht, fatkeqësisht, jemi dëshmitarë të akteve terroriste dhe kriminale përqark rajonit tonë dhe shpeshherë dëgjojmë zëra përçarës e zjarr-nxitës.

Prandaj duhet vazhduar me reforma gjithëpërfshirëse që shumë prej vendeve tona kanë përqafuar, ku në qendër janë politika më të sigurta dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e ndërlidhës mes nesh”, - theksoi ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi.

Duke e cilësuar këtë dekadë si 10-vjeçarin e paparashikueshëm, Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje kontributin që Shqipëria dhe Forcat e Armatosura veçanërisht japin përmes misionëve në Kosovë, Bosnje, Letoni, Bullgari, Irak, Detin Mesdhe dhe Egje, Sudanin e Jugut dhe Sinai. Nisur nga tema e kësaj konference “Angazhimi i të rinjve në mbrojtje dhe siguri: Promovimi dhe përfshirja e të rinjve në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, përforcimin e inovacionit dhe sfidat e rekrutimit në ushtri”, ministri i Mbrojtjes z. Peleshi tha se afrimi i sa më shumë të rinjve në Forcat e Armatosura është prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.

Në fjalën e tij përshëndetëse presidenti i Republikës, SH. T. z. Bajram Begaj e cilësoi këtë konferencë si një instrument mjaft të rëndësishëm për bashkëpunimin mes vendeve dhe stabilitetin në rajon. Kreu i Shtetit tha se sfidat e sigurisë janë në rritje çdo ditë, ndaj kjo situatë kërkon Forca të Armatosura të përgatitura.

“Rinia është garancia e së ardhmes. Edukimi i tyre me kulturën e dialogut, respektit reciprok, të pranimit të diversitetit dhe të fqinjësisë së mirë krijon kushtet për një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt. Rinia është e ardhmja e Forcave tona të Armatosura dhe burimi i inovacionit që mund të ndryshojë mënyrën se si ne mendojmë dhe



veprojmë në fushën e mbrojtjes, përfshirja e saj aktive në siguri dhe mbrojtje është e rëndësishme për të nxitur një ndryshim pozitiv dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e strategjive afatgjata”, - u shpreh presidenti Bajram Begaj.

Më tej presidenti Bajram Begaj theksoi se: “Ju si Shefa të Shtabeve të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të vendeve të Ballkanit, jeni kolonat mbi të cilat mbështetet paqja dhe siguria e këtij rajoni. Ne jemi dëshmitarë të një bote që ndryshon me shpejtësi, ku sfidat e sigurisë janë në rritje dhe ndryshojnë çdo ditë.

Nga kërcënimet kibernetike, klimatike deri te krizat humanitare dhe konfliktet rajonale, sot është e rëndësishme që të kemi Forca të Armatosura, të cilat të jenë të përgatitura, fleksibël dhe proaktive. Në veçanti, agresioni i padrejtë rus kundër Ukrainës ka treguar jo vetëm brishtësinë e arkitekturës së sigurisë botërore, por edhe se si po ndryshon vetë arti i luftës. Lufta moderne tashmë nuk është një luftë konvencionale, por ka natyrë hibride dhe asimetrike.

Kemi detyrën dhe misionin historik që Ballkani të shndërrohet në një rajon të integruar, ku të mbizotërojë mirëkuptimi, bashkëpunimi i gjithanshëm, paqja dhe orientimi i palëkundur Euroatlantik. Shqiptarët kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë faktor paqeje, stabiliteti dhe bashkëpunimi. Si anëtare e NATO-s dhe kandidate tashmë me përvojë të gjatë në procesin e anëtarësimit, pavarësisht se ngelemi shumë shpesh në klasë, Shqipëria mbështet çdo iniciativë dhe nismë që krijon kushtet për bashkëpunim, bazuar në fqinjësinë e mirë dhe respektin reciprok. Jemi të vetëdijshëm që kemi ende sfida përpara. Këto sfida tejkalohen duke përmirësuar marrëdhëniet ndërshtetërore, duke zgjidhur mosmarrëveshjet e vjetra përmes diplomacisë aktive, si dhe duke bashkëpunuar më ngushtë në mbrojtjen e përbashkët për të krijuar një rrjet të sigurisë rajonale.

Kam bindjen se Konferenca e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të vendeve të Ballkanit, konferenca juaj, do të vijojë të jetë pararojë në promovimin e bashkëpunimit në funksion të paqes dhe sigurisë. Ju më shumë se kushdo tjetër e njihni vlerën që ka paqja në parandalimin e tmerreve të luftës.

E përshëndes pjesëmarrjen e Kroacisë dhe Sllovenisë si vëzhguese

në këtë konferencë, por ky forum, më lejoni të them, do të ishte akoma më i plotë me pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës. Gjej rastin të përshëndes vendimin e Asamblesë së NATO-s për avancimin e statusit të Kosovës si anëtare të asociuar, si një hap drejt një rajoni më të sigurt dhe më evropian.

E kam theksuar dhe do të vijoj ta theksoj se anëtarësimi i Kosovës në iniciativa dhe organizata ndërkombëtare politike dhe të sigurisë në rajon, por edhe globale, si Karta e Adriatikut A5, do të jetë vlerë e shtuar dhe kontribut i jashtëzakonshëm për paqen dhe sigurinë.

Le të punojmë së bashku, si një rajon i bashkuar, për të përballuar sfidat dhe për të shfrytëzuar mundësitë që na ofron kjo epokë e re, të cilën po e jetojmë”, - përfundoi fjalën e tij presidenti Bajram Begaj.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, duke iu drejtuar homologëve të tij tha: “Të gjitha këto sfida ndaj sigurisë nuk mund të menaxhohen pa një qasje të përbashkët rajonale. Në këtë kuadër forumi ynë qëndron si një mjet i rëndësishëm dhe i përshtatshëm për të përparuar në ndërtimin e respektit dhe besimit reciprok si dhe arritjen e një kuptimi të përbashkët mes nesh”.

Në këtë nismë rajonale vendet pjesëmarrëse ishin: Shqipëria, si vend pritës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Bullgaria,

Turqia, Greqia, Bosnjë - Hercegovina dhe Serbia. Kroacia dhe Sllovenia morën pjesë në cilësinë e vendit vëzhgues të iniciativës.

Qëllimi i iniciativës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit është promovimi dhe forcimi i paqes dhe sigurisë rajonale nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak të vendeve anëtare.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet të rëndësishëm të drejtuesve më të lartë ushtarakë të vendeve të Ballkanit ishin edhe përfaqësues nga Komiteti Ushtarak i BE-së dhe Komanda e Forcës së Bashkuar e NATO-s (JFC) Napoli, Itali.

Si lindi Iniciativa e BCHODs

Më datë 18 prill 2007, Shefat e Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit (Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia, Rumania, Serbia, Shqipëria dhe Turqia) firmosën Termat e Referencës të forumit të BCHODs për bashkëpunimin ushtarak.

Me këtë akt, të gjithë pjesëmarrësit u angazhuan për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, duke zhvilluar bashkëpunimin ushtarak më qëllim rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan, për t'i paraprirë sfidave të mundshme të përbashkëta në rajon. Rritja e bashkëpunimit ushtarak edhe në fushën e edukimit trajnimit dhe stërvitjeve është një ndër temat kryesore të kësaj iniciative.

Konferenca vjetore e BCHODs vlerësohet si një instrument i rëndësishëm për promovimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak. Forumi mund të pranojë anëtarë të rinj vetëm mbi bazën e konsensusit. Si traditë e këtij forumi, Shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të Kroacisë dhe Sllovenisë janë ftuar çdo vit që prej nismës së saj.

Në konferencën vjetore të BCHODs tradicionalisht janë ftuar edhe Kryetari i Komitetit Ushtarak i BE-së, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Komandanti i Komandës Amerikane në Evropë dhe Komandanti i Komandës së Bashkuar të NATO-s në Napoli.

Radha e zhvillimit të konferencave bëhet sipas rendit alfabetik të kryeqyteteve. Gjithashtu, bazuar në rotacionin e organizimit të konferencës pasardhëse, vendi organizator merr Sekretariatit e konferencës dhe përgjigjet për menaxhimin e informacionit, organizimin e takimeve të Grupeve të Punës si dhe përgatitjen dhe organizimin e konferencës së BCHODs.



Helikopterët “Black Hawk” fluturojnë për herë të parë me pilotë shqiptarë

Helikopterët e tipit “Black Hawk” UH-60A+, fluturojnë për herë të parë me pilotë shqiptarë. Personeli i pilotëve të FA-së, teknikëve të bordit dhe atyre të mirëmbajtjes, u certifikuan për kryerjen e detyrave në përfundim të fazës së parë të trajnimit nga instruktorët amerikanë të skuadrës SATMO.

8 pilotë dhe 8 specialistë mirëmbajtje janë kualifikuar në profilet teknik linje, teknik motori, teknik strukture, teknik avionik etj. Ekipi amerikan SATMO, sipas kontratës do të kryejë avancimin e aftësive të pilotëve në modulet transport trupash, fast-rope, bambi bucket, vinç, IFR, dhe natën me NVG.

Nënkolonel Ervin Buzi, ka kryer avancimin operacional për të kryer transport trupash përfshirë këtu menaxhimin e emergjencave si dhe fluturimin me instrumente në kushte të vështira meteorologjike; ndërsa major Klajdi Tushe ka kaluar fazën e menaxhimit të emergjencave, fluturimit vizual dhe më pas do të vazhdojë atë instrumental.

Dy helikopterët e parë UH-60 “Black Hawk” erdhën në Shqipëri në janar të këtij viti, si porosi e parë e vendit tonë, mbështetur me mbi 50 milionë dollarë nga fondet e ndihmës së SHBA-



së. Helikopterët e rinj do të ndihmojnë në forcimin e aftësive të Forcave Ajrore të Shqipërisë dhe aftësinë për të kryer evakuim mjekësor, rikuperim të personelit, misione kërkim-shpëtimi, si dhe mbështetje të lëvizjeve logjistike të NATO-s për operacione dhe stërvitje.



SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti gjenerallejtënant Alexander Sollfrank

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji priti në komandantin e Komandës së Bashkuar të Mbështetjes dhe Mundësimit të NATO-s, gjenerallejtënant Alexander Sollfrank. Në takim ata diskutuan mbi rëndësinë e kësaj komande për mbështetjen e operacioneve të NATO-s dhe ambicien e Shqipërisë për një rol aktiv në këtë drejtim. Gjithashtu në takim u diskutua dhe mbi mundësitë që ofron pozicioni strategjik i vendit tonë, si një portë e rëndësishme rrugëkalimi nga perëndimi në lindje, në sajë të zhvillimit të projektit të Porto Romano-s, infrastrukturës së Korridorit 8-të dhe projekteve të tjera.



SHSHP, gjeneralmajor Arben Kingji priti gjeneralmajor Daniel T. Lasica, drejtor i Planifikimit, Politikave, Strategjisë dhe Kapaciteteve në Komandën Amerikane në Evropë

Drejtori i Planifikimit, Politikave, Strategjisë dhe Kapaciteteve në Komandën Amerikane në Evropë, gjeneralmajor Daniel T. Lasica zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

Fillimisht gjeneralmajor Lasica u prit në një takim nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sh. T. z. Bajram Begaj, për të vijuar më tej me takimin zyrtar me shefin e SHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji.

Gjeneralmajor Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen gjeneralmajor Lasica dhe ekipit që e shoqëronte, vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe në fushën e Mbrojtjes dhe mbështetjen e pakursyer të SHBA-ve për reformimin, transformimin, dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura.

Gjatë takimit një vëmendje e veçantë iu kushtua dinamikave në mjedisin e sigurisë në zonën euroatlantike dhe sidomos në Ballkanin Perëndimor, zhvillimit të koncepteve të shkujtimit dhe mbrojtjes dhe masave të marra nga vendi ynë në kuadër të rishikimit të planeve kombëtare të mbrojtjes dhe harmonizimin me planet rajonale të Aleancës.

Në lidhje me situatën e sigurisë në rajon, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të operacionit KFOR për sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë, si



dhe prezencën dhe angazhimin e SHBA-së në këtë drejtim. Më tej, bashkëbisedimi u fokusua në zhvillimet e fundit në Forcat e Armatosura, përmirësimet strukturore dhe ligjore, rishikimin e dokumenteve strategjike, ecurinë e projekteve të modernizimit, zhvillimin e infrastrukturës ushtarake, kontributin në misione dhe operacione, masat e marra në kuadër të shkujtimit dhe mbrojtjes dhe planeve rajonale, etj.

Po kështu, gjeneralmajor Kingji u ndal në rolin e iniciativave rajonale për promovimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit në rajon, duke përmendur si shembull konkret konferencën e 17-të të Shefave të Shtabit të Ballkanit, të mbajtur në Durrës, më datën 06 qershor 2024, si një mënyrë e mirë për të nxitur stabilitetin dhe sigurinë në rajon nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak.

Gjeneralmajor Lasica vlerësoi bashkëpunimin tonë dypalësh në fushën e Mbrojtjes dhe riafirmoi vullnetin e tij për ta avancuar atë dhe më tej në të ardhmen. Ai theksoi rolin konstruktiv të vendit tonë për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit dhe u shpreh i sigurt se suksesi i konferencës së 17-të të Shefave të Shtabit të Ballkanit do të tejkalohet gjatë konferencës së radhës të Iniciativës së Kartës së Adriatikut, që do të mikpritet nga vendi ynë në datat 17 - 19 shtator 2024.

Në vijim të këtij takimi gjeneralmajor Lasica u prit në një takim nga drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes, z. Gjergji Methoxha, për të vazhduar me takimin me komandantin e Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia dhe personelin amerikan të atashuar pranë kësaj komande.



QPR, 17 vite mobilizim, përkushtim, bashkëpunim

Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Komandant Ciroku, fillimisht ju uroj suksese në drejtimin e Qendrës së Personel Rekrutimit, kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të RSH! Qendra e Personel Rekrutimit është qendra avangardë e FA-së, si e tillë për lexuesin ushtarak, por jo vetëm, së bashku le të ecim mbi rrugëtimin e saj disavjeçar.

I nderuar kolonel Ciroku!

Si nisi rrugëtimi juaj nën uniformën ushtarake?

Pas përfundimit të shkollës së mesme, mua mu dha mundësia që të vijoja studimet e larta në shkollën Ushtarake, në degën AKA dhe pas përfundimit të studimeve në vitin 1989 dhe deri në vitin 2002 shërbeva në detyrën komandant Toge dhe baterie në Divizionin e Shkodrës. Nga viti 2002 e në vazhdim kam kryer detyra të ndryshme në shtab batalioni, në shtab Brigade, në Shtabin e Përgjithshëm, detyrën e Drejtorit të Burimeve njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, detyrën e Atasheut Ushtarak rezident në Poloni dhe jo rezident në Estoni, Letoni, Lituani, Sllovaki dhe Ukrainë. Po kështu për tre vjet shërbeva në detyrën e Komandantit të Qendrës së Bashkuar Operacionale në Shtabin e Përgjithshëm dhe duke filluar nga qershori i vitit 2023 vijoj të kryej detyrën e Komandantit të Qendrës së Personel Rekrutimit.

Gjatë karrierës si ushtarak kam kryer kualifikime të ndryshme si nga ana profesionale ashtu dhe për mësimin e gjuhës së huaj anglisht dhe gjermanisht. Po kështu, si dhe shumë ushtarakë të tjerë, kam marrë pjesë në dy misione paqeruajtëse jashtë vendit në Bosnje-Hercegovinë në vitin 2005 dhe në Afganistan në vitin 2013.

Momenti më i vështirë në karrierën ushtarake ishte maji 2019, kur në bazën Ushtarake Adazi në Letoni, si pasojë e një shpërthimi ra në krye të detyrës Major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj. Unë në detyrën e Atasheut Ushtarak ndoqa të gjithë procedurën për kthimin e trupave në Atdhe.

Çfarë do të thotë për ju të jesh pjesë e Forcave të Armatosura? Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura do të thotë t'i shërbesh atdheut.

Kur e ka filluar aktivitetin Qendra e Personel Rekrutimit?

Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) e filloi veprimtarinë e saj, më 22 qershor të vitit 2007, e krijuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 98, datë 22.06.2007, "Për miratimin e organikës analitike (TOP), të Qendrës së Personel Rekrutimit", u krijua QPR, koduar me Repartin Ushtarak nr. 4600, në vartësi të Komandës Mbështetëse, dhe e vendosur në garnizonin "Skënderbej". Në strukturën e saj, kishte personel prej 32 vetash si dhe 12 Qendra Rekrutim-Mobilizimi në qarqe, të cilat u transformuan në seksione rekrutimi në vitin 2012. QPR ka kaluar në vartësi të SHP në vitin 2010.



Kolonel Fadil Ciroku,
Komandant i Qendrës së Personel Rekrutimit të FA

Në strukturën organike të QPR-së, në vitin 2012 u krijua Sektori i Trajtimin Financiar të Ushtarakëve në rezervë/lirim sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

Në strukturën organike të vitit 2014 u suprimuan seksionet e rekrutimit në qarqe dhe u krijua Sektori i Rekrutimit, me 2 seksione, 1 zyrë pritje pranë QPR-së.

Në strukturën e vitit 2017, si rezultat i kërkesave të Ligjit nr. 9047, datë 10.7.2003, "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe VKM nr. 103 datë 10.02.2016, "Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme", u bë

riorganizimi i strukturës së Qendrës së Personel Rekrutimit në interes të realizimit të misionit dhe detyrave themelore të saj.

Në strukturën e re të miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 43 datë 19.01.2017, "Për miratimin e Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve të Repartit Ushtarak nr. 6670, krahas rikompozimit të sektorëve u krijua struktura e Qendrës së Rekrutim-Mobilizimit, e cila kishte në përbërje: Sektorin e Pritjes dhe Testimit; Sektorin e Rekrutimit për Oficer, Ushtar, Rezervë për Forcat/Komandat, me 6 seksione; Sektorin e Rekrutimit për Oficer, Ushtar, Rezervë në Qark/Rreth, me nga një seksion në 12 Qarqe.

Në strukturën organike të vitit 2023 u krijua "Sektori i Mbrojtjes" si domosdoshmëri e procesit të rekrutim mobilizimit, si dhe u krijuan disa funksione shtesë për ofrimin e shërbimit online nëpërmjet platformës "e-Albania", për realizimin e procedurës së përpunimit të dokumentacionit për përkujdesje e përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim si dhe procesit të rekrutimit në Forcat e Armatosura.

Cili është misioni i Qendrës së Personel Rekrutimit?

Kryen rekrutimin e kandidatëve për oficerë dhe ushtarë/detarë aktiv, përpunimin, administrimin e dokumentacionit dhe të të dhënave individuale të ushtarakëve aktivë, në rezervë/lirim dhe atij civil, përpunimin e dokumentacionit për përkujdesje e përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim, ofrimin e shërbimeve, aplikimet e të cilave kryhen nëpërmjet platformës "e-Albania", evidentimin e burimeve njerëzore dhe materialeve që do të mobilizohet gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme.

Detyrat:

- Rekruton kandidatë për oficerë të rinj, ushtarë/detarë aktivë në Forcat e Armatosura, rekruton kandidatë për ndjekjen e studimeve në institucionet e larta arsimore brenda/jashtë vendit sipas planit të miratuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.
- Përgjigjet për standardizimin, automatizimin, administrimin dhe përditësimin e të dhënave të personelit aktiv në Forcat e Armatosura dhe atij në rezervë/lirim;
- Realizon procedurat e përpunimit të dokumentacionit për trajtimin financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim;
- Zbaton procedurat lidhur me shërbimet, aplikimet e të cilave kryhen nëpërmjet platformës "e-Albania";
- Mbështet me të dhëna personelin, komandat, drejtoritë në MM/SHP dhe komisionet e karrierës;
- Kryen shërbime ndaj qytetarëve për pajisjen me vërtetime për kryerjen shërbimit ushtarak aktiv (SHDU), si dhe ndaj ish-ushtarakëve për plotësimin e dokumentacionit për pension pleqërie e suplementar;
- Planifikon dhe organizon aktivitetet promovionale dhe informuese në mbështetje të aktiviteteve të FARSH për rekrutimin;
- Zbaton planin e rekrutim-mobilizimit, të personelit të shërbimit ushtarak në rezervë, për zhvillimin e stërvitjeve dhe të veprimtarive të tjera;
- Bën identifikimin, sigurimin e personelit të nevojshëm për shërbimin ushtarak në rezervë dhe plotësimin e njërive dhe reparteve të Forcave të Armatosura me personel rezervist;
- Bën hartimin dhe përditësimin e listës emërore të personelit ushtarak në rezervë;
- Realizon në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse, lajmërimin e ushtarakëve të shërbimit ushtarak në rezervë, në rast aktivizimi, stërvitje dhe mobilizimi.

Çfarë shërbimesh ofron Qendra e Personel Rekrutimit?

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, Qendra e Personel Rekrutimit, bazuar në misionin dhe detyrat themelore, ofron ndaj shtetasve dhe institucioneve, në mënyrë elektronike nëpërmjet

platformës "e-Albania", 7 (shtatë) shërbime, si më poshtë:

1. Aplikim për rekrutim në Forcat e Armatosura.

Ky shërbim ofrohet për shtetasit e Republikës së Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura si oficer apo ushtar/detar aktiv, në bazë të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

2. Kopje të dokumentacionit të dosjes personale për ish-ushtarakët dhe civilët e Forcave të Armatosura.

Ky shërbim ofrohet për shtetasit të Republikës së Shqipërisë për t'u shfrytëzuar nga vetë ata dhe për t'u paraqitur në institucionet brenda dhe jashtë vendit për arsye pune apo përfitime në vjetërsi shërbimi, punësimi, pensioni, etj., mbështetur në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores "Për administrimin dhe përmbajtjen e dosjes të personelit në FA", miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1383, datë 27/08/2015.

3. Vërtetim i Pagesës Kalimtare për periudhën 1992-2000 ose për periudhën në vazhdim.

Ky shërbim iu mundëson Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe ish-ushtarakëve vërtetime për periudhat e trajtimit me pagesë kalimtare sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të policisë së shtetit, të gardës së Republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 "Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009", të ndryshuar.

4. Vërtetim karriere ushtarake.

Ky shërbim iu ofrohet ish-ushtarakëve dhe përfshin, periudhën e Arsimit të Lartë Ushtarak, datën e titullimit ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura, detyrat që ka kryer, datën e daljes në rezervë/lirim, mbështetur në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores "Për administrimin dhe përmbajtjen e dosjes të personelit në FA", miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1383, datë 27/08/2015.

5. Vërtetim për efekt pensioni, vjetërsi shërbimi, invaliditeti ose familjar.

Ky shërbim iu mundëson Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ish-ushtarakëve dhe përfshin: Shërbimin e Detyrueshëm Ushtarak Aktiv, Arsimin e Lartë Ushtarak, stazhin dhe periudhën nga data e titullimit deri në datën e daljes në rezervë/lirim si dhe trajtimin me pagesë kalimtare sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të policisë së shtetit, të gardës së Republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 "Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009", të ndryshuar.

6. Vërtetim për vjetërsi në punë si ish-punonjës civilë në Forcat e Armatosura.

Ky shërbim ofrohet për punonjësit civilë që kanë punuar në Forcat e Armatosura dhe përfshin periudhën e punësimit në Forcat e Armatosura, duke evidentuar datën e fillimit dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores "Për administrimin dhe përmbajtjen e dosjes të personelit në FA", miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1383, datë 27/08/2015.

7. Vërtetim të kryerjes/moskryerjes së Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak Aktiv.



Ky shërbim ju ofrohet shtetasve të Republikës së Shqipërisë për ta paraqitur në institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për arsye pune, apo për përkujdesje e përfitime suplementare.

8. Regjistra themeltarë: 2 330

9. Kartona evidence: 1 146 631

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha të këtij institucioni?

Grumbullimi i dosjeve të të gjithë ushtarakëve në rezervë nga strukturat e FA-së; Sistemi i dokumentacioni, individualizimi i tyre si dhe krijimi i kushteve më rregullat e administrimit të dokumentacionit; Grumbullimi i regjistrave themeltarë dhe kartona evidence të shërbimit të detyrueshëm aktiv nga 12 qarqet e RSH, si dhe evidentimi në sistem elektronik në një databazë nga ku përpunohet dhe përgatiten vërtetimet për kryerje/moskryerje të shërbimit të detyrueshëm; Kalimi në shërbimin online me 148 920 shërbime të ofruara për periudhën 2023-2024; Ridislokimi i zyrave të seksioneve të rekrutimit nga repartet ushtarake në zyra të reja.

Cila është qasja juaj për arritjen e objektivave të QPR-së?

Përkushtim, përgjegjësi, disiplinë dhe mbështetje për vartësit; Bashkëpunimi me Strukturat e Forcave të Armatosura si dhe bashkëpunimi me Njësitë e qeverisjes vendore Bashki/Njësi Administrative, me institucionet arsimore publike dhe jo publike, me zyrat e punës dhe me çdo institucion tjetër për të mundësuar promovimin e Forcave të Armatosura si dhe informimin e qytetarëve mbi mundësit që FA-ja ofron për të rinjtë dhe të rejtat që dëshirojnë të bëhen pjesë e FA-së.

Si rekrutohen ushtarët aktivë?

Një kandidat duhet të plotësojë disa kritere të përcaktuara në udhëzimin për rekrutimin, ku mund të përmendim: moshë, aftësia fiziko-shëndetësore, plotësimi i kushtit të sigurisë.

QPR zhvillon 3 fushata rekrutimi në vit, duke zhvilluar takime informuese në strukturat e qeverisjes vendore..., zhvillon aktivitete promovuese në qendrat e qyteteve dhe në strukturat ushtarake të FA-së, takime më nxënës dhe studentë pranë institucioneve arsimore, si dhe çdo aktivitet të organizuar nga Ministria e Arsimit (work&study), panaire të organizuara nga struktura të tjera shtetërore dhe jo vetëm.

Informimi i të interesuarve nëpërmjet rrjeteve sociale zyrtare të MM, SHP, QPR, nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar si dhe faqes zyrtare të MM në adresën mod.gov.al.

Çdo kandidat ka disa mundësi për të bërë aplikimin siç janë: në elektronik nëpërmjet portalit e-Albania, seksionet e rekrutimit në qarqet e vendit. Kandidati dorëzon dokumentacionin e kërkuar dhe njoftohet nga QPR për datat e kryerjes së testeve dhe kontrollit shëndetësor. Kandidatët i nënshtrohen procesit të testeve: fizik, intelektual, psikologjik dhe shëndetësor.

Kandidatët e shpallur fitues ndjekin kursin e stërvitjes Individuale Bazë, ku në fund të këtij kursi certifikohen dhe titullohen Ushtar Aktiv. Më pas vijon karrierën ushtarake duke shërbyer në strukturat e FA-së.

A kanë interes të rinjtë shqiptarë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura?

Nisur nga ndryshimet ligjore të miratuara në vitin 2024, ku në lidhje me rekrutimin u rrit moshë nga 27-30 vjeç, nga fakti i rritjes së pagave në Forcat e Armatosura si dhe benefiteve të tjera që ofrohen për ushtarakët në FA, në vitet e fundit ka një interesim të shtuar nga të rinjtë shqiptar për të shërbyer në FA.

Cilat janë benefitet e të qenit pjesë e Forcave të Armatosura?

- Punë të garantuar.
- Pagesa në rritje pagë/gradë.
- Trajtim me ushqim ose kompensim në lekë (733 lekë/ditë) rreth 16000 në muaj.
- Transport falas nga qendra e banuar në repartet ushtarake dhe kthim.
- Mundësi strehimi (kredi të buta për ushtarakët, të ndarë në dy kategori: nga MM me 3% dhe me programet e Qeverisë me 0%).
- Leje e paguar vjetore (30 ditë U/D aktiv dhe 45 ditë për oficerë/nënoficerë).
- Mundësi për të pushuar në shtëpitë e pushimit (Durrës, Vlorë).
- Infrastrukturë për të zhvilluar aftësitë fizike (fusha sportive, palestra).
- Përkujdesje shëndetësor për ushtarakët dhe familjet e tyre.
- Mundësi për të marrë pjesë në përfaqësitë ushtarake apo misione paqeruajtëse të drejtuara nga OKB/BE/NATO, ku mund të përmendim misionet në Letoni, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, Bullgari, detin Egje (pagesë ekstra për këtë periudhë deri 12.000 lekë/ditë, dhe llogaritje e kohës me 1,5 fish).
- Përfitime suplementare nga statusi i ushtarakut sipas Ligjit Nr.9210, datë 23.3.2004 i ndryshuar si dhe me ligjin nr. 10142, për sigurimet Shoqërore suplementare që kanë të bëjnë me: Trajtim me 50% të pagës për një periudhë 2 vjeçare pas daljes në lirim/rezervë; Për ushtarakët që plotësojnë 12 vjet shërbim në FA për femrat dhe 15 vjet shërbim në FA për meshkujt, trajtohen me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga moshë 47 deri në moshën e daljes në pension pleqërie; Pas daljes në pension pleqërie ushtarakët përfitojnë pension suplementar mbi pensionin e pleqërisë për vitet e shërbimit në FA.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, pjesë e takimit të zëvendësshefave të SEDM-it, të zhvilluar në Stamboll

Në kuadrin e iniciativës së SEDM-it (South-Eastern Europe Defense Ministerial) kryesuar nga Rumania, në Stamboll u zhvillua takimi i Zëvendësshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore anëtare të SEDM-it, ku Turqia ishte në rolin e vendit pritës. Ky është një takim i përvitshëm, që ka për qëllim për të promovuar bashkëpunimin konstruktiv ushtarak rajonal në Evropën Juglindore (EJL), me qëllim të rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit, stabilitetit, besimit dhe sigurisë në rajon e më gjerë. Vitin e kaluar ky takim u zhvillua në Romë të Italisë.

Në këtë takim morën pjesë zëvendësshefat e Shtabit të Përgjithshëm nga shtetet anëtare të SEDM-it. Republika e Moldavisë ishte pjesëmarrëse për herë të parë, jo më si vëzhguese, por si anëtare me të drejta të barabarta e kësaj iniciative.

Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Kapiten i Rangut të Dytë Bedo Merruko, oficer shtabi në Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, gjeneral İrfan Özsert, në rolin e vendit pritës, iu uroi mirëseardhjen në takim të gjithë pjesëmarrësve.

Pastaj fjalën e mori drejtuesja e takimit, nga Rumania, znj. Violeta Nicolescu, drejtoresha e Sekretariatit të SEDM, e cila, pasi falënderoi vendin pritës për organizimin e takimit, vlerësoi arritjet e kësaj iniciative dhe përgëzoi pjesëmarrësit për punën e bërë dhe finalizimin e “Deklaratës së Përbashkët” (Joint Statement).

Takimi vijoi me hapësirën për deklaratat e vendeve pjesëmarrëse të iniciativës për dhënien e qëndrimeve të tyre politiko-ushtarake për situatën e sigurisë rajonale dhe më gjerë. Gjatë dhënies së deklaratave të vendeve pjesëmarrëse u vu re se të gjitha shtetet dënuan agresionin e Rusisë dhe mbështetën unanimisht integritetin territorial të Ukrainës.

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Manushaqe Shehu në fjalën e saj, pasi falënderoi vendin pritës për organizimin dhe ecurinë e iniciativës nën drejtimin e Rumanisë (2023 – 2025), shprehu vendosmërinë e FARSH-së dhe Republikës së Shqipërisë për vijimin e bashkëpunimit rajonal në fushat e edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta. Gjithashtu ajo shprehu qëndrimin e vendit tonë kundër agresionit të



paprovokuar të Rusisë ndaj Ukrainës, si dhe vijimin e mbështetjes së Ukrainës deri në sigurimin e plotë të integritetit territorial të saj.

Gjithashtu ajo theksoi se rajoni ynë është në një rrezik të vazhdueshëm ndaj influencës Ruse dhe si rrjedhojë vendet e rajonit tonë duhet të tregojnë vullnetin e tyre të përbashkët për t'u përballur me sfidat dhe kërcënimet e mundshme.

Më pas Komandanti i SEEBRIG-ut, gjeneral brigade Bilbil Bitri vijoi me pasqyrimin e aktiviteteve kryesore të realizuar nga SEEBRIG, si dhe aktivitetet në vijim që prej marrjes së drejtimit të SEEBRIG-ut nga vendi ynë prej muajit gusht 2023. Një prej sfidave kryesore të SEEBRIG-ut, e cila është në fokusin e momentit, është integrimi i kësaj strukture me strukturat e NATO-s, duke bashkëpunuar në fushën e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Më pas pjesëmarrësit diskutuan edhe finalizuan “Deklaratën e Përbashkët” (Joint Statement), e cila u miratua unanimisht nga të gjithë pjesëmarrësit.

Në “Deklaratën e Përbashkët” vendet anëtare vlerësuan punën e bërë nën drejtimin e Rumanisë dhe dënuan unanimisht agresionin e vazhdueshëm të Rusisë ndaj Ukrainës. Theksi u vu në bashkëpunimin dhe qëndrimet e përbashkëta ndaj problematikave rajonale si rruga dhe forca e vërtetë e këtij forumi me synimin integrimin euro-atlantik të rajonit.

Takimi i ardhshëm u vendos të zhvillohet në Sofje, Bullgari gjatë muajit qershor 2025.



ZVSHSHPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu zhvilloi vizitë zyrtare në Pentagon të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, së bashku me kolonel Arben Toska me detyrë zëvendëskomandant i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kreu një vizitë zyrtare në Pentagon në Uashington DC të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Gjatë vizitës gjenerale Shehu u shoqërua nga atasheu ushtarak i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kolonel Flori Suli. Gjenerale Shehu dhe delegacioni që e shoqëronte u prit në takime të veçanta nga: gjeneralmajor Jami C. Shawley, drejtorë e J5 për Iniciativat Strategjike; znj. Sandy Long, këshilltare e Lartë në fushën e Eksporteve të Armatimeve dhe Pajisjeve Ushtarake; gjenerallejtënant Laura Potter, drejtorë e Shtabit të Forcave të Armatosura në Pentagon.

Në këto takime u bisedua rreth zhvillimeve aktuale të sigurisë globale dhe në rajon; Zhvillimi dhe modernizimi i kapaciteteve të Forcave të Armatosura; kontributi i Shqipërisë në NATO dhe operacionet e drejtuara nga SHBA; Disponueshmëria e infrastrukturës kombëtare në dispozicion të NATO-s dhe SHBA; Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara "Gruaja, Paqja dhe Siguria", etj.

Në fjalën e saj gjenerale Shehu, pasi i falënderoi për ftesën për të qenë në krye të delegacionit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së shqiptare në këtë vizitë të rëndësishme, përmendi bashkëpunimin e shkëlqyer të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku theksin e vuri në bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe konkretisht në fushat kryesore si të: edukimit, trajnimit dhe stërvitjes, arsimit ushtarak, transformimit dhe modernizimit të FARSH-së, asistencës teknike për përgatitjen e dokumenteve kryesorë strategjikë, krijimit dhe mbështetjes së iniciativave rajonale, binjakëzimit me New Jersey National Guard, programit të asistencës humanitare, bashkëpunimit për sigurinë, binjakëzimit të AFA-së me Akademinë e "West Point", etj.

Në takimin me gjeneralmajor Jami C. Shawley, me detyrë drejtorë e J5 për Iniciativat Strategjike Gjatë takimit u fol për situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, situatën aktuale në Ukrainë dhe mbi konfliktin në Lindjen e Mesme. Implikimet e ndërhyrjes së Rusisë, Iranit në vendin tonë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Gjenerale Shehu falënderoi mbështetjen që SHBA-ja ka dhënë në përballimin e sulmeve kibernetike intensive Iraniane ndaj sistemeve dhe portaleve Qeveritare, si dhe vlerësoi rëndësinë e pranisë së SHBA-ve në Shqipëri dhe Rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në takim u theksua dhe u vlerësua roli i FARSH-ve në misionet e

ndryshme të drejtuara nga SHBA-të, NATO, BE dhe UN, ndihma e dhënë nga FARSH për Ukrainën, Prezenca e KFOR-it dhe e SHBA-ve në rajon dhe më gjerë.

Në takimin me znj. Sandy Long, Këshilltare e Lartë në fushën e eksporteve të Armatimeve dhe pajisjeve Ushtarake

Një takim të veçantë gjenerale Shehu pati me Zonjën Sandy LONG, e cila është Drejtuesja e Zyrës së Eksporteve të armatimit dhe pajisjeve ushtarake të SHBA-ve si dhe është Këshilltare e Lartë për Zyrën e Eksportit të Mbrojtjes të Zëvendës Ndhmës Sekretarit të Mbrojtjes për Eksportet e Mbrojtjes dhe Bashkëpunimin.

Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimin e programeve të mbrojtjes dhe projekteve të modernizimit për rritjen kapaciteteve të FARSH,

në kuadër të angazhimeve të FA-së në operacionet e NATO-s dhe me ato të drejtuara nga SHBA. Mbi prioritetet dhe përparësitë për realizimin e Objektivave të Kapaciteteve që FARSH ka në kuadër të angazhimeve me NATO-n si: Grup-batalioni i Këmbësorisë së Lehtë, rritja e aftësive të Mbrojtjes Kibernetike, projekti i helikopterëve shumërolësh "Black Hawk", etj.

Gjenerale Shehu, falënderoi znj. Sandy LONG për ndihmën dhe mbështetjen e pakursyer që SHBA-të, i kanë dhënë FARSH-ve.

Në takimin me gjenerallejtënant Laura Potter, drejtorë e Shtabit të Forcave të Armatosura në Pentagon

Takimi u fokusua kryesisht në historinë e marrëdhënieve dypalëshe SHBA - Shqipëri, mbështetja dhe kontributi i çmuar që SHBA-

ja i ka dhënë Shqipërisë gjatë gjithë procesit të demokratizimit të vendit dhe veçanërisht të transformimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura nëpërmjet ekipeve, ekspertëve dhe zyrës së ODC në Tiranë.

Gjithashtu u diskutua për rolin e femrës në Forcat e Armatosura, mbi rezolutën 1325 të OKB "Women Peace and Security".

Gjenerale Shehu së bashku me personalitet që e pritën në takime, vunë në dukje bashkëpunimin e shkëlqyer mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, vlerësuan ndihmën e dhënë nga SHBA në fushën e arsimit, trajnimit, stërvitjeve dhe pjesëmarrjes

në misione të përbashkëta, mbështetjes logjistike, kibernetike, modernizimit të FA-së dhe rritjen e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen në dobi të paqes e sigurisë në Rajonin e Ballkanit dhe atë globale dhe në modernizimin e Forcave të Armatosura.

Si përfundim vizita ishte shumë e suksesshme dhe i shërben rritjes dhe forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të shkëlqyera mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Përballja me zjarret, Peleshi: Mirënjohje për përkushtimin e paçmuar të çdo efektiv të Forcave të Armatosura

4 vatra aktive zjarri ishin në të gjithë territorin e vendit. Problematikë mbetej situata e zjarrit në Balgjaj në fshatin Kurdari. Forcat operacionale nën koordinimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile vijojnë të mbanin nën kontroll situatën, për të shmangur rrezikun pranë një stani me bagëti e dhjetëra koshere bletësh.

Në fshatin Madhesh, njësi administrative Ulëz në Mat, zjarri i rënë mori përmasa të menjëhershme dhe avancoi në drejtim të fshatit Stojan. Veç forcave operacionale në terren shkuan në ndihmë edhe helikopteri "Cougar".

Vijoi ndërkafq edhe operacioni për shuarjen e flakëve në vatrën e zjarrit të rënë në Buza Dede mbi fshatin Gurë-Lurë, ku flakët ishin pranë liqeneve të Lurës.

Era e fortë vështirësoi aksionin për shuarjen e zjarrit edhe në vatrën e regjistruar një ditë më parë midis malit të Xhyrës dhe njësisë administrative Qukës në bashkinë e Përrenjasit.

Të gjitha forcat operacionale u shpërndanë me grupe në zona të ndryshme për të krijuar një perimetër për të ruajtur vijën e zjarrit ekzistues dhe për të fikur çdo aktivizim në kufijtë e zjarrit dhe në thellësi të tij.

Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile në AKMC, në Qarkun e Dibrës vijoi puna nga terreni dhe ajri për shuarjen e zjarrit të rënë në fshatin Kurdari, bashkia Klos. Vatra e zjarrit në Balgjaj të fshatit Kurdari u zhvillua në dy vatra, njëra prej të cilave u vu nën kontroll.

Një prej vatrave u zhvillua në drejtim të liqeneve të Balgjajt, Kurdari në sipërfaqe me filiza pishe e ahu, por u mbaj pjesërisht nën kontroll. Për fikjen e zjarrit u angazhuan 23 forca dhe helikopteri i FA-së. Nuk u rrezikuan banesa.

Vijoi puna për shuarjen e zjarrit të rënë në Buza Dede mbi fshatin Gurë-Lurë, bashkia Dibër, me dy vatra zjarri aktive, njëra në kullotë, ndërsa vatra tjetër po zhvillohet në pyll me ah në vendin e quajtur Plehenaj, ku zjarri u zhvillua shumë aktiv i ndihmuar nga temperaturat e larta, era e fortë si dhe mbetjet e thata të grumbulluara ndër vite. Efektivë zjarrfikës, forca nga Administrata e Zonave të Mbrojtura, forca bashkiake e vullnetare po punojnë për vënien nën kontroll të flakëve.



Po ashtu në qarkun e Elbasanit, midis malit të Xhyrës dhe njësisë administrative Qukës, bashkia Përrenjas, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me ah, dëllinjë dhe panjë. Punonjësit në terren izoluan vatrën e zjarrit dhe e mbajtën atë nën kontroll, por për shkak të sasisë së madhe të humusit zjarri në brendësi vazhdon dhe ka forcë. 25 efektivë të FA-së u përfshirë në këtë aksion, duke vënë nën kontroll flakët, por vazhdon puna për ta mbajtur atë të izoluar. Ndërkafq është fikur një vatër e raportuar në malin e Trushnicës, në Tepelenë, por po mbahet në monitorim nga forcat bashkiake për të mos u riaktivizuar.

Situatë e vështirë zjarresh edhe në fshatin Kakodhiq të bashkisë





Delvinë për izolimin e plotë të vatrës, i cili ishte vazhdimi i zjarrit masiv që kish përfshirë fshatin Kardhikaq në bashkinë Finiq. Në vendngjarje operuan forcat zjarrfikëse të bashkisë Delvinë dhe efektivët e Forcave të Armatosura.

Po ashtu Forcat e Armatosura izoluan vatrën e zjarrit pranë liqeneve të Lurës, në fshatin Gurë - Lurë të bashkisë Dibër, vazhdim i zjarrit të rënë në një sipërfaqe me pisha. Në terren efektivët zjarrfikës të bashkisë Dibër, forca nga administrata e Zonave të Mbrojtura, Shërbimi Pyjor e forca bashki-ake si dhe 50 efektivë nga Forcat e Armatosura. Ju lutemi banorëve të bëjnë kujdes! Ligji parashikon dënim të rëndë për të gjithë ata që ndezin zjarre dhe do të zbatohet për çdokënd, pa dallim! Pas një pune të pandërprerë forcat e Emergjencave Civile, nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile kanë bërë të mundur shuarjen e zjarrit në bashkinë Dropull, ku situata po vazhdon të monitorohet për të shmangur çdo mundësi riaktivizimi.

Në fshatin Kakodhiq në bashkinë e Delvinës po vijon aksioni me forcat e bashkisë, efektivët e Forcave të Armatosura, forca shtesë zjarrfikësish nga Berati, por edhe dy avionë PZL nga Greqia, për shuarjen e flakëve.

Po ashtu operacioni vazhdon edhe pranë liqeneve të Lurës në Dibër.

Mirënjohje të gjithë efektiveve të angazhuar si dhe autoriteteve greke që po asistojnë me dy avionët tip PZL në shuarjen e flakëve në fshatin Kakodhiq!

Përsërisim thirrjen për kujdes të shtuar gjatë këtyre ditëve me temperatura të larta, në mënyrë që të shmangen ngjarje që dëmtojnë mjedisin dhe pasurinë tonë të përbashkët!

Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), gjatë 24 orëve të fundit janë raportuar 14 vatra zjarri, nga të cilat janë shuar 11 vatra dhe janë aktive 3. Sot puna po vijon në bashkinë Delvinë, ku është aktive vatra e zjarrit sipër Manastirit dhe fshatit Kakodhiq.

Në bashkinë Gjirokastrë, efektivët e Forcave të Armatosura dhe ato të emergjencave vendore kanë nisur punën prej orëve të para të mëngjesit për shuarjen e vatrave të zjarrit

mbi Malin e Gjerë, ku flakët kanë një shtrirje 10-12 km dhe janë të shpërndara në 3 vatra.

Po ashtu po punohet për shuarjen e zjarrit të rënë dje, pranë

liqeneve të Lurës, në fshatin Gurë - Lurë të bashkisë Dibër, ku ndërhyrja paraqet vështirësi për shkak edhe të terrenit shkëmbor. Të gjitha kapacitetet në nivel vendor dhe qendror, efektivët zjarrfikës, efektivët e Forcave të Armatosura, forcat bashki-ake, forcat policore, punonjës të administratës së Zonave të Mbrojtura, punonjës të Shërbimit Pyjor, forca vullnetare janë në gatishmëri të plotë për mbajtjen nën kontroll të situatës.

Përballja me zjarret në këto temperatura të larta dhe terrene të vështira është një nga sfidat e mëdha të Forcave të Armatosura në këta muaj të nxehtë.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ndau sot dëshminë e kolonel Dritan Durmishaj, i cili është vetëm njëri nga ushtarakët e shumtë që sakrifikojnë çdo ditë në shërbim të vendit dhe qytetarëve.

“Mirënjohje për përkushtimin e paçmuar të çdo efektivi të angazhuar në këtë detyrë, për ndjenjën e përgjegjësisë dhe humanizmit dedikuar mbrojtjes së jetës së qytetarëve tanë, pronës së tyre dhe natyrës së vendit tonë”, - u shpreh Peleshi.

Kolonel Durmishaj shpjegoi se çdo mision kërkon përgatitje: “Mbase për ata që janë jashtë aviacionit duket shumë e thjeshtë, por për pilotët dhe teknikët duhet një kohë e caktuar që të përgatiten, të gjendet terreni ku do të fluturojë.

Për mjetin ajror, sa më lart të jetë terreni, aq më e vështirë është për të kryer operacionin për shkak të ngarkesës dhe kushteve meteorologjike”, - u shpreh ai.

Kolonel Durmishaj flet edhe për misionin e fundit: “Morëm një thirrje nga AKMC për një fshat në Klos, ku një masiv pyjor kishte marrë zjarr dhe për shkak të terrenit shumë të vështirë malor dhe të thepisur kërkohej edhe ndërhyrja e mjeteve ajrore. Me të marrë sinjalin, ekuipazhet u përgatitën dhe filluan detyrën, duke ndihmuar forcat zjarrfikëse, të cilat ndodheshin në terren”, - tha ai.



Qendra shëndetësore ROL-1 e BKL-së përfundon me sukses stërvitjen vetëvlerësuese “MEDEVAL”

Në vijimësi të trajnimeve për vlerësimin NATO “MEDEVAL”, Qendra Shëndetësore Rol-1 e BKL-së nën drejtimin e trajnuesve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it kreu stërvitjen e vetëvlerësimit.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte vetëvlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe materialeve mjekësore të Qendrës Shëndetësore Rol-1 e BKL-së, në kuadër të vlerësimit NATO “MEDEVAL”.

Gjatë vetëvlerësimit u testuan aftësitë e personelit mjekësor për dhënien e ndihmës së parë mjekësore, evakuimi i pacientëve nga vendi i dëmtimit në pikën e grumbullimit të të dëmtuarve, evakuimi i të dëmtuarve nga pika e grumbullimit të të dëmtuarve në qendrën shëndetësore fushore Rol-1, triazhimi i tyre, stabilizimi dhe evakuimi për Rol-2 ose Rol-3, në varësi të gravitetit të dëmtimit. Gjithashtu u testuan aftësitë e personelit mjekësor në situatë të jashtëzakonshme; si MASKALL dhe dhënia e ndihmës së parë të dëmtuarve me kontaminime biokimike.

Krahas testimit të aftësive profesionale të personelit mjekësor u vlerësua dhe mënyra e plotësimit të dokumentacionit si: nëntë linjat e evakuimit mjekësor, kartela shoqëruese e të dëmtuarit nga vendi i dëmtimit në qendrën shëndetësore Rol-1, kartela mjekësore e mbajtur gjatë kohës së stabilizimit, si dhe kartela shoqëruese për në nivelet më të larta mjekësore Rol-2 dhe Rol-3.

Personeli mjekësor i QSH-së të BKL-së, gjatë stërvitjes tregoi përkushtim dhe profesionalitet të lartë gjatë zbatimit të detyrave në të gjithë skenarët e improvizuar të stërvitjes. Trajnuesit e Gardës Kombëtare të New Jersey-it u shprehën të



kënaqur nga progresi i personelit mjekësor në dhënien e ndihmës së parë, stabilizimin dhe evakuimin e të dëmtuarve. Gjatë zhvillimit të kësaj stërvitjeje krahas situatave të improvizuara sipas skenarëve

të hartuar nga trajnuesit, në qendrën shëndetësore u zhvilluan vizita mjekësore reale për ushtarakët që patën probleme shëndetësore, si dhe për popullsinë civile të zonës.



Efektivat e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut dhurojnë gjak për fëmijët talasemikë dhe njerëzit në nevojë

Pasi përfunduan me sukses stërvitjen 3-shkallëshe “Përpyekja e Përbashkët -24”, efektivët e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut, Poshnjë, Berat, në mbështetje të fushatës së Dhurimit Vullnetar të Gjakut, ditën e djeshme iu bashkuan nismës “Dhuro Gjak – Shpëto Jetë”, për dhurim vullnetar të gjakut, në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe njerëzve në nevojë.

Dhurimi i gjakut për njerëzit në nevojë u krye në bashkëpunim me Bankën e Transfuzionit të Gjakut dhe nën kujdesin e mjekëve të Qendrës Shëndetësore të Forcës Tokësore.

Me anë të këtij kontributi, efektivët e Forcës Tokësore solidarizohen me përpjekjet e të sëmurëve që luftojnë për jetën. Kjo nismë do të vijojë në ditët në vazhdim edhe në strukturat e tjera të Forcës Tokësore.



Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia mori pjesë në konferencën e 31-të të Komandantëve të Forcave Tokësore europiane

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, mori pjesë në Konferencën e 31-të të Komandantëve të Forcave Tokësore Evropiane (CEA), që u zhvillua në Garmisch-Partenkirchen, Gjermani. Qëllimi i kësaj konference ishte të sigurojë një mundësi për diskutime të hapura ndërmjet komandantëve të Forcave Tokësore lidhur me çështjet kritike të sigurisë dhe ato ushtarake. Krahas programit të konferencës, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Xhebexhia, zhvilloi takime bilaterale me përfaqësues të US Army Europe and Africa dhe përfaqësues të palës greke. Takimet u zhvilluan në një frymë të lartë mirëkuptimi me qëllim bashkëpunimin në sfidat e sigurisë, trajnimit të personelit si dhe stërvitjeve të përbashkëta në rajon dhe më gjerë.



Forca Tokësore zhvillon analizën e 6 - mujorit të parë të vitit 2024

Në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua analiza e realizimit të detyrave për 6 mujorin e parë të vitit 2024. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, shefat e degëve në Shtabin e Forcës Tokësore si dhe komandantët e reparteve vartëse.

Analizën e hapi shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, i cili bëri prezantimin e materialit të analizës 6 - mujore, evidentoi realizimin e detyrave nga efektivat dhe degët në shtabin e FT-së, objektivat e arritura gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024, problemet e hasura dhe mënyra e zgjidhjes së tyre. Gjithashtu, ai vuri theksin në prioritetet e Forcës Tokësore për vitin 2024 në modernizim dhe në krijimin e kushteve për kryerjen e një stërvitje të efektive në kushte sa më reale me ato të fushës së luftimit.

Më tej, analiza vijoi me diskutimet e te pranishmeve, ku doli në pah mobilizimi i efektiveve të FT-së për realizimin e stërvitjeve dhe rritjen e aftësive profesionale.

Në përfundim të fjalës së tij, komandanti i FT-së përgëzoi të pranishmit për realizimin e detyrave të 6 - mujorit të parë të vitit 2024, duke theksuar: "Forca Tokësore këtë periudhë ka përballuar një ngarkesë të konsiderueshme në angazhimet në

stërvitjet në vend dhe ato me partnerët, ashtu dhe në pjesëmarrjen aktive në operacionet e Emergjencave Civile në ndihmë të komunitetit për përballimin e situatave të vështira. Këto janë arritur vetëm falë përkushtimit të komandantëve dhe efektiveve të reparteve, duke mos harruar dhe operacionalitetin e shtabit të FT-së në realizimin e detyrave të ngarkuara". Ai shprehu bindjen se ky përkushtim do të vijojë dhe në të ardhmen.



Në Distriktin Detar Jugor u zhvillua konferenca përfundimtare planëzuese për stërvitjen “GrupEx-24” dhe për stërvitjen “Imponimi-24”

Në mjediset e Komandës së Distriktit Detar Jugor, Pashaliman, u zhvillua Konferenca Përfundimtare Planëzuese (FPC) për Stërvitjen “GrupEx-24” dhe për stërvitjen “Imponimi-24” si pjesë e Stërvitjes Kombëtare 3-shkallëshe “Përpjekja e Përbashkët - 24”, si dhe qitjet bregdetare të planifikuara për t’u zhvilluar më datë 24-28 qershor 2024.

Fokusi i kësaj stërvitjeje është përmirësimi i koordinimit midis institucioneve me interesa në det në përgjigje të një situatë operacionale detare si dhe testimi i kapaciteteve reaguese të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, strukturave të vartësisë së saj Distriktit Detar Jugor, Distriktit Detar Verior si dhe strukturave ligjzbatuese me interesa në det. Stërvitja ka gjithashtu për qëllim aftësimin e shtabeve pjesëmarrëse në planëzimin e stërvitjeve të këtij niveli dhe zhvillimin e operacioneve MIO.

Konferenca u organizua në dy pjesë: Stërvitja “Imponimi-24” e planëzuar për t’u zhvilluar me pjesëmarrje të Distriktit Detar Jugor, Distriktit Detar Verior, Forcës Tokësore (Regjimenti Operacioneve Speciale), Forcës Ajrore, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe Policisë Kufitare de Migracionit.



Stërvitja “GrupEx-2024” dhe qitjet bregdetare me temë: “Vlerësim dhe certifikim i grupeve të anijeve si njësi zbatuese, testimi i aftësive organizative dhe komanduese të komandave dhe shtabeve të distrikteve detare si dhe kryerja e qitjeve bregdetare me armatimin e anijeve.

Përfundon me sukses operacioni FOCOPS-24-3

Përfundon me sukses operacioni FOCOPS 24-3, pjesë e misionit “Sea Guardian”, në detin Mesdhe. Anija P-134 “Butrinti” filloi operacionin FOCOPS 24-3 së bashku me anijen kroate “Dubrovnik” nën komandën e CTG 440,03, duke patrulluar nga Adriatiku deri në Mesdhe për sigurimin e linjave detare të transportit, sigurinë e mjeteve detare dhe ekuipazheve nga kërcënimet dhe veprimet terroriste, zbulimin, verifikimin dhe ndalimin e mjeteve detare që paraqesin rrezikshmëri për sigurinë detare apo tentojnë të cenojnë sigurinë e mjeteve detare që ushtrojnë aktivitetin e ligjshëm të transportit, tregtisë, turizmit apo peshkimit. Në konkluzionet përfundimtare me Komandën Detare të NATO-s, u theksua se gjatë këtij operacioni 25 ditë janë arritur me sukses të gjitha objektivat. Operacione të këtij niveli janë një kontribut i drejtpërdrejtë i Forcës Detare/Rojës Bregdetare mbi sigurinë detare jo vetëm rajonale, por edhe më gjerë.



Kontingjenti V i anijes “Oriku” P-138, pjesë e operacioneve “SeaGuardian” në Detin Egje

Në kuadër të dislokimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s në detin Egje, në Distriktin Detar Jugor, Pashaliman u zhvillua ceremonia për përcjelljen në mision të anijes “Oriku” P-138, e cila është pjesëmarrëse për të tretën herë në aktivitetin e NATO-s në detin Egje.

Në ceremoni morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes Dorian Tola, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, personel të Forcës Detare/Rojës Bregdetare si dhe familjarë të efektivave që janë pjesë e kontingjentit V.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Agastra theksoi se: “Efektivët e Forcës Detare/Rojës Bregdetare po vazhdojnë të tregojnë profesionalizëm të lartë në kryerjen e detyrave të tyre, duke u bërë shembull për aleatët tanë.

Forca Detare/Roja Bregdetare ndikuar nga gjeopolitika në rajon si dhe të diktuar nga kushtet dhe detyrat e NATO-s po ndryshon dhe transformohet në përmirësimin e rritjes operationale, në aftësimin e personelit dhe ndërveprueshmërinë me vendet aleate partnere të Aleancës.

Në përfundim të fjalës, komandanti i FD-së iu uroi suksese në shërbimin ndaj atdheut dhe Aleancës. Efektiv i kontingjentit pjesëmarrës në mision u përshëndet dhe nga zëvendësministri i Mbrojtjes Dorian Tola, i cili u shpreh: “Jemi të bindur se edhe ju do të



kryeni detyrën e ngarkuar nga Aleanca me të njëjtin sukses dhe përkushtim si më parë. Në 4 kontingjentet e para në mision janë arritur të shpëtohen mbi 400 jetë, ndër këto dhe gra e fëmijë, të cilëve iu rezikohet jeta duke tentuar të kalonin kufirin jashtë kushteve të sigurisë lundrimore”.

Në përfundim të fjalës së tij, zëvendësministri falënderoi fëmijët e efektivëve dhe iu siguroi kujdesin e vazhduar të Ministrisë së Mbrojtjes.



Anija P-134 “Butrinti” vijon stërvitjen “Përpyjekja e Përbashkët”

Anija P-134 “Butrinti”, si pjesë e stërvitjes “Përpyjekja e Përbashkët”, vazhdon të kryejë detyrën për kontrollin dhe sigurinë e hapësirës detare në zonën e përgjegjësisë së saj në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Sot anija P134 “Butrinti” stimuloi skenarin MIO (verifikim dhe bordim për sigurinë detare) të një anije tregtare, e cila lundronte brenda ujërave tona territoriale. Gjatë verifikimit u zhvilluan të gjitha procedurat sipas standardeve në zbatimin e ligjshmërisë detare.

Gjithashtu është ndjekur dhe një skenar i dytë në hapësirën detare pranë linjës së gazsjellësit TAP-it, në të cilin u konstatua një mjet lundrues tip jaht.



Anija P-134 “Butrinti” është përpjekur për të komunikuar me mjetin lundrues, pasi dyshohej se mjeti po kryente aktivitet të paligjshëm në këtë zonë.

Në momentin e afrimit nga grupi i bordingut drejt jahtit, mjeti filloi lëvizjen me shpejtësi maksimale drejt perëndimit, duke u përpjekur për t’u larguar nga ujërat tona territoriale.

Anija P-134 si dhe gomonia me grupin e bordingut filluan ndjekjen, si dhe kërkuan bashkëpunim nga shteti fqinj për të bërë të mundur bllokimin e tij. Anija P-134 vijon patrullimin në rajonin e saj të përgjegjësisë për sigurinë lundrimore dhe hapësirës tonë territoriale detare.

U zhvillua stërvitja e përbashkët trajnuese e palombarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Qendrës së Zhytjes

Në Qendrën e Zhytjeve Pashaliman u zhvillua një stërvitje trajnuese e përbashkët ndërmjet palombarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me palombarët e Qendrës së Zhytjes dhe Flotiljen Detare Pashaliman.

Gjatë këtij trajnimit u zhvilluan zhytje ambientuese në 3-12m, forma e kërkimit me mbështetje nga gomonia, orientim me busull dhe format e kërkimit me pamje kufizuese dhe eliminimi i pengesave gjatë kërkimit nën ujë.

Gjithë faza e trajnimit është realizuar me sukses dhe bashkëpunimi mes palombarëve të FSK-së dhe palombarët e Qendrës së Zhytjes dhe Flotiljes Detare do të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim njohjen e pajisjeve dhe qendrave respektive.



Forca Detare/Roja Bregdetare vazhdon misionin e saj fisnik në shpëtimin e jetëve njerëzore, në kuadër të Aleancës

Anija "Lissus", e cila ndodhet në mision në detin Egje, gjatë patrullimit finalizoi me sukses operacionin e kërkim-shpëtimit. Operacioni i erdhi në ndihmë emigrantëve të paligjshëm, të cilët lundronin në kushte të vështira lundrimore dhe rrezikonin të mbyteshin.

Pas koordinimit të anijes "Lissus" me Rojën Bregdetare turke u bë i mundur shpëtimi i 23 emigrantëve me kombësi nga Palestina, Somalia dhe Jemeni.

Emigrantët, 21 meshkuj dhe 2 femra ndodhen në gjendje të mirë shëndetësore dhe u morën nga Roja Bregdetare turke për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.





Baza Ajrore e Gjadrit, 5 vite histori suksesi

Në mjediset e Bazës Ajrore të Gjadrit, u zhvillua një ceremoni në nder të 50 - Vjetorit të Krijimit të Bazës Ajrore të saj.

Në këtë ceremoni morën pjesë, komandanti i FAJ, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, personeli i FAJ, të ftuar, si dhe personel nga stafi trajnues amerikan për helikopterët "Black Hawk".

Në fjalën përshëndetëse të mbajtur nga komandanti i FAJ, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, ndër të tjerash u evokua historia 50 - vjeçare e bazës. "Data 10 korrik 1974, hyri në histori si data e krijimit të një prej objekteve me rëndësi të madhe për mbrojtjen e asaj kohe.

Në këtë bazë kanë punuar me mjaft vetëmohim, kanë derdhur djer-sën dhe mundin personel ushtarak e civil, pilotë e teknikë avionësh, duke realizuar, jo vetëm detyrat e fluturimit, por edhe shumë ditë larg familjarëve, në shërbim të mbrojtjes së vendit.

Sot, kur konceptet dhe nocionet e sigurisë kanë ndryshuar, në raport me zhvillimet aktuale, infrastruktura e kësaj baze do të shërbejë si vend për trajnimin e ekuipazheve fluturuese të mjeteve ajrore helikopterë, si dhe për trajnime bazike të pilotëve të rinj", - përfundoi fjalën e tij gjeneral brigade Dimo".

Më 10 korrik 1974, dy pilotë të Rinasit u ulën për herë të parë në



pistën e sapondërtuar të aerodromit të Gjadrit, komandanti i Regji-mentit të Rinasit Haki Jupasi me avionin supersonik MIG - 19 dhe zëvendësi i tij Serafin Shegani me avionin supersonik MIG - 21.

Në 10 korrik 2024, në pistën e bazës së Gjadrit, u ul për herë të parë helikopteri UH - 60 "Black Hawk", helikopteri më i ri i FA-së, pjesë e komponentit të pasurimit dhe modernizimit të teknikës ajrore të FAJ.

Personeli ushtarak dhe civil i DMR, Mengel, pjesë e fushatës për dhurimin vullnetar të gjakut

Komanda mbështetëse së bashku me nënrepartet vartëse ka nisur angazhimin e saj për të kontribuar në kuadër të fushatës së dhurimit vullnetar të gjakut.

Detashmenti i Mbrojtjes Rajonale, Mengel, bëhet struktura e parë, e cila nis fushatën e dhurimit të gjakut në bashkëpunim me stafin mjekësor të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Në ambientet e qendrës shëndetësore të Batalionit të Mbështetjes Rajonale, Mengel, personeli ushtarak dhe civil i kësaj strukture iu bashkuan nismës sa humane aq dhe jetike për të dhuruar vullnetarisht gjak.

Fushata e dhurimit vullnetar të gjakut do të vazhdojë në struk-tura të tjera të Komandës Mbështetëse.



Certifikohet personeli për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të radarit TPS 77

Për një periudhë njëmuajore në vend dislokimit të radarit TPS 77, Midë, u krye trajnimi i personelit për operimin dhe mirëmbajtjen e këtij radari.

Trajnimi u zhvillua nga dy instruktorë të kompanisë "Lockheed Martin" dhe në të morën pjesë 8 kursantë, të Qendrës së Kontroll - Raportimit, me formim nga fusha e elektronikës dhe e teknologjisë së informacionit.

Programi i trajnimit, i shtrirë në 5 javë kalendarike pune, përmbante tema teorike mbi njohjen me elementët përbërës të radarit, teorinë e operimit të secilit komponent përbërës dhe të të gjithë sistemit të radarit, llojet e kontrolleve dhe mirëmbajtjes periodike, diagnostikime të defekteve të ndryshme, studimin e skemave inxhinierike të komponentëve përbërës, si dhe ushtrime praktike për kryerjen e inspektimeve, matjen e parametrave të ndryshëm teknikë me instrumente matës, ndërrimin e pjesëve të defektuara, kryerjen e kalibrimeve dhe akordimeve të ndryshme nëpërmjet programit softuerik, si dhe ushtrime të tjera praktike për njohjen e programit të sistemit të kontrollit të mirëmbajtjes.

Në ceremoninë e organizuar me rastin e përfundimit të këtij trajnimi, si dhe për certifikimin e personelit, mori pjesë komandanti i Faj-së, gjeneral brigade Ferdinant Dimo.

Në fjalën e tij, gjeneral brigade Dimo, pasi shprehu rëndësinë që kjo postë ka për Forcat e Armatosura në përgjithësi, por edhe për Faj-në në veçanti, në drejtim të mbajtjes në operacionalitet të sistemit të vëzhgimit ajror, falënderoi instruktorët e kompanisë "Lockheed Martin" për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre. Nga ana tjetër, ai falënderoi edhe personelin kursant mbi arritjen



e rezultateve të duhura në përfundim të trajnimit, duke theksuar se tashmë FARSH-të dhe FAJ-të kanë edhe një aset tjetër të shtuar oficerësh të trajnuar, për të mirëmbajtur dhe ruajtur gatishmërinë operacionale të sistemit të radarit TPS 77 në FAJ.

Përfundoi me sukses Kursi Bazik Teknik/Mekanik Helikopteri



Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, Kuçovë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazik Teknik/Mekanik Helikopteri.

Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku, i cili theksoi rëndësinë e këtij kursi që shërben për të përgatitur personelin për të punuar në teknikën ajrore, si dhe shtoi rëndësinë e kurseve në zhvillimin e mëtejshëm profesional.

Përgjatë këtyre 14 javëve janë trajnuar 6 kursantë me kurrikulat mësimore më të avancuara. Arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi i personelit është element thelbësor që shërben si bazë solide për krijimin e një trupe profesionale për t'iu përgjigjur kërkesave dhe sfidave në rritje në një mjedis sfidues sigurie. Pas dhënies së certifikatave, ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.

U zhvillua në Berlin Takimi i Drejtuesve të Lartë të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të Bazuar në Tokë

Përfaqësuesit e Forcave Ajrore të vendeve të NATO-s për Mbrojtjen Ajrore dhe Raketore të Bazuar në Tokë (SBAMD Key Leader Seminar within NATO), si pjesë e ekspozimit ILA24 (Innovation and Leadership in Airspace - ILA), zhvilluan në Berlin, Gjermani, një seminar, ku në fokus ishin sfidat e reja që vendet e NATO-s dhe vendet partnere po përballen si pasojë e zhvillimeve në mjedisin gjeopolitik. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku.

Aktiviteti u organizua nën përkujdesjen e veçantë të zëvendëskomandantit të Forcave Ajrore gjermane dhe kishte për qëllim diskutime mbi: situatën gjeopolitike në hapësirën Euro-Atlantike dhe më gjerë me fokus të veçantë luftën në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme; zhvillimet në fushën e sistemeve të mbrojtjes ajrore; sfidat, rreziqet dhe kërcënimet që përballen vendet anëtare të NATO-s, si dhe vizioni për të ardhmen e mbrojtjes ajrore të Aleancës. Në mënyrë specifike u mundësua shkëmbimi i ideve ndërmjet pjesëmarrësve për çështjet që kanë të bëjnë me kompleksitetin e mbrojtjes së integruar ajrore, rëndësinë e planifikimit dhe ekzekutimit shumëkombësh si dhe konceptin e mbrojtjes së forcave nga kërcënimet e sistemeve fluturuese pa pilot. Gjithashtu, si pjesë e aktivitetit ishte



edhe pjesëmarrja në ekspozitën ndërkombëtare Innovation and Leadership in Airspace (ILA) në të cilën kompanitë ndryshme të industrisë së mbrojtjes kishin paraqitur produktet e tyre.

Në vijim të aktivitetit, përfaqësuesit e Forcës Ajrore u informuan rreth produkteve të ofruara nga kompanitë e tjera si Airbus Defence & Space GmbH, MBDA Deutschland GmbH + Patriot si dhe Rheinmetall AG.



93 vjet Mbrojtje Kundërajrore

Plot 93 vjet më parë, Forcave të Armatosura iu bashkëngjiti Mbrojtja Kundërajrore.

MKA, si armë e Artilerisë dhe Radiolokacionit, e nisur fillimisht vetëm me 3 bateritë e artilerisë, kryesisht në portet e vendit, u fuqizua ndër vite, deri tek raketat apo radarët.

Si pjesë e Sistemit të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s, (NATINAMDS), MKA sot do të kontribuojë dhe me asetet moderne të vëzhgimit, duke u kompletuar me elementet e Mbrojtjes Ajrore të bazuar në tokë (GBAD), si dhe kompletimi me radarë, në zbatim të projektit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (SIVHA).



Me këtë rast, Komandanti i Faj-së, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, uroi dhe përgëzoi ushtarakët e Faj-së dhe kryesisht ata të Mbrojtjes Kundërajrore për kontributin ndër vite, sakrificat, dhe përkushtimin e tyre.

“MKA ka qenë objektivi i parë dhe kryesor i Faj-së, që kërkonte modernizim dhe përkushtim, në vazhdimësi të misionit fisnik dhe vlerave që FARSH-të dhe FAj mbartin”, - u shpreh ndër të tjerash gjeneral Dimo.

U zhvillua ceremonia e certifikimit dhe betimit të rekrutëve

Ceremonia e certifikimit dhe betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan me sukses kursin e Stërvitjes Individuale Bazë, është një moment krenarie dhe arritjeje për të gjithë pjesëmarrësit, duke treguar përkushtimin dhe përgatitjen e tyre për t'i shërbyer vendit me nder dhe dinjitet. Urime të gjithë rekrutëve!



QAPN, përfundon Kursi i 81-të Fillestar i Nënoficerëve

Përfundon Kursi i 81-të Fillestar i Nënoficerëve, i cili u zhvillua në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve. Në këtë kurs kursantët hedhën bazat për karrierën e nënoficerit, ofrimin e njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njehsuara me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues grupi.



Hackathoni i Kriptografisë, një rrugëtim i ri për studentët e AFA-së

Hackathoni i Kriptografisë, nis rrugëtimin drejt krijimit të një algoritmi dhe çelësave Kombëtarë të Kriptimit! Nën mentorimin e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, studentët e Masterit Profesional në "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes" të AFA-së, nisën një përvojë të jashtëzakonshme për të shfaqur aftësitë e tyre në krijimin e një algoritmi të rëndësishëm kombëtar!



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, pjesë e iniciativës "Dhuro gjak, shpëto Jetë"



Personel pedagogjik dhe kursantë nga Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursi i Lartë i Oficerit, u bënë pjesë e fushatës së dhurimit vullnetar të gjakut, zhvilluar në Qendrën Shëndetësore të garnizonit "Skënderbej".

Seanca e dhurimit të gjakut u realizua në kuadër të bashkëpunimit të Forcave të Armatosura me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe do të vijojë dhe përgjatë muajve në vijim.



Zhvillohet konferenca shkencore “Sfidat e Arsimit të Lartë në një mjedis që ndryshon”

Akademia e Forcave të Armatosura në bashkëpunim me Universitetin “Luarasi” dhe “Tirana Business University”, organizuan Konferencën Shkencore me temë: Sfidat e Arsimit të Lartë në një mjedis që ndryshon”.

Kjo konferencë vjen në një moment të rëndësishëm për sa i përket sfidave që po hasen në mjedisin e sigurisë dhe mbrojtjes.

Në përshëndetjen e tij të veçantë në këtë konferencë, SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, pasi falënderoi pjesëmarrësit, u shpreh ndër të tjera: “Studimet ushtarake në përgjithësi dhe kërkimi shkencor në veçanti, kanë qenë prezent dhe bashkudhëtarë të çështjeve të teorisë ushtarake e doktrinare, si dhe të aplikimit të teknologjisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në gjithë rrugëtimin e saj. Studimet dhe kërkimet në fushën e sigurisë mundësojnë analizën e mjedisit dhe statusin e gjendjes aktuale të sigurisë, si një pikënisje për të nxjerrë në pah statusin e saj të kontestuar disiplinor. Mbi këtë bazë, bëhet lidhja e ngushtë ndërmjet historisë konceptuale të sigurisë me zhvillimin konkret dhe parashikimeve të saj për të ardhmen.”

Më tej, gjatë përshëndetjes së tij gjeneral Kingji, duke e konsideruar këtë konferencë shumë aktuale në mjedisin e tanishëm të sigurisë, mjedis i cili vazhdimisht ndryshon dhe është i paparashikueshëm, theksoi se kjo konferencë do të ofrojë përjasje dhe rrugë efikase drejt përmirësimit të programeve studimore, zhvillimit dhe inovacionit të edukimit ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura, në funksion të ndryshimeve të shpejta dhe të paparashikueshme në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

“Në këtë mjedis global të përkeqësuar të sigurisë, Aleanca ka përforcuar konceptin e saj të shkurajimit dhe mbrojtjes dhe vënë në funksion plane të reja rajonale të mbrojtjes dhe një model të ri të Forcës së NATO-s. Nëpërmjet këtyre planeve gjithëpërfshirëse, të harmonizuara me planet kombëtare të vendeve aleate, do të bëhet e mundur mbrojtja e integritetit territorial të Aleancës dhe adresimi i kërcënimeve të identifikuar në konceptin strategjik të saj, që janë Rusia dhe Terrorizmi...”, - nënvizoi gjeneral Kingji.

Në vijim të përshëndetjes së tij, gjeneral Kingji theksoi se Forcat e Armatosura të RSH-së, janë përshtatur në mënyrë të shpejtë me këto ndryshime, dhe përveç hartimit të dokumenteve strategjike



në vijim të miratimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, është punuar për rishikimin e planeve kombëtare të mbrojtjes, tashmë të ndara në domene për një adresim sa më të plotë të të gjithë spektrit të kërcënimeve dhe rreziqeve.

Duke përfunduar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, pasi vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë për zhvillimin e programeve mësimore dhe projekteve të përbashkëta, si dhe shkëmbimin e lektorëve, theksoi se Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes e kanë prioritet transformimin dhe modernizimin e vazhdueshëm, të gjithanshëm, gjithëpërfshirës dhe progresiv të sistemit të Arsimit të Lartë Ushtarak (ALU), në pikëpamje të modernizimit, zhvillimit të kurrikulave, programeve të studimit, infrastrukturës dhe stafit akademik. Konferenca Shkencore “Sfidat e Arsimit të Lartë në një mjedis që ndryshon”, pati si synim rritjen e vëmendjes në harmonizimin sa më të drejtë të burimeve financiare e logjistike të FA-ve për zhvillimin e arsimit dhe kërkimit shkencor, përshtatjen e programeve studimore të arsimit të lartë përballë sfidave të reja në epokën digjitale.



Diplomohen kursantët e KKSHP dhe KLO

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizoi ceremoninë e diplomimit të kursantëve të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursit të Lartë të Oficerit. Në këtë aktivitet morën pjesë Ambasadori i Republikës së Kosovës i akredituar në Tiranë z. Skënder Durmishi, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Enkelejd Joti, sekretarja e Përgjithshme në MM, znj. Gelardina Prodani, zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Aleksandër Pando, Atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës kolonel Enver Hoti, Komandantë forcash kryesore dhe të njëjve autonome të FA-së, drejtore të Shtabit të Përgjithshëm, staf drejtues dhe mbështetës, pedagogë etj.

Në fjalën e tij të rastit, komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj ndër të tjera u shpreh: “Në kuadrin e ambicies për të krijuar një institucion të arsimit dhe kualifikimit ushtarak rajonal si dhe duke u mbështetur në Direktivën e Ministrisë të Mbrojtjes dhe në vizionin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë këtë vit akademik startoi për herë të parë me realizimin e mësim-it në gjuhën angleze për Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) me 2 Module, duke sjelle një risi në historikun e arsimit tonë ushtarak. Stafi akademik ka punuar vazhdimisht që kurrikula, programet, leksionet të përditësohen me të rejtat më të fundit nga zhvillimet në NATO, BE dhe institucione me rëndësi të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare, ndaj, me gjithë gamën e njohurive të marra gjatë këtij viti akademik, jam i bindur se ju kursantë jo vetëm keni rritur nivelin tuaj profesional, por edhe jeni të gatshëm për të drejtuar në shtabe kombëtare dhe ndërkombëtare, në funksione drejtuese, koordinuese dhe përfaqësuese me më shumë përvojë,

njohuri dhe aftësi menaxhuese. Falënderim për Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes për mbështetjen e vazhdueshme të dhënë për kompletimin e infrastrukturës mësimore dhe realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare”. Në emër të kursantëve që përfunduan kurset KKSHP dhe KLO përshëndetën kapiten i rangut II Edion Hoxhaj nga Forcat e Armatosura të FA-së dhe nënkolonel Ali Krasniqi nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilët sollën disa nga momentet kryesore të zhvillimit të kurseve si stërvitjet, vizitat mësimore/studimore, temat kurseore si dhe falënderuan stafin pedagogjik dhe

Mbrojtjes të vendeve të NATO-s. I nderuar Ambasador i Republikës së Kosovës, z. Durmishi, Ju falënderoj për bashkëpunimin e deritanishëm në fushën e arsimit dhe ju shpreh se Ministria e Mbrojtjes do të vijojë të shtojë urat e komunikimit dhe ndërveprimit, jo vetëm me Forcën e Sigurisë së Kosovës, por dhe me institucionet civile për ta bërë sa më të plotë tablonë tonë të përbashkët në stërvitje, trajnime dhe kurse. Mirënjohje stafit drejtues, pedagogjik dhe mbështetës të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë që drejtuan, koordinuan dhe zhvilluan me sukses vepërimtarinë mësimore të dy kurseve KKSHP dhe KLO, duke treguar se çdo ditë, Ju, bëni



mbështetës për përkushtimin e treguar gjatë gjithë vitit akademik.

Më pas përshëndeti zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Enkelejd Joti, i cili u shpreh: “Më lejoni që në emër të ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi dhe në emrin tim t’ju përgëzoj për përfundimin me sukses të studimeve akademike njëvjeçare, si proces më rëndësi në karrierën tuaj ushtarake. Jam i bindur se duke u modernizuar në pajisje dhe duke u konsoliduar me staf gjithnjë e më profesional, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë do të jetë në gjendje për të dhënë më të mirën e mundshme, duke krijuar të gjitha premisat për transformimin e tij në një Kolegj rajonal dinjitoz përkrah Kolegjeve të

përpjekjet e duhura për më shumë njohuri, profesionalizëm, modernizim dhe zhvillim, duke e bërë Kolegjin tashmë, një strukturë elitare në Forcat e Armatosura Shqiptare për arsimimin e ushtarakëve dhe civilëve të lartë brenda dhe jashtë vendit. Në përfundim, uroj të jemi prezent dhe të na bëni krenarë në shumë suksese tuaja”.

Në këtë ceremoni u diplomuan 47 kursantë të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) dhe 19 të Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) me pjesëmarrje nga strukturat e Forcave të Armatosura të RSH dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, FSK. Ceremonia u mbyll me fotografi të përbashkët dhe shpërndarjen e diplomave.

Në kuadër të planit të aktiviteteve të atsheve të akredituar në vendin tonë, në ambientet e Komandës Mbështetëse u zhvillua një vizitë njohëse e trupës së Atasheve Ushtarakë, rezident dhe jo rezident, me qëllim rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit në fushën e mbrojtjes.

Atasheu ushtarak i Çekisë, kolonel Radim Jonas, atasheu ushtarak i Gjermanisë, kolonel Hans Peter Wamsler, atasheu ushtarak i Turqisë, kolonel Tolga Kip, atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, kolonel Timothy Wight Boycott, atasheu ushtarak i Kosovës, kolonel Enver Hoti, atasheu ushtarak i Bullgarisë, kolonel Miroslav Sandrev, atasheu ushtarak i Polonisë, kolonel Przemyslaw Balut, atasheu ushtarak i Italisë, kolonel Agostino Piccirillo, atasheu ushtarak i Greqisë, kolonel Ioannis Mokos, dhe atasheu ushtarak i Kroacisë, kolonel Stjepan Domjancic, u mirëpritën nga zëvendës komandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, i cili iu uroi mirëseardhjen dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen e kahershme që vendet e tyre kanë ofruar për Forcat e Armatosura dhe Komandën Mbështetëse në veçanti.

Përmes një prezantimi, përfaqësuesit ushtarakë u njohën me misionin e Komandës



Atashtetë Ushtarakë të akredituar në vendin tonë, zhvilluan vizitë njohëse në Komandën Mbështetëse



Mbështetëse, me transformimet strukturore që ka pësuar ndër vite, detyrat kryesore, kapacitetet aktuale, objektivat, prioritetet dhe fokusin për të ardhmen.

Atashtetë Ushtarakë shprehën interes në lidhje me modernizimin e sistemeve, pajisjeve dhe teknikës që Komanda Mbështetëse përdor në përmbushjen e objektivave operacionale, si dhe implementimin e ligjit të ri në lidhje me kompletimin e strukturave rezerviste.

Aktiviteti përfundoi me shkëmbimin e dhuratave simbolike midis përfaqësuesit të trupës së Atasheve Ushtarakë, kolonel Radim Jonas dhe zëvendës komandantit të Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela.

Përfundoi operacioni EOD, në njësinë administrative nr.11, bashkia Tiranë

Nga punimet e kryera në rrugën "Beniamin Kruta", njësinë administrative nr.11, bashkia Tiranë, është identifikuar një municion i rrezikshëm.

Ekipi i ekspertëve të kompanisë EOD, në përgjigje të njoftimit të marrë nga strukturat përgjegjëse, është dislokuar pranë territorit, ka bërë rrethimin e perimetrit të zonës, ku është gjetur municioni dhe me profesionalizëm e përgjegjësi të lartë ka konstatuar se municioni i identifikuar ishte një bombë amerikane me nomenklaturë AN-M64 240 kg me djegore majore të montuar.

Duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik të parashikuar në manualin EOD, efektivet e kompanisë EOD, bënë heqjen e djegores dhe më pas transportimin dhe magazinimin e municionit në ambientet e Batal-



ionit të Xhenios. Kjo detyrë e përfunduar me sukses, është tregues i gatishmërisë, ekspertizës, punës së palodhur e të paku-shtëzuar të efektiveve të kompanisë EOD, në Batalionin e Xhenios.



Komanda Mbështetëse dhe strukturat e saj, në mbështetje të stërvitjes së SHP “Përpjekja e Përbashkët-24”

Në stërvitjen 3-shkallëshe të FA-së, “Përpjekja e Përbashkët-24”, Komanda Mbështetëse është angazhuar së bashku me strukturat vartëse për mbështetjen me kapacitete dhe shërbime logjistike, sipas klasave të furnizimit të FBOD dhe trupave pjesëmarrëse në stërvitje në zonën e operacionit Bizë dhe vend-dislokimin Rrapi i Treshit.

Kjo stërvitje synon të testojë kapacitetet e mbështetjes logjistike me furnizim, kapacitetet EOD, kapacitetet xheniere, transport trupash, mjete, teknikë dhe ngritjen e setit fushor.

Pas përfundimit të fazës planëzuese ka filluar mbështetjen e operacionit “Stuhia 24”, duke vendosur në dispozicion të Forcës Tokësore personel, mjete dhe pajisje si dhe duke ngritur setet fushore në të dyja rajonet e stërvitjes.

Efektivët e grup-batalionit gjatë lëvizjes për në rajonin e zhvillimit të operacionit, u përballën me dy incidente, të cilat kërkuan ndërhyrjen e specializuar të efektivëve të togës EOD.



Duke përdorur me përpikëri teknikat dhe procedurat e parashikuara në manualin EOD ML 400-5-2, ekspertët EOD asgjësuan municionet e paplasura në rrugëkalimin e lëvizjes dhe kryen kontrollin e një automjeti për prezencë mjete shpërthyes, duke përdorur pajisjet dhe teknikat moderne EOD.

Komanda Mbështetëse vazhdon monitorimin dhe ndjekjen e aktivitetit operacional.

Komanda Mbështetëse, pjesë e Ditës së Vizitorëve të Shquar

Në stërvitjen “Përpjekja e Përbashkët - 24”, Komanda Mbështetëse angazhoi strukturat dhe personel, me qëllim sigurimin e mbështetjes logjistike të Forcës së Bashkuar të Organizuar për Detyrë, në zonën e operacionit Bizë dhe vend-dislokimin Rrapi i Treshit me kapacitete EOD, xheniere, transport trupash, mjete dhe teknikë, set fushor dhe kapacitete për ngritjen e fushimit. Në Ditën e Vizitorëve të Shquar (DVD), në rajonin stërvitor Bizë, toga EOD tregoi kapacitetet teknike (mjete, pajisje EOD) dhe aftësi operationale për zgjidhjen e situatave gjatë stërvitjes.

Toga EOD demonstroi dy skenarë, improvizimin e zjarrit të artilerisë së kundërshtarit, duke realizuar shpërthime të kontrolluara, si dhe mbështetjen me kapacitete



EOD, duke bërë të mundur asgjësimin e 13 predhëve, mortajë 81mm dhe 5 mortaja 120mm.

Komanda Mbështetëse testoi kapacitetet e saj të mbështetjes logjistike në të gjitha klasat e furnizimit, kapacitetet transportuese, ato të mirëmbajtjes, kapacitete xheniere dhe EOD.



Një tjetër operacion në ndihmë të komunitetit i përfunduar me sukses

Në fshatin Bater, njëسيا administrative Koms, bashkia Mat, efektivet e kompanisë së punimeve xheniere të Batalionit të Xhenios, kanë punuar në mënyrë sistematike dhe kanë përfunduar me sukses detyrën për shembjen e kontrolluar të masivit shkëmbor.

Për më shumë se dy javë, duke përdorur pajisje, teknika, njohuritë e duhura e mbi të gjitha falë eksperiencës së krijuar ndër vite nga specialistët xhenierë, u realizua shkatërrimi i masivit shkëmbor, nëpërmjet shpërthimit të kontrolluar dhe në mënyrë mekanike, duke i dhënë mundësinë banorëve të fshatit Batër e Madhe të lëvizin lirshëm e të sigurt në drejtim të fshatit Batër e Vogël dhe qytetit të Burrelit.

Për inspektimin e punimeve, ka qenë i pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, i cili falënderoi ekipin xhenier për përkushtimin dhe njëkohësisht realizoi takim me përfaqësuesit e pushtetit lokal, të cilët shprehën mirënjohje për shërbimin e paçmuar që i bëhet kësaj zone.

Efektivet e kompanisë së punimeve xheniere do të jenë gjithmonë të gatshëm për t'iu përgjigjur në çdo kohë kërkesave për ndihmë të komunitetit, në të gjithë territorin e vendit tonë.



Ekspertët xhenierë përfundojnë një tjetër operacion në bashkinë Finiq

Ekspertët xhenierë të kompanisë EOD, janë angazhuar në mbështetje të emergjencave civile të bashkisë Finiq, qarku Vlorë.

Banorë të fshatit Dërmish, në njësinë Administrative Dhivër, bashkia Finiq kanë identifikuar disa municione të tipit granata dore. Ekspertët xhenierë, pjesë e operacionit për vlerësimin dhe largimin e municionit të gjetur, pas këqyrjes me vëmendje kanë konkluduar se municioni, granata dore, është i lëvizshëm.

Duke zbatuar me rigorozitet masat e sigurisë, specialistët EOD, kanë bërë transportimin dhe magazinimin e municionit në ambientet e Batalionit të Xhenios.

Kontingjenti XV EOD i bashkohet grup-batalionit kanadez, në kuadër të misionit të e-FP në Riga, Letoni

Në ambientet e Batalionit të Xhenios u zhvillua ceremonia për nisjen e kontingjentit XV EOD, i cili do t'i atashohet grup-batalionit kanadez për t'u radhitur përkrah vendeve të tjera aleate të NATO-s, për kryerjen e misionit të radhës në Riga, Letoni.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, drejtori i Operacioneve në Shtabin e Përgjithshëm, kolonel Elton Bregu, drejtori i BCU-së, kolonel Arjan Osmani, efektivet e Batalionit të Xhenios, familjarë të kontingjentit EOD dhe të ftuar të tjerë. Komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, në fjalën e hapjes shpreh mirënjohje dhe falënderim për Shtabin e Përgjithshëm dhe Komandën Mbështetëse, për mbështetjen e treguar për kontingjentet EOD, ku në mënyrë të veçantë falënderoi efektivet e kontingjentit XV për përkushtimin, sakrificën dhe për



detyrën fisnike që ata kanë marrë përsipër për të realizuar në këtë mision sa të vështirë, por aq dhe domethënës. Ndër të tjera ai u shpreh me bindje se kontingjenti XV do të jetë vazhdues i denjë i rrugës së nisur nga kontingjentet e mëparshme. Kolonel Elton Bregu, në emër të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, përcolli urimet më të mira për kontingjentin. Komandanti i kontingjentit XV, major Klodi-

an Nuredini, u shpreh në emër të kontingjentit se me disiplinën, profesionalizmin, dashurinë dhe krenarinë për atdheun, do të rrisin vlerat e Forcave të Armatosura, me përfaqësimin e tyre në këtë mision.

Në përfundim të ceremonisë zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, i dorëzoi kontingjentit XV flamurin kombëtar dhe më pas u realizua një foto e përbashkët.



Përfundoi operacioni për vlerësimin dhe transportimin e municioneve të rrezikshme në bashkinë Elbasan

Në mjediset e fushës së përpunimit të skrapit të firmës “Kurum Internacional”, në bashkinë Elbasan, u konstatuan municione të kalibrave të ndryshëm. Komanda Mbështetëse në përgjigje të kërkesës së autoriteteve të emergjencave civile ka vënë në dispozicion në grup ekspertësh EOD, të Batalionit të Xhenios. Specialistët EOD, kanë shkuar në vendin e përcaktuar, kanë bërë sigurimin e perimetrit të zonës dhe me përgjegjësi kanë vlerësuar se municionet e gjetura ishin të lëvizshme. Duke zbatuar rregullat e parashikuara në manualin EOD, forcat e vëna në dispozicion për këtë operacion kanë bërë transportimin dhe magazinimin e municioneve në depot e Batalionit të Xhenios.



Ekspertët e Kompanisë EOD në Batalionin e Xhenios, përfunduan operacionin në mbështetje të emergjencave civile në bashkinë Cërrik. Në vendgrumbullimin e mbetjeve në qytetin e Cërrikut është gjetur një granatë dore luftarake me ndezës të montuar.

Pas marrjes së njoftimit nga autoritetet përgjegjëse, ekipi EOD ka shkuar në vendin e përcaktuar, ku ishte konstatuar municioni dhe, përmes vlerësimit të kujdesshëm, kanë arritur në përfundimin se municioni i gjetur, granatë dore luftarake me ndezës të montuar ishte i palëvizshëm dhe përbente rrezik jo vetëm për punonjësit e vendgrumbullimit por dhe për banorët e kësaj zone.

Duke zbatuar masat e sigurimit teknik, specialistët EOD bënë asgjësimin në vend të granatës së dorës, duke kontribuar dhe njëherë në sigurinë e jetës së popullsisë civile.



Batalioni i Xhenios realizon punime për përmirësimin e infrastrukturës në ish - Bazën Ajrore në Gjadër

Batalioni i Xhenios, Komanda Mbështetëse, ka treguar gatishmërinë duke iu përgjigjur kërkesës së Komandës së Forcës Ajrore për sistemimin e infrastrukturës në nënrepartet e saj vartëse.

Forca dhe mjete speciale të kompanisë së punimeve xheniere në Batalionin e Xhenios, janë angazhuar për kryerjen e punimeve me natyrë specifike për sistemimin e infrastrukturës para tuneleve të ish - Bazës Ajrore Gjadër, me qëllim ndërtimin e qendrës stërvitore të Forcës Ajrore.

Specialistët xhenierë kanë kryer punime të tilla si: gërmim dhe nivelim me buldozer, ngarkim dhe shkarkim inertesh me fadromë dhe transportimin e tyre me mjete vetëshkarkuese. Komanda Mbështetëse me nënrepartet e saj do të mbështesë në çdo kohë strukturat e Forcave të Armatosura për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës.



Forca dhe mjete të kompanisë së parë operacionale në Bazë të Mbështetjes së Emergjencave Civile në Komandën Mbështetëse, në krye të detyrës për shuarjen e zjarreve

Temperaturat e larta të cilat kanë përfshirë vendim tonë kanë ndikuar në shfaqjen e disa vatrave të zjarrit në zona të ndryshme. Krahas ndërhyrjes së strukturave të tjera, një rol shumë të rëndësishëm në stabilizimin e situatës kanë dhënë dhe efektivet e Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile në Komandën Mbështetëse.

Më datë 09 korrik, Emergjencat Civile janë angazhuar në operacionin për shuarjen e zjarrit në fshatin Kardhikaq, njësi administrative Mesopotam, bashkia Finiq.

Me sakrificë, këmbëngulje, punë të vazhdueshme dhe duke u përballur me kushtet e vështira atmosferike (erërat e forta të cilat përhapnin zjarrin me shpejtësi) efektivet me mjete zjarrfikëse dhe pajisje të tjera bënë të mundur shuarjen e 74 vatrave të zjarrit, duke penguar depërtimin e tij në brendësi të fshatit dhe bane-save. Njëkohësisht një ndërhyrje e rëndësishme e efektiveve të Komandës Mbështetëse ishte dhe ajo në zonën e Dropullit, në fshatrat Terihat dhe Dhuvjan.

Më datë 11 korrik efektivet të kompanisë së kërkim shpëtimit u përfshinë në një tjetër operacion për shuarjen e zjarrit në bashkinë Delvinë. Forcat dhe mjetet zjarrfikëse u pozicionuan në segmentin Manastiri i Kamenës dhe rrugës së fshatit Kakodhiq, duke i bërë ballë situatës kritike të krijuar nga zjarri i përhapur në një gjatësi rreth 1 km dhe në veçanti



duke mos lejuar afrimin pranë fshatit, bane-save dhe vend burimit të gazit në Delvinë.

Komanda Mbështetëse me efektivet të trajnuar dhe mjetet e posaçme përmbush misionin e saj në ndihmë të komunitetit përmes shuarjes së zjarreve, duke i ardhur në ndihmë popullsisë civile dhe mjedisit përreth.

Operacionet EOD në ndihmë të komunitetit përmbillen me sukses

Ekipi i ekspertëve të Kompanisë EOD, në Batalionin e Xhenios, ka përfunduar detyrat për vlerësimin, heqjen dhe asgjësimin e municioneve të paplasura të identifikuar në lagjen "Jani Vruhu" në Berat dhe në fshatin Strëmbec, njësi administrative Çarçovë, bashkia Përmet. Gjatë punimeve të kryera në lagjen "Jani Vruhu", banorët e saj kanë pikasur municione të paplasura. Specialistët EOD, të angazhuar në këtë detyrë kanë bërë vlerësimin e municionit të gjetur dhe kanë konstatuar se municionet ishin granata dore mbrojtëse dhe mësymëse me ndezës të montuar. Me kujdes të veçantë ekspertët kanë bërë sigurimin e granatës mësymëse.

Pas marrjes së njoftimit nga strukturat përgjegjëse, ekipi EOD ka bërë vlerësimin e municionit të gjetur në fshatin Strëmbec, njësi administrative Çarçovë, bashkia Përmet, duke konstatuar një granatë dore italiane të Luftës së Dytë Botërore, SRCM-35. Duke zbatuar masat e sigurimit teknik, ekipi EOD bëri transportimin dhe magazinimin e municioneve në mjediset e Batalionit të Xhenios.



Kompania EOD kryen punime për përmirësimin e infrastrukturës në Bazën Ajrore Gjadër

Një ekip prej 7 specialistësh EOD të batalionit të xhenios, prej më se tre javësh është angazhuar në operacion për kontrollin dhe pastrimin e sipërfaqes nga municionet e paplasura në zonën ushtarake, baza Ajrore Gjadër, Lezhë, ku po kryhen punime për përmirësimin e infrastrukturës. Gjatë punimeve në bazën Ajrore Gjadër është gjetur një municion, i cili pas vlerësimit dhe identifikimit të kryer nga ekipi EOD, rezultoi 1(një) predhë artilerie gjysmë-blindshpuese 100mm. Ekipi EOD bëri të mundur largimin sigurt të municionit dhe transportimin e tij për magazinim, duke respektuar të gjitha masat e sigurimit teknik.



“ZONA GRI” - Hapësira mes paqes së brishtë dhe luftës së mundshme



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“Zona gri përkufizohet gjithashtu edhe si “veprime konkurruese midis, apo dhe brenda aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, të cilët ndodhen në gjendjen e dualitetit tradicional midis luftës dhe paqes. Një element kyç i operacioneve brenda zonës gri, është se ato mbeten nën pragun e një sulmi të armatosur, i cili mund edhe të marrë një përgjigje legjitime ushtarake konvencionale.”




Termini “zonë gri” u krijua nga Komanda e Operacioneve Speciale të Shteteve të Bashkuara dhe u botua në 2015. Koncepti i “zonës gri” është ndërtuar mbi strategjitë ekzistuese ushtarake; megjithatë, teknologjia e informacionit ka krijuar hapësira të reja radikale, të cilat kanë zgjeruar atë

që është e mundur. Lufta moderne hibride dhe operacionet e luftës politike ndodhin kryesisht në zonën gri. “Zonë gri” në terminologjinë ushtarake përshkruhet hapësira gjeopolitike ndërmjet paqes dhe luftës, hapësirë në të cilën aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë përfshihen në konflikt. Përdorimi i termit “zonë gri” është i përhapur në institucionet e sigurisë kombëtare, por nuk ka një marrëveshje universale ndërkombëtare për përkufizimin e zonës gri.

Zona gri përkufizohet gjithashtu edhe si “veprime konkurruese midis, apo dhe brenda aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, të cilët ndodhen në gjendjen e dualitetit tradicional midis luftës dhe paqes. Një element kyç i operacioneve brenda zonës gri, është se ato mbeten nën pragun e një sulmi të armatosur, i cili mund edhe të marrë një përgjigje legjitime ushtarake konvencionale. Ka një përkufizim tjetër që e quan atë si “veprime shtrënguese shtetërore pa luftë” dhe “kryesisht një fushatë joushtarake e veprimtarisë njerëzore në të cilën shtetet përdorin burimet kombëtare për të detyruar qëllimisht shtetet e tjera të veprojnë në përputhje me interesat e tyre. Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare e përkufizon zonën gri si “arenën e kontestuar diku midis kërcënimit për luftë dhe luftës së hapur”. Sekretari britanik i Mbrojtjes Ben Wallace e quajti zonën gri “tokë e harruar midis paqes dhe luftës”. Sipas Vincent Cable, shembuj të aktiviteteve të zonës gri përfshijnë minimin edhe e zinxhirëve industriale ose furnizimet me naftë dhe gaz, pastrimin e parave dhe përdorimin e spiunazhit dhe sabotimit. Sipas Lee Hsi-ming “konflikti i zonës gri karakterizohet nga përdorimi i kërcënimit të forcës për të krijuar frikë dhe pasiguri”.

Në fund të viteve 2010, Kina e përshkallëzoi luftën e zonës gri me Tajvanin në një përpjekje për të detyruar bashkimin me të. Rojës Bregdetare të Tajvanit i është dashur të zgjerohet me shpejtësi për të përballuar sfidën në rritje të zonës gri, të krijuar nga Pekini. Operacionet e zonës gri të Kinës kundër Tajvanit në fushën detare kanë për qëllim të krijojnë pranimë nga njëra anë si dhe duke ruajtur mohimin e besueshëm, për mos ndërhyrje shtetërore. Përgjithësisht shtetet jodemokratike mund të veprojnë në mënyrë më efektive



në zonën gri, pasi ato janë shumë më pak të kufizuara nga ligji dhe rregullatorët e brendshëm. Mund të jetë gjithashtu shumë e vështirë për shtetet demokratike që t'u përgjigjen kërcënimeve të zonës gri, sepse sistemet e tyre ligjore dhe ushtarake janë të orientuara drejt shikimit të konflikteve përmes ndjenjës së zgjidhjes paqësore të tyre. Kjo mund t'i shtyjë shtetet demokratike ose të reagojnë në mënyrë drastike ose të mos reagojnë ushtarakisht fare, kur përballen me një sfidë të zonës gri.

Një tipar i mosmarrëveshjes është rivaliteti në rritje i fuqive të mëdha në rajon midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. SHBA i sheh aktivitetet e Kinës në Arktik si një kërcënim për interesat e saj ushtarake. Ngrohja globale ka krijuar rrugë të reja detare që është ideale për Kinën pasi anijet e saj tregtare mund të reduktojnë kostot e transportit dhe të anashkalojnë ngushticat e Malacca-s të monitoruara nga SHBA. Në vitin 2018, Kina e quajti veten një shtet "afër Arktikut" dhe ka dërguar anije me teknologji gjithnjë e më të sofistikuar në rajon, duke rritur shqetësimet mbi mundësinë përdorimit të tyre të dyfishtë. Kina i ka minimizuar këto shqetësime dhe thotë se nuk po kryen kërkime ushtarake. Rebecca Pincus dhe Walter Berbrick kanë thënë se Arktiku po shfaqet si kufi për aktivitetet e zonës gri dhe se aktorët e lidhur me shtetin kinez po përdorin dy teknika kryesore: investimi strategjik në infrastrukturë dhe burime që mund t'i shërbejnë ushtrisë ose sigurisë, dhe kërkime shkencore që mbështesin interesat ushtarake.

Kina ka flotën më të madhe në botë dhe e ka përdorur një pjesë të saj si "milici detare" për të mohuar zyrtarisht pretendimet e saj për sovranitet në Detin e Kinës Jugore. Si pjesë e përpjekjeve, Kina ka ndërtuar objekte ushtarake në shkëmbinj dhe ishuj në zonat e diskutueshme. Megjithatë pretendimet e Kinës për Detin e Kinës Jugore u anuluan në vitin 2016 nga një gjykatë ndërkombëtare,

ajo e ka dyfishuar përpjekjen e saj, duke forcuar "milicinë e saj të peshkimit" për të mbrojtur përpjekjet në ndërtimin e ishujve, si dhe për të ngacmuar anijet e huaja. Përfshirja e milicisë kineze të peshkimit në operacionet "grey zone" së bashku me zgjerimin e në madhësi dhe burime, ka bërë që vendet fqinje dhe SHBA-të, të rrisin prezencën e tyre ushtarake në Detin e Kinës Jugore.

Milicia në hierarki i përgjigjet majës së burokracisë ushtarake të Kinës dhe Presidenti Xi Jinping e ka inkurajuar atë të ndihmojë në forcimin e interesave të vendit në Detin e Kinës Jugore. Milicia operon në bashkëpunim të ngushtë me Rojet Bregdetare Kineze dhe Marinën Kineze. Prandaj është përshkruar si "Forca e Detit të Tretë" të Kinës dhe është përcaktuar si një "forcë e organizuar nga shteti, e zhvilluar nga shteti dhe e kontrolluar nga shteti". Ajo vepron nën një zinxhir komandues ushtarak për të kryer aktivitete të sponsorizuara nga shteti kinez. Forca e milicisë kineze të peshkimit qëndron në natyrën e saj hibride, pasi përdorimi i anijeve të peshkimit dhe peshkatarëve të zakonshëm, i ka lejuar Kinës të mohojë lidhjen e drejtpërdrejtë me milicinë. Për shkak të mohimit të besueshëm që milicia i ofron qeverisë kineze, ato janë quajtur "burrat e vegjël blu" të Kinës nga studiuesit amerikanë Andrew Erickson dhe Connor Kennedy. Ky emërtim është në analogji për "burrat e vegjël të gjelbër" të Rusisë gjatë aneksimit hibrid të Krimesë në 2014. Statusi në dukje civil i milicisë kineze dhe aftësia në rritje e operacioneve të saj, e lejon Kinën të dobësojë sfiduesit e saj pa nisur një luftë konvencionale. Në një situatë kërcënimi, kombet e dobëta mund të hezitojnë të ndeshen me milicinë nga frika e një përgjigjeje nga Kina, ndërsa kombet e fuqishme do të hezitojnë të përballen me milicinë për shkak të "prishjes" së lidhjes pozitive me qeverinë kineze. Kina e ka krijuar dhe përdorur milicinë e saj detare për të mbështetur pretendimet e saj në Detin e Kinës Jugore, si një ndër forcat më pak të financuara, më pak

të organizuara dhe shpesh më pak profesionale nga forcat që janë punësuar për këtë qëllim.

Që nga viti 2015, SHBA ka kryer operacione të lirisë së lundrimit për të sfiduar pretendimet territoriale të Kinës ndaj Detit të Kinës Jugore. Shtetet e Bashkuara e justifikojnë këtë me arsyetimin se ata mbështesin të drejtën e të gjitha vendeve për të lundruar lirshëm në det të hapur. Krista Wiegand dhe Hayoun Jessie Ryou - Ellison, kanë thënë se duke pasur parasysh statusin e SHBA-së si udhëheqëse e rendit të bazuar në rregulla, ajo mund të vazhdojë të justifikojë praninë e saj ushtarake për të promovuar lirinë e lundrimit, mbrojtjen e aleatëve dhe partnerëve të saj të sigurisë dhe të tyre. Studiuesi Walter Mead ka argumentuar se shtetet revizioniste si Kina e kanë përdorur luftën e “zonës gri” për të minuar rendin ndërkombëtar të udhëhequr nga SHBA-të. Kina i shikon aktivitetet e zonës gri si zgjerime natyrore të mënyrës sesi vendet ushtrojnë pushtetin dhe rekomandon që SHBA-ja të zhvillojë diskutime me aleatët dhe partnerët kryesorë për të kuptuar më mirë shqetësimet, përgjigjet dhe nevojat e tyre.

Në një rajon tjetër të botës, që nga viti 2019, ka pasur një konflikt të vazhdueshëm midis Iranit dhe Izraelit, i cili ka shpikur “Luftën në hije” të emërtuar nga studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare. Irani dhe Izraeli kanë akuzuar njëri-tjetrin për kryerjen e taktikave klandestine kundër njëri-tjetrit, siç janë sulmet me dronë, të cilat kanë shkaktuar shumë shqetësime në ngushticën e Hormuzit dhe Bab el-Mandeb. Irani dyshohet se është i përfshirë në aktivitete në zonën gri, në Ngushticën e Hormuzit dhe Bab el-Mandeb, ku ka pasur incidente të shumta të sulmeve me mina, sulme me dronë, sabotim dhe anije që janë ndalur. Sulmet dhe pasiguria si në Ngushticën e Hormuzit ashtu edhe në Bab el-Mandeb shkaktojnë dëm të madh ekonomik global pasi të dy vendet janë strategjikisht të rëndësishme për furnizimin global me naftë. Kjo do të thotë se shumë kombe dhe kompani të transportit detar, janë të interesuara të mbrojnë anijet nga sulmet. Rrjedhimisht, kjo ka çuar në rritjen e masave të sigurisë dhe monitorimit në rajone nga shtete si SHBA-të dhe Arabia Saudite, por edhe kompani private të transportit detar.

Ngushtica e Hormuzit luan një rol të rëndësishëm në ekonominë globale, pasi afërsisht një e katërta e naftës botërore transportohet përmes kësaj hapësire. Për shkak të rëndësisë, disa analistë kanë frikë se një barrikadë detare nga Irani, ose një konflikt ushtarak do të shkaktonte një ndërprerje masive në furnizimin global të naftës, duke i bërë çmimet jashtëzakonisht të larta derisa anijet të jenë në gjendje të vazhdojnë të lundrojnë nëpër ngushticë pa u sulmuar. Kjo ndodhi edhe në vitet 1980 në Luftën e Tankerëve midis Irakut dhe Iranit ku kombet kryen sulme të shumta mbi anijet që trafikonin naftë ose në Iran ose në Irak.

Në vitet e fundit, ka pasur sulme të shumta që kanë ndodhur në Gjirin Persik pranë ngushticës, duke përfshirë një sulm të supozuar me silur në një anije me flamur të ishujve Marshall dhe një sulm me dy mjete shpërthyes drejt një anijeje me flamur të Panamasë në vitin 2019. Për më tepër, ka shumë raste sulmesh sabotazhi dhe madje një rast me një cisternë naftë me flamur britanik që u ndalua nga Irani. Ekspertët besojnë se Irani nuk ka kapacitetin për të bllokuar ngushticën e Hormuzit, se është e mundur që Irani do të trondiste çmimet globale të naftës, duke sabotuar cisternat në ngushticë me mina raketa të vogla kundër anijeve etj. Ekspertët argumentojnë se Irani do të arrijë të vazhdojë të ngacmojë dhe të kryejë sulme të vogla, pa krijuar një luftë të plotë as me SHBA-në dhe as me vendet e koalicionit arab.


Për industrinë e transportit detar, këto sulme çuan në rritje masive në normat e sigurimit dhe çmimet e naftës. Si përgjigje, kompanitë e transportit detar përdorin metoda të ndryshme për të manovruar kërcënime të tilla, duke punësuar ekspertë të paarmatosur të sigurisë. SHBA, MB, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe vende të tjera kanë krijuar një koalicion detar për të mbajtur mbikëqyrjen detare dhe për të komunikuar me anijet tregtare si një mjet për të eliminuar këto kërcënime.

Bab el-Mandeb ka rëndësi gjeostrategjike për tregtinë globale për shkak të lidhjes midis Detit të Kuq dhe Oqeanit Indian. Ngushtica sot shërben si një rrugë detare thelbësore për shumë cisterna naftë për shkak të përmasave të vogla të ngushticës, duke e bërë kështu transportin dhe tregtinë ndërkombëtare një objektiv të lehtë për taktikat e luftës në zonën gri. Taktika të tilla përfshijnë raketa, bomba, mina detare, varka vetëvrasëse dhe pajisje shpërthyes të telekomandua. Bab el-Mandeb shërben si një rrugë shumë strategjike për gazin natyror dhe naftën dhe një lidhje kryesore për tregtinë detare të Evropës dhe Azisë. Në dekadat e fundit, ujërat pranë Bab el-Mandeb kanë qenë një zonë jashtëzakonisht e rrezikshme për tregtinë ndërkombëtare me shumë anije që sulmohen nga piratët ose grupet terroriste. Megjithatë, vitet e fundit këto kërcënime janë zvogëluar, por në vend të kësaj janë zëvendësuar me përshkallëzimin e luftës civile në Jemen me forcat qeveritare që luftojnë kundër forcave Houthi të mbështetura nga Irani.

Sipas SHBA-së, Irani i ofron mbështetje financiare, trajnime dhe pajisje materiale si dronë, raketa dhe bomba. Houthi-t shihen si kërcënimi më i madh i sigurisë për lundrimin në ato ujëra me sulme të shumta, si sulmi ndaj dy cisternave naftë saudite në vitin 2018, një sulm vetëvrasës me varkë mbi një cisternë me flamur spanjoll në vitin 2016 dhe një sulm me granatë me raketa në një cisternë me flamur Tuvalu në vitin 2016. Për më tepër, Houthi-t kanë vendosur mina detare që kanë shpërthyer në anije mallrash tregtare si dhe në anije peshkimi lokale.

Që nga viti 2019, ka një “Luftë në hije” midis Izraelit dhe Iranit në ujërat pranë Bab el-Mandeb dhe ngushticës së Hormuzit, ku ka pasur një sërë sulmesh “greyzone” me mina detare, sulme me raketa dhe sulme me dronë kundër anije tregtare. Irani është akuzuar për sulmimin e anijeve tregtare dhe kontejnerëve izraelitë. Izraeli dyshohet se është i përfshirë në sulmet e zonës gri kundër cisternave iraniane që shkojnë për në Siri. Përveç kësaj, një anije detare iraniane u sulmua gjithashtu nga Izraeli në 2021 me pretendimet se anija iraniane po mbështeste rebelët Houthi, ndërsa iranianët pretenduan se anija ishte përdorur për të luftuar piraterinë. Ndërsa Irani dhe Izraeli janë ndërluftuesit kryesorë, vende të tjera si SHBA-ja, Britania e Madhe dhe Siria janë gjithashtu të përfshira, pasi Irani vazhdon përpjekjen për të dërguar naftë në Siri pavarësisht embargos së naftës së SHBA dhe BE-së. Irani është i varur nga kalimi i sigurt përmes Bab el-Mandeb dhe Kanalit të Suezit. Me flamur iranian rrezikon të kapet nga Britania e Madhe nëse ata përpiqen të dërgojnë naftë në Siri, duke hyrë në ngushticën e Gjibraltarit, gjë që ndodhi në vitin 2019, kur cisterna me flamur iranian “Grace 1” po transportonte rreth 2 milionë fuçi naftë në Siri, por u ndalua nga MB. Cisterna u lirua një muaj më vonë me kushtin që anija të mos lundronte për në Siri.

Si përgjigje ndaj luftës së Izraelit ndaj Hamasit që nga tetori 2023, forcat Houthi kanë intensifikuar sulmet e tyre ndaj anijeve në Detin e Kuq me dronë dhe raketa. Rebelët kanë rrëmbyer gjithashtu një



anije. Si rezultat, firma të shumta nga industria e transportit detar, duke përfshirë “Maersk” dhe Kompaninë Mesdhetare të Transportit, deklaruan se anijet e tyre do të shmangnin lundrimin në atë zonë. Shtetet e Bashkuara kanë akuzuar Iranin se është përfshirë në planifikimin e operacioneve të forcave Houthi. Irani ka mohuar çdo përfshirje. Sipas SHBA-së, sulmet e Houthi-ve ndikojnë shumë në tregtinë ekonomike globale pasi 10-15% e anijeve globale në botë kalon përmes Detit të Kuq. Si përgjigje, SHBA-ja ka formuar Operacionin “Prosperity Guardian” (OPG) me qëllim mbrojtjen e lirisë së lundrimit dhe tregtisë detare në Detin e Kuq. Shtetet e Bashkuara deklarojnë se OPG do të shërbejë si një operacion sigurie shumëkombëshe, duke formuar një koalicion të vullnetarëve me më shumë se 20 vende për të kundërshtuar sulmet e Houthis.

Ajo që i bën këto sulme pjesë të luftës së zonës gri është se është ligjshëm e vështirë të vërtetohen akuzat se Irani qëndron pas sulmeve direkte dhe indirekte, në gjykatat ndërkombëtare. Procedurat ligjore varen nga provat përfundimtare të një sulmi të armatosur në mënyrë që shteti i flamurit i sulmuar të pretendojë të drejtën për vetëmbrojtje sipas nenit 51 të Kartës së OKB-së. Minat e detit janë të lehta për t'u fshehur, gjë që e bën të vështirë për një shtet, të provojë se ata ishin në shënjestër të veçantë për këtë sulm. Si i tillë, ka pasur një rast kur SHBA-ja nuk ishte në gjendje të provonte se Irani ishte pas një sulmi me minë detare, pavarësisht dëshmimeve se mina ishte prodhuar në Iran. Përfshirja e rebelëve Houthi i ndërlikon gjërat më tej, sepse neni 51 i Kartës së OKB-së dikton të drejtën e një shteti për vetëmbrojtje, por karta nuk merr parasysh veprimet e kryera nga aktorë privatë dhe mercenarë. Si e tillë, kjo i pengon shtetet neutrale që ta akuzojnë Iranin përgjegjës, pasi sulmet shpesh kryhen nga Houthis për të cilët Irani nuk mban asnjë përgjegjësi. Më 1 prill 2024, pati përshkallëzim të marrëdhënieve kur Izraeli bombardoi ambasadën iraniane në Damask

dhe vrau dhe 16 persona, duke përfshirë Mohammad Reza Zahedi, një komandant i Forcave Quds, pasi dyshohet se po zhvillonin takim me udhëheqësit militantë palestinezë në kohën e sulmit. Në 13 prill, Hezbollahu sulmoi Izraelin jugor me rreth 40 raketa. Izraeli u përgjigj duke bombarduar një vend të prodhimit të armëve të Hezbollahut në Liban. Më vonë, Irani sulmoi Izraelin me rreth 300 dronë dhe raketa të shumta balistike, nga të cilat vetëm 3 arritën të depërtonin “iron dome” dhe dëmtuan lehtë bazat ajrore Nevatim dhe Ramon.

Koncepti i konflikteve ose luftës në zonën gri është i ndryshëm nga koncepti i luftës hibride, edhe pse të dyja janë të lidhura ngushtë pasi në epokën moderne shtetet më së shpeshti aplikojnë mjete jo konvencionale dhe teknika hibride në zonën gri. Megjithatë, të dy konceptet e strategjive të “luftës hibride” dhe “zonave gri” ndërtohen rreth idesë së ekzistencës së një shteti të ndërmjetëm midis paqes dhe konfliktit të armatosur ndërkombëtar dhe jo ndërkombëtar. Shumë nga mjetet jo konvencionale të përdorura nga shtetet në zonën gri, të tilla si fushatat propagandistike, presioni ekonomik dhe përdorimi i subjekteve jo shtetërore nuk e kalojnë pragun në agresion të formalizuar në nivel shtetëror. Sulmi terrorist i Bënjës, në shtator 2023, është përgatitur, subvencionuar, trajnuar dhe mbrojtur nga strukturat shtetërore të Beogradit, duke qenë “gri zona” më e rrezikshme e rajonit. “Zonë gri” tjetër në rajon, unë vlerësoj se është edhe Himara, e cila artificialisht mbahet nën presionin diplomatik jo proporcional të Athinës. Greqia mbron dhe vlerëson një kandidat që vjedh zgjedhjet, që dënohet për armëmbajtje pa leje dhe që dhunon simbolet kombëtare shqiptare, të vërtetuara të gjitha këto me vendime gjyqate. Diplomacia dhe politika shtetërore greke në mënyrë të paarsyeshme, investon një hidraulik shqiptar me shtetësi greke, të zgjidhet deputet i parlamentit europian, duke e demonstruar dukshëm një projekt të një kauze të vjetër në një “gri zone” afatgjatë.

DEZINFORMIMI, tortë e helmatisur ndaj interesave Kombëtare!



**GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n**

Ndër shekuj, por veçanërisht gjatë 10-vjeçarit të fundit (mbas pushtimit “de fakto” të Krimesë nga Rusia), pesha e “Armës së Dezinformit” si pjesë e paketës së kërcënimeve hibride, mbetet në fokusin e Institucioneve, Kolegjeve, Instituteve, Medias, NGO-ve, që merren me çështjet strategjike të sigurisë.

Duke konsideruar rrezikun që vjen nga dezinformimi Rus në luftën “jo vetëm për Ukrainën”, më posaçërisht në Ballkanin Perëndimor, Uashingtoni dhe Brukseli, kanë konfirmuar ngritjen e Komisionit të Dezinformimit në rajon, si një mekanizëm për mbrojtjen nga dezinformimi Rus, Kinez si dhe vegla/shtete të tjera jo-miqësore me interesat kombëtare dhe Aleancën euroatlantike (USA/NATO/UK/BE).

E parë nga këndvështrimi euroatlantik (në 360°), ndër kërcënimet dhe oportunitetet hibride, dezinformimin e gjej si tortë të helmatisur ose thikë që rrotullohet në shpinën e interesave gjeopolitike të RSH-së.

Në “kapacitetin e Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO”, çmuj që përtej oscilacioneve bolshevike jo vetëm në Moskë dhe Beograd, të sjellë në vëmendjen kombëtare një përmbledhje me definicione, historikun, aktorët, me konkluzione si dhe rekomandime Euroatlantike:

Paketa e kërcënimeve hibride, ndërthur luftën politike, ekonomike, ushtarake, kibernetike, ndërsa definicioni akademik i posaçëm për dezinformimin si: informacion i remë i përhapur jo thjesht dhe vetëm për të mashtruar njerëzit e zakonshëm, por si aktivitet i mirë-orkestruar me mashtrime dhe taktika të manipulimit të medias, influencuar në zgjedhje si dhe depërtuar te vendimmarrësit me qëllim për të dominuar mbi kundërshtarët

si dhe për të përmbushur objektivat strategjike, ushtarake, ekonomike, etnike, dhe gjeopolitike.

Rreth 2000 vjet më parë, Republika Romake po përballlej me luftë civile midis Oktavianit, djalit të birësuar të gjeneralit Julius Caesar dhe Mark Anthony, komandantit më të besuar të Tij. Për të marrë mbështetjen publike, Oktaviani nisi një luftë dezinformuese (sot fake news), duke mashtruar se Mark Anthony, kishte një lidhje me Kleopatrën, mbretëreshën egjiptiane, pra e preku shoqërinë në thelbin e vlerave romake. Po për shkak të kësaj, fitoi luftën dhe u bë perandori i parë i Romës, duke sunduar për 40 vjet.

Lufta e Parë Botërore (1914-1918), dezinformimi luajti rol vendimtar, duke i bërë thirrje shpirtit patriotik: “Vendi juaj ka nevojë për Ju” ose “Baba, çfarë jeni duke bërë për Luftën e Madhe”? Kështu Britanikët u përqendruan në diskreditimin e armikut në front, si p.sh “forcat gjermane përdornin kufomat e ushtarëve të tyre për të zier për yndyrë, miell kockash si ushqim për derrat”. Zyrtarët e dinin se kjo nuk ishte e vërtetë, por ajo ndihmoi që gjermanët të urreheshin dhe luftoheshin si armiqtë më barbar të historisë së njerëzimit.

Lufta e Dytë Botërore (1939-1945): Nazizmi u ngrit por (po edhe u rrëzua) nga “fushata dezinformuese më famëkeqe në histori”. Goebbels themeloi Ministrinë e Publikut për Propagandën për të përhapur urrejtjen kundër hebrenjve, duke keq-përdorur fuqinë e medias, televizionin, teatrin, shtypin. Ndërsa koalicioni i fitimtareve (USA/Rusi/Angli, etj.), e ndërtoi mbështetjen e gjerë popullore në strategjinë e kundër-propagandës mbi krimet çnjerëzore të nazi-fashizmit, p.sh. në krimet dhe mizoritë e Holokaustit.

Lufta e Ftohtë (1945-1991): Krahës garës së armatimit dhe strategjisë së shkurajimit (të armiqve, duke e dominuar me forcën e armëve, përfshi të shkatërrimit në masë/atomike) gjatë 45 viteve perëndimi, i udhëhequr nga SHBA-të e gjunjëzoi Rusinë edhe në fushatën e dezinformimit, duke marrë mbështetje botërore për luftën me “djajt e kuq, që ishin edhe më çnjerëzorë se nazi-fashistët!

Gjithsesi pranohet se kampi lindor/BRSS, ishte më i strukturuar në përhapjen e dezinformatave, ndërsa perëndimi/SHBA-të, krijuan një strukturë ndërinstitucionale (Grupi i Punës për Masat Aktive), i sfidoi me sukses masat aktive sovjetike deri në vitet 1990. Përveç eksperiencës me BRSS, përmendet edhe lufta në Vietnam, kur USA përdori sloganin: “Nëse Vietnam bie nën



kontrollin komunist, fqinjët e tij do të pasonin edhe shumë më keq”.

Ndërsa dezinformimi qesharak i regjimit komunist, se: “Do na sulmojë NATO, Varshava, ose të dyja së bashku”, qasje që për 45 vjet e vetë-gjunjëzoi RPSSH dhe rrokullisi në mjerim shqiptarët.

Pas viteve 1990, lindja e internetit, decentralizimi i burimeve dhe rritja e aktorëve në shpërndarjen e informacionit ka krijuar një platformë më të favorshme për dezinformimin. Zhvillimi i teknologjisë ka ndihmuar që “lajmet/fotot-fake”, të deformohen ndërsa politikanët vendas e keq përdorin këtë si avantazh për të sulmuar mediat, duke i quajtur lajmet e vërteta “lajme të rreme”, duke ndihmuar që ato të merrnin më shumë audiencë pasi njerëzit nuk po dinin kujt t’i besonin?

Me këtë rast, sjellim në kujtesë se ndër mësimet e nxjerra nga fushata e përballjes dhe mposhtjes së Millosheviçit, ishte strategjia e dezinformimit dhe e mashtimit, çka bëri që NATO gabimisht të bombardonte autokolona me civilë, ura dhe infrastruktura transporti, ambasadën Kineze, makete njësisish ushtarake të Aviacionit dhe artilerisë, etj. Si shembull të peshës së “Fake

News”, mundet të përmendim gjithashtu, faktin që përpara Brexit/UK, kishte vetëm 2 herë më pak mbështetës të Brexit, por ata ishin gjithashtu 5 herë më aktivë se aktivistët kundër.

Po ashtu, përmendim përdoruesit nga Rusia të mediave sociale dhe ndikimin të rezultati të zgjedhjeve në 2016 në SHBA, midis Hilary Clinton dhe Donald Trump. Për këtë, 13 shtetas rusë dhe agjenci ruse interneti u paditën nga DASH si komplot për të prishur zgjedhjet amerikane, por Putini këmbënguli se të kjo nuk ishte punë e qeverisë ruse. Edhe në zgjedhjet në Francë dhe Gjermani në 2017, u konfirmua se ¼ e historive politike të shpërndara në Twitter ishin bazuar në dezinformata, prandaj me ligj u vendosen gjoka mbi 50 milionë dollarë mediave që nuk heqin menjëherë ato me përmbytjen të paligjshme.

Referencat: Maj 2024, SHBA dhe BE kanë konfirmuar ngritjen e një mekanizmi të përbashkët koordinues që fokusohet tek lufta kundër dezinformimit që prodhohet nga Rusia dhe Kina në Ballkanin Perëndimor. Ndër të tjera theksohet, se ky mekanizëm i ri do të forcojë “mbrojtjen nga dezinformimi” si dhe forcimin e qeverisjeve demokratike dhe sundimin e ligjit rajon. Më qartë se kaq nuk ka si të thuhet/bëhet.

Direktiva 483 e APN, duke marrë në konsideratë mësimet e nxjerra në Ukrainë, Ballkan, etj., Asambleja Parlamentare konkludon se dezinformimi mbetet një kërcënim serioz për paqen, sigurinë, stabilitetin afatgjatë, rendin demokratik, kohezionin dhe interesat gjeopolitike të Aleancës. Nëpërmjet kësaj rezolute, NATO rekomandon dhe nxit vendet anëtare, posaçërisht të Ballkanit perëndimor, për të ngritur mekanizma gjithëpërfshirëse të vlerësimit të riskut si dhe mbrojtjes nga dezinformimi.

Kodi i Sjelljes ndaj Dezinformimit, 2022. Në vitin 2022, Parlamenti European dhe një listë aktorësh të medias, platformat online, dhe shoqëria civile, për herë të parë nënshkruan këtë marrëveshje/kod për të mbrojtur nga dezinformimi, duke marrë përgjegjësitë reciproke.

Qendra Europiane e Ekselencës për luftën Hibrite (European Center of Excellence for Countering Hybrid Threats), e cila në 7 vite eksperiencë mbetet referencë e mirënjohur për vlerësimet dhe rekomandimet strategjike në lidhje me mbrojtjen nga rreziqet hibride përfshi dezinformimin.

Pse mekanizmat e mbrojtjes nga dezinformimi Ruso-Kinez dhe Serb, mbeten domosdoshmëri për Ballkanin? Pse kjo mbart vëmendje strategjike për Aleancën Euroatlantike?!

Duhet ta pranojmë se propaganda bolshevice mbetet një histori suksesi jo vetëm në Ballkan. Por, mbas 2014 (Krimesë), Rusia e ka modernizuar industrinë e dezinformimit që përfshin Institucionet, Patrikanën, grupe dhe kompani private, si: Akademia e Shkencave, Byroja Federale Kundër Inteligjencës, televizioni shtetëror (Kanali 1, Rusia 2, Rusia 24, Rusia Sot, etj.), që militojnë vlerat ruse dhe Putinin; që manipulojë opinionin brenda dhe jashtë Rusisë, duke punuar me diasporat rusisht folëse, përfshirë jo - rusë të komuniteteve në mbështetje të urrejtjes ndaj Ukrainës, Perëndimit, SHBA-së, NATO-s, BE-së, Shqiptarëve, etj.

Përqasja e Rusisë - Putiniste në rajon paraqet një zgjatim të

fushatës së dezinformatave në Ukrainë ndërmjet 2014 - 2024, duke u bërë shembull i prodhimit të informacionit të rremë, krijimit të miteve politike dhe falsifikimit të historisë për të justifikuar vendimet politike të marra si brenda Rusisë ashtu edhe në rrafshin gjeopolitik. Për ta konfirmuar këtë, përmendim një studim të porositur nga PE, i cili ngrinte alarmin se: “dezinformimi Rus është pjesë endemike dhe e kudondodhur e politikës në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor”, ndërsa shton se: “ka prova se shumica e mediave në Ballkanin Perëndimor janë të paktën bashkëpunëtorë në një formë të dezinformimit ose në një tjetër”.

Sigurisht, qendra e gravitetit mes aktorëve të jashtëm në rajon, mbetet Rusia, që nëpërmjet dezinformimit, përpaket të përforcjë çdo ndarje sociale, politike, ekonomike, historike, fetare dhe ideologjike, që do të minonte kohezionin politik, ekonomik, fuqinë ushtarake dhe orientimin euroatlantik. Ndërsa Kina, me investime pragmatike, kërkon të vendojë hegjemoninë në tregjet ekonomike në rajon dhe Mesdhe.

Por, pavarësisht diskutimeve rreth dezinformimit, aktorët e huaj nuk janë fajtorët e vetëm, pasi shumica e njerëzve dhe organizatave që prodhojnë dhe shpërndajnë dezinformim janë aktorë të brendshëm. Ndër aktorët, e brendshëm qëndron presidenti serb Vuçiç, i cili pasi ka dështuar për të bërë viktimën apo për të pirë nga 4 nëna (Moskë, Uashington, Bruksel, Pekin), së fundmi dalldisi se: “solidariteti i BE-së është një përrallë”, presidentin Xi Jinping e quajti “vëllain e tij” si dhe bëri thirrje për “miqësi prej çeliku” me Kinën.

Me gjithë përpjekjet dhe përparimin për t’u larguar nga urrejtja dhe gjakderdhja shekullore, politika e jashtme në Ballkanin Perëndimor mbetet ende konfuzë. Por nuk ka askush mëdyshje se masha e burimeve të dezinformimit Rus dhe Kinez në Ballkan mbetet Serbia dhe fundamentalistët e tipit Dodik. Sondazhet në Serbi dhe republikën Srpska tregojnë se mbi 57% mbështesin politikën e jashtme me Rusinë dhe Kinën, ndërsa vetëm 13% besojnë BE-në. Ndërkohë, për RSH, Kosovë, MV, Mal i Zi, mbi 75% besojnë në BE/NATO.

Ndërsa në raport me Kosovën, përsërisim se, përveç kërcënimeve donkishoteske me fuqinë ushtarake (70% e ekspozuar në kufi me Kosovën/KFOR), Beogradi ka ri-nënshkruar (si karshillëk ndaj USA) marrëveshje strategjike bashkëpunimi me Rusinë, duke e mitizuar Putinizmin si një mbrojtëse të interesave kombëtare serbe, ndërsa cinikët mendojnë që: “orientimi pro-rus mbetet edhe nëse vetë Rusia nuk do të ekzistonte”.

Konkluzione dhe 5 rekomandime strategjike:

Dezinformimi mbetet një kërcënim serioz për bashkëjetesën paqësore, demokracinë funksionale, axhendën e integritetit euroatlantik, në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni, Serbi, Bosnje-Hercegovinë), si dhe interesat kombëtare në rajon dhe në Mesdhe.

Aktorët e jashtëm, mbeten Rusia në rrafshin gjeopolitik, Kina në rrafshin ekonomik, si dhe masha e tyre, Serbia e oscilacioneve

të Millosheviçit. Veçmas, apo së bashku manipulojnë informacionin si dhe konfuzionin demokratik, gjeopolitik për të çuar përpara interesat e tyre në rajon.

Aktorët brenda vendit, që ushqejnë dezinformimin janë politikanë mendjendryshkur, shtetarë të korruptuar, sekserë të pushteteve, interesat e krimit të organizuar dhe mediat e paguara jo vetëm në Beograd dhe Banja Luka, që kanë të vetmin qëllim për të helmuar dhe devijuar orientimin e vendeve si dhe pikëpamjet e njerëzve, duke na bërë të pyesim për kë do të votojmë dhe kujt duhet t’ia besojmë ardhmërinë euroatlantike? Konfuzioni gjeopolitik për shkak të Luftës në Ukrainë dhe zgjedhjeve në USA (Kush do ta fitojë luftën? Po zgjedhjet në SHBA?); ndërsa BE-ja ende ngurron për integrimin e 6 vendeve të rajonit me qasjen ndaj zgjerimit në lindjen komuniste: “better in than out”, e aplikuar me sukses nga NATO.

Mbështetur në këtë rezime, në vijim gjeni 5 (pesë) rekomandime strategjike:

(1). Ngritja (jo vetëm për të qenë OK me Uashingtonin dhe Brukselin) e Komisionit gjithëpërfshirës Parlamentar të Dezinformimit.

(2). Ngritja e Bordit të Dezinformimit (BD) si një bord këshillues, monitorues dhe kontrolli i Kuvendit për mbrojtjen e interesave kombëtare nga rreziqet hibride, me fokus dezinformimin.

(3). Zhvillimi i një koncepti “on paper” (strategji) dhe procedurave standarde për të përcaktuar aktorët dhe përgjegjësit/ë e mbrojtjes nga dezinformimi Ruso – Serbo – Kinez, por jo vetëm.

(4). Sipas eksperiencës së vendeve të BE/NATO, Hartimi dhe miratimi i marrëveshjes/Kod Sjelljes ndaj rreziqeve të Dezinformimit, i cili do të duhet nënshkruar nga një listë aktorësh shtetërorë (kuvendi), me strukturat relevante të Inteligjencës, mediat, shtypi, platformat online, shoqëria civile, qendra studimi, NGO, etj., që bashkohen për të luftuar dezinformimin dhe angazhohen për përmbytjen e detyrimeve të tyre.

(5). Anëtarësimi i RSH (nënshkrimi MoU) në Qendrën Europiane të Ekselencës për mbrojtjen nga Kërcënimet Hibride (përfshi dezinformimin), e cila në vetëm 7 vite eksperiencë shërben si një referencë e mirënjohur për vlerësimet dhe rekomandimet strategjike në përballjen me rreziqet hibride, përfshi këtu dhe dezinformimin. HCoE është themeluar në Helsinki në 2017 me 9 anëtar; zgjeruar me 35 Shtete të BE/NATO-s, përfshi vendet e rajonit (jo RSH dhe Kosova) si Mal i Zi, Kroaci, Maqedoni, Slloveni, etj.

Në përmbyllje “torta e helmatisur nga dezinformimet e Rusisë – Putiniste”; ambiciet gjeo-ekonomike të Kinës, ushtarët e oscilacioneve të Millosheviçit në Beograd apo Dodikët e droguar nga Moska, jo vetëm kërcënojnë sovranitetin territorial të Kosovës, por edhe stabilitetin dhe axhendën e integritetit të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (përfshi Serbinë), si dhe sfidojnë seriozisht vlerat demokratike, fuqinë ushtarake, kohezionin dhe interesat e Aleancës Euroatlantike në rajon (USA/NATO/UK/BE”).

3 gratë e fuqishme të Europës

Gratë që do drejtojnë Europën

Në një botë të rrezikshme, Europa 'e vjetër', e gjen veten në një pozitë alarmante. Në Ukrainë, vazhdon lufta më e përgjakshme që nga viti 1945, ndërkohë që Rusia, përbën një kërcënim për hapësirën kibernetike. Ekonomia e kontinentit, është e ndjeshme ndaj goditjeve të shkaktuara nga politika industriale. Populistët euroskeptikë, janë duke ecur lart në sondazhe.

Për t'u përballur me këto rreziqe, Europa ka nevojë, së paku, për një udhëheqje koherente në Bashkimin Europian. Ajo gjithashtu, duhet të mbajë ekstremistët jashtë pushtetit.

Nëse do të ketë sukses, varet pjesërisht në zgjedhjet e tre grave: Ursula von der Leyen, presidentja e Komisionit Europian, Giorgia Meloni, kryeministre e Italisë dhe Marine Le Pen, populistja kryesore e Francës.

Ursula von der Leyen, ka udhëhequr krahun ekzekutiv të BE-së, që nga viti 2019, dhe kandidoi për një mandat të dytë. Ajo e meriton një mandat të dytë.

Ka bërë një punë të mirë, duke marshuar përgjigjen e fortë kolektive të BE-së, ndaj agresionit të Vladimir Putinit dhe duke ndihmuar, në thellimin e integritetit europian, në një kohë vendimtare, për shembull duke nxitur një program novator për emetimin e borxhit të përbashkët.

Një konservatore gjermane gjakftohtë, ajo e ka vënë gjithashtu Komisionin Europian, në qendër të vendimmarrjes, kur marrëdhëniet franko-gjermane, kanë qenë të acaruar. Duke pasur parasysh kërcënimet, nevoja për një udhëheqje të fortë dhe të unifikuar, nuk ka qenë kurrë më e madhe.

Në teori, ajo do të gëzojë mbështetjen e grupimeve konservatore, liberale dhe socialiste.

Si kandidatja kryesore për grupin kryesor të EPP-së, ajo tani do të marrë edhe pesë vjet të tjera në krye të krahut ekzekutiv të BE-së.

Por, për shkak se politika është bërë kaq e fragmentuar, këto tre grupime, parashikohen kolektivisht të fitojnë vetëm një shumicë të vogël të vendeve. Zonja Meloni, kryeministre e Italisë, që nga viti 2022 dhe liderja e partisë së djathtë Vëllezërit e Italisë (Fratelli d'Italia), e cila është kthyer, nga një forcë kryengritëse, në drejtimin e vendit. Me mbështetjen e saj, zonja von der Leyen, mund të ketë një shans më të mirë për të fituar një shumicë parlamentare, për një mandat të dytë, në postin kryesor të BE-së. Ajo në një takim me Giorgia Melonin është shprehur: "Kam punuar shumë mirë me Giorgia Melonin".

Këto fjalë, dhe ideja e çdo lloj pakti, që përfshin partinë e Melonit, ka zemëruar liberalët dhe figurat e BE-së, duke përfshirë disa në Partinë Social Demokrate në pushtet në Gjermani, dhe partinë e Emmanuel Macron në Francë. Për ta, zonja Meloni është në të njëjtin nivel si Viktor Orban, njeriu i fortë i Hungarisë.

Ajo ka bërë kauzë të përbashkët, me znj. von der Leyen, për çështje të tilla si emigracioni i paligjshëm, dy gratë kanë bërë



vizita të përbashkëta, në vendet e Afrikës së Veriut, duke arritur marrëveshje me autokratë, për të frenuar rrjedhën. Ajo ka qenë një mbështetëse e fortë e Ukrainës, ndryshe nga disa shokët të saj, në të djathtën populiste.

Zonja Lë Pen, partia e saj National Rally, është përpjekur të riemërojë veten, si një figurë kryesore. Një rrugë, mund të sigurojë udhëheqje të qëndrueshme, në nivel BE-je, dhe të tregojë sesi të moderuarit, mund të përballen me inteligjencë, me të djathtën populiste.

Partia e francezes Marin Lë Pen ka hyrë me ide të qarta në zgjedhjet për parlamentin e ri europian. Dy nga objektivat kryesorë janë eliminimi i Komisionit Europian dhe reformimi i vetë parlamentit. Eliminimi i Komisionit Europian dhe reformimi i parlamentit janë disa nga propozimet e partisë së Marin Lë Pen që prezantoi në Strasburg manifestin e saj për zgjedhjet parlamentare europiane. Lë Pen u shpreh se dëshiron të çlirojë kombet nga një Bashkim Europian që i mbyt dhe i privon nga sovraniteti i tyre, dhe që seriozisht minon demokracinë.

Por ideja e mos pasjes së një krahut ekzekutiv dhe eliminimi i gardianit të traktateve konsiderohet si absurd nga eurodeputetët gjermanë. Nga radhët e partisë së gjelbër shprehen se Komisioni Europian i shërben interesave të të gjithëve. Lë Pen kërkon që të jenë shtetet anëtare që të vendosin, në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një reformimi të parlamentit europian që u shërben kombeve.

Sipas tyre parlamenti europian është i përbërë nga deputetë kombëtarë, dhe kjo formulë ekziston që nga 1979. Partia e Lë Pen kërkon dhe ndryshime Brenda bankës qendrore dhe në Fronteks, i cili merret me kufijtë. Sipas sondazheve partia është në të njëjtin nivel votash me grupimin politik të Emanuel Makron.

Rezervat materiale, në konceptin e integruar logjistik të NATO-s



KOLONEL ARBEN DHULI, IKSHU

Është e rëndësishme të pranohet se funksionet e ndryshme logjistike bashkohen për të formuar tërësinë e mbështetjes logjistike. Planifikimi logjistik e ka origjinën në udhëzimet e politikave kombëtare, të NATO-s dhe duhet të koordinohet me të gjitha degët e stafit në fjalë, qofshin ato operacionale, administrative apo logjistike, ushtarake apo civile. Një ekzaminim i shkurtër i funksioneve kryesore të logjistikës e tregon qartë këtë. Logjistika e prodhimit ose e blerjes mbulon materialin, nga faza e parë e ciklit jetësor deri në asgjësimin përfundimtar nga inventari. Pjesa e parë e ciklit, nga specifikimi, projektimi dhe prodhimi është qartësisht një funksion i logjistikës së prodhimit. Marrja në shërbim e pajisjeve, shpërndarja dhe ruajtja e saj, riparimi, mirëmbajtja dhe asgjësimi janë padyshim një detyrë logjistike e konsumatorit. Megjithatë, dizajni fillestar i pajisjeve që është pjesë e logjistikës së prodhimit duhet të marrë parasysh aspektet e konsumatorit të riparimit dhe mirëmbajtjes, dhe për këtë arsye përfshin të dyja disiplinat. Furnizimi mbulon të gjithë materialin dhe artikujt e përdorur në pajisjet, mbështetjen dhe mirëmbajtjen e forcave ushtarake sipas klasave të furnizimit. Funksioni i furnizimit përfshin përcaktimin e niveleve të stokut, sigurimin, shpërndarjen dhe rimbushjen.

Logjistika e integruar krijon një sistem koheziv. Çdo aktivitet i zinxhirit të furnizimit është i ndërruar ku përfshihen: prokurimi i materialeve, prodhimi, magazinimi, shpërndarja, transporti, furnizimi, marketingu. Me fjalë të tjera, burimet, teknologjia dhe proceset organizative janë të ndërlidhura. Ky koncept u shfaq si një strategji për të kapërcyer sfidat logjistike në shitjen me pakicë të gjithë kanaleve. Duke rregulluar dhe thjeshtuar të gjitha proceset, organizatat mund të mbajnë ritmin me kërkesën e klientëve për përmbyshje të shpejtë të porosive dhe dërgesa brenda 24 orëve. Me logjistikën e integruar, organizatat mund të zhvillojnë fleksibilitet dhe shkathtësi për të përballuar ndërprerjet

e zinxhirit të furnizimit dhe për të zbutur rreziqet. Kur kompanitë zbatojnë këtë model, proceset logjistike si përpunimi i porosive, shpërndarja, zhdoganimi, përcjellja, logjistika e kundërt, etj., nuk funksionojnë më në kaponone.

Aspekti gjithëpërfshirës i logjistikës së integruar ka modifikuar mënyrën se si organizatat përgatiten për efikasitet të shtuar dhe avantazh konkurrues. Në fund të fundit, logjistika e integruar bashkon logjistikën hyrëse dhe dalëse për të formuar një tërësi gjithëpërfshirëse dhe të lehtë për t'u kontrolluar.

Fazat e prodhimit ose të prokurimit përfshijnë trajtimin e materialit, planifikimin e blerjeve, komunikimin me furnitorët dhe transportin e inventarit në magazina ose qendrat e përmbyshjes. Zgjidhjet e integruara logjistike drejojnë planin e prodhimit, inventarin dhe operacionet e magazinimit. Funksioni i logjistikës së integruar është optimizimi i planifikimit dhe menaxhimit të inventarit në kohë reale me teknologji dhe flukse pune të automatizuara. Kjo lejon parashikime të avancuara, rimbushje në kohë të stoqeve, planifikimin e kohës së prodhimit dhe parandalimin e rezervave dhe humbjeve.

Plotësimi dhe dërgimi. Logjistika e integruar u mundëson organizatave të tregtisë elektronike të mikro-menaxhojnë përpunimin, zgjedhjen, paketimin, shpërndarjen dhe dërgimin e porosive. Firmat mund të shpërndajnë në mënyrë strategjike produkte te partnerët e shitjes me pakicë dhe qendrat e shpërndarjes me dukshmëri të zgjeruar dhe parashikimin e kërkesës. Me të gjithë palët e interesuara në komunikim, firmat mund të menaxhojnë ruajtjen, të automatizojnë përmbyshjen dhe të përdorin teknologji si IT dhe AI për saktësinë e porosive dhe dërgimin e shpejtë. Së bashku me menaxhimin e magazinës, logjistika e integruar në të njëjtën kohë thjeshton transportin. Kur të gjitha sistemet janë në linjë, bëhet më e lehtë për të fituar shikueshmëri të plotë në statusin dhe përmbyshjen e porosive.

Shpërndarja. Logjistika e integruar koordinon transportin, ndarjen (sipas llojit) dhe shpërndarjen e produkteve. Me përparimet në sistemet e menaxhimit të transportit, magazinimin strategjik dhe menaxhimin e inventarit, shpërndarja në kohë është shtuar. Logjistika e integruar ndikon që çdo element në departamentin e logjistikës të funksionojë në kohezion, duke reduktuar ndryshimet në kohën e tranzitit dhe të përpunimit. Për më tepër, mund të jetë e dobishme nëse firmat lëvizin drejt një modeli biznesi prodhimi në kohë.

Marketingu. Funksioni i marketingut përfshin koordinimin e paketimit të nevojshëm për të forcuar proceset logjistike. Për më tepër, logjistika e integruar koordinon departamentet e marketingut me pjesën tjetër të organizatave. Kjo lejon krijimin e



fushatave efektive të marketingut që ndikojnë në inventarin dhe dizajnin e produktit. Funkzioni i marketingut përfshin gjithashtu publikimin e informacionit të saktë mbi shërbimet dhe zgjerimin e prezencës së biznesit ndërmjet klientëve dhe partnerëve.

Teknologjia. Logjistika e integruar bashkon proceset, teknologjinë, furnitorët, shitësit dhe transportuesit për të ruajtur të dhëna të sakta dhe dukshmëri të plotë të zinxhirit të furnizimit. Përfundimisht, ajo vendos skenën për përmbushjen e shumë kanaleve, logjistikën shumë kanalëshe.

Logjistika e integruar përmbledh përmirësime teknologjike, praktika të rrjedhshme të biznesit dhe avancime të prokurimit në të gjitha fazat e një sistemi produkti. Prandaj, ajo shkurton ciklin e jetës së një produkti në të gjitha pikat, siç shpjegohet më poshtë:

- Prokurimi dhe menaxhimi i materialeve përfshijnë planifikimin e prodhimit, burimin, trajtimin dhe optimizimin. Ajo gjithashtu përfshin zgjedhjen e furnitorëve, monitorimin e kontratave të furnitorëve dhe planifikimin e blerjeve. Logjistika e integruar punon drejt adoptimit të strategjive për zvogëlimin e kohës së ofritit në tregtinë elektronike me sisteme të përmirësuara të rimbushjes, ruajtjes dhe transportit. Duke nxitur procese automatike dhe duke vendosur lidhje me furnitorët, rrit efikasitetin në dhënien e burimeve, qoftë për dropshipping (ku produktet dërgohen direkt nga furnizuesi te klienti dhe paguhet vetëm për atë që shitet) pra nuk ka kosto fillestare të inventarit apo për shitje me pakicë të gjithanshme.

- Logjistika e integruar ka dy nëngrupe kritike: inventarin dhe magazinat. Logjistika e integruar funksionon duke koordinuar të dhënat e inventarit, duke rishikuar buxhetet e ruajtjes dhe logjistikës dhe duke analizuar historinë e shitjeve për kërkesën. Kështu, inventari mund të vendoset në mënyrë strategjike në magazina më afër pikave të nxehta të kërkesës dhe të ndahet në përputhje me rrethanat midis transportuesve me kosto të ulëta.

Në mënyrë të ngjashme, duke përdorur sisteme dhe mjete inteligjente të menaxhimit të depove, si skanerët e inventarit.

Këto përfshijnë përpunimin e porosive, metodat e marrjes, ngarkimin dhe shkarkimin dhe rimbushjen e stoqeve. Logjistika e integruar bashkon pikat e forta të personelit të magazinës, operacionet e shitjes dhe përpunimin e porosive. Me të dhënat mbi parashikimin e kërkesës dhe menaxhimin e transportit, firmat mund të shpërndajnë më shpejt në zonat me kërkesë të lartë. Me menaxhimin efikas të porosive, logjistika e integruar mund të parashikojë kërkesat dhe nevojat e klientëve.

Logjistika e integruar optimizon transportin dhe shpërndarjen me shpejtësi dhe saktësi. Kjo bëhet nëpërmjet dixhitalizimit të fuqisë punëtore, planifikimit të rrugëve dhe bashkëpunimeve në kohë reale në të gjithë rrjetin e zinxhirit të furnizimit. Ajo menaxhon pika të shumta përfundimtare si trajtimi i produktit, pagesat, planifikimi i dërgesave, zhdoganimi. Logjistika e integruar gjithashtu bën të mundur zbatimin e transportit intermodal (që përfshin transportin nga më shumë se një formë transportuesi gjatë një udhëtimi të vetëm) dhe multimodal (që ka ose përfshin disa mënyra, modalitete ose maksimum shpërndarje) të mallrave. Me drejtimin dinamik, integrimin me shumë transportues dhe një ekip të centralizuar transporti, logjistika e integruar e çon përpara dërgimin dhe shpërndarjen. Logjistika e integruar promovon planifikimin sistemik me fazat e kontrollit dhe menaxhimit që punojnë së bashku. Me integrimet e proceseve dhe koordinimin e sigurt, gjurmimi i gabimeve bëhet më i lehtë.

Kur kompanitë e tregtisë elektronike përfshijnë menaxhimin e integruar të logjistikës, ato ndërtojnë sisteme për të parashikuar parashikimet e gabimeve dhe për të zbuluar rrezikun. Ata mund ta bëjnë këtë në tre mënyra: Së pari, identifikon të metat ekzistuese të aplikacionit për korrigjim të menjëhershëm; Së dyti, parashikimi i rreziqeve; Së treti, vizualizimi i situatave të paparashikuara në financat, blerjen e materialeve, produktivitetin dhe kënaqësinë e klientit.

Sistemi operacional i firmës mund t'i nënshtrohet kontrolleve të përsëritura pasi përmirësimi është një proces i vazhdueshëm. Kjo



mund të jetë mirëmbajtje rutinë ose kurse trajnimi për të rregulluar mirë procedurat dhe për të maksimizuar funksionalitetin. Pas testimit, raportet e analizës mund të gjenerohen për të përshkruar përmirësimet dhe rekomandimet për sistemet e prirur ndaj gabimeve.

Kjo është një detyrë qendrore në menaxhimin e proceseve të tepërta dhe pakënaqësisë së klientit. Një nga faktorët kryesorë të koston që ndikon në të gjitha bizneset e tregtisë elektronike është logjistika. Me një qasje të efektshme ndaj logjistikës, firmat mund të ulin kostot në pika të shumta problematike, nga prokurimi te transporti, magazinimi deri te dorëzimi. Kur të gjitha proceset funksionojnë së bashku dhe informacioni shpërndahet nëpër departamente, bëhet më e lehtë të mbash gjurmët e shpenzimeve dhe humbjeve aktuale. Me ciklet e ndërlidhura të produkteve, zgjidhjet e integruara logjistike përfshijnë një numër më të vogël palësh që lejojnë kompanitë të përdorin çmime konkurruese. Firmat gjithashtu mund të dallojnë joefikasitetet dhe të krijojnë më shumë fusha për kursime. Rezultati neto përkthehet në një marzh më të madh fitimi dhe kosto të reduktuara operacionale.

Mbështetja Logjistike e Integruar (ILS)

Një qasje e disiplinuar, e unifikuar dhe përsëritëse ndaj menaxhimit dhe aktiviteteve teknike të nevojshme për të: (1) integruar konsideratat mbështetëse në projektimin e sistemit dhe pajisjeve; (2) zhvilluar kërkesa mbështetëse që lidhen vazhdimisht me objektivat e gatishmërisë, për të hartuar, dhe ndaj njëri-tjetrit; (3) marrë mbështetjen e nevojshme; (4) të siguruar mbështetjen e nevojshme gjatë fazës operative me kosto minimale.

Duke bashkuar prodhimin, menaxhimin, teknologjinë dhe marketingun, logjistika e integruar optimizon aspekte të shumta. Këto përfshijnë dizajnin e produktit, veçoritë, kriteret e cilësisë dhe paketimin për t'u përmbajtur pritshmërive të klientit.

Fleksibiliteti dhe elasticiteti janë bërë parime thelbësore sot, pasi ne jemi dëshmitarë të llogarive të shumta të ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit. Një nga përfitimet më të mira të logjistikës së integruar është shkathtësia e zinxhirit të furnizimit me dukshmëri nga fundi në fund dhe bashkëpunime midis ekipeve të ndryshme. Meqenëse zgjidhjet e integruara të logjistikës përpilojnë të gjitha proceset për t'u përgatitur së bashku, ato mund t'i përgjigjen ndryshimeve të papritura, vonesave dhe rënies së shpejtësisë. Për më tepër, firmat mund të krijojnë struktura elastike me zgjidhje

logjistike të integruara si automatizimi, ndërfaqja e dizajnit, shkëmbimet IT.

Çelësi për menaxhimin pa probleme të zinxhirit të furnizimit janë të dhënat që rritin efikasitetin dhe ndikojnë shumë në vendimmarrjen e informuar. Lidhja së bashku e të gjitha të dhënave dhe sistemeve logjistike përmirëson integritetin, qëndrueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave. Kjo, nga ana tjetër, ndikon pozitivisht në shërbimin ndaj klientit, rrit operacionet e brendshme dhe përmirëson teknikat e marketingut. Më e rëndësishmja, përmirëson ndjeshëm dukshmërinë në mënyrë që porositë të arrijnë në destinacionin e tyre në kohë dhe të paprekura.

Aspekti i parë i logjistikës së integruar

është planifikimi. Fillon me vendosjen e qëllimeve për krijimin e një grafiku rrjedhash për të kuptuar të gjitha funksionet, proceset dhe personelin e përfshirë. Është gjithashtu thelbësore t'i jepet përparësi identifikimit të mangësive të komunikimit dhe përmirësimit të tyre brenda dhe ndërmjet departamenteve të ndryshme. Një zinxhir furnizimi elastik dhe i shkathët ka të gjitha burimet, personelin, teknologjinë, partneritetet dhe proceset në të njëjtën faqe.

Hapi i dytë është përmirësimi i sistemit logjistik, duke identifikuar mundësitë e bashkëpunimit dhe duke konsoliduar aktivitetet logjistike. Për shembull, drejtuesit e menaxhimit dhe shitjeve mund të analizojnë së bashku konkurrencën për të ndërtuar politika për të rritur avantazhin e tyre konkurrues.

Mënyra e tretë është të trajnohet dhe zbatohet një model "biznesi i orientuar nga njerëzit", ku kompetencat individuale zhvillohen për të lulëzuar në situata me kërkesa të larta. Këtu, departamenti i burimeve njerëzore luan një rol qendror në përpunimin e individëve me përshtatjen e duhur të punës. Trajnimi i teknikëve, operatorëve dhe personelit për t'i pajisur ata me aftësi praktike të përshtatura me nevojat organizative janë jetike për fillimin e tyre drejt logjistikës së integruar.

Mënyra e katërt është përforsimi i vazhdueshëm i efektivitetit operacional me mirëmbajtje rutinore për një sistem operacional optimal. Kompanitë zgjedhin zgjidhje të Logjistikës së Integruar për dy arsye kryesore: kosto dhe efikasitet. Ata mund të menaxhojnë faza të shumta në lëvizjen e mallrave nga një burim i vetëm. Logjistika e integruar lejon kompanitë të ofrojnë produkte tek konsumatorët fundorë me kosto dhe efikasitet. Kjo ndihmon në përmirësimin e përvojës së klientit, ndërkohë që i bën operacionet e biznesit më të shkathët. Ai u lejon kompanive të rrisin produktivitetin e tyre përmes konsolidimit të informacionit dhe thjeshtimit në ekzekutim.

Burimet materiale, rezervat strategjike, nivelet dhe planëzimi i rezervave materiale

Qeveria e Republikës së Shqipërisë siguron burime materiale të mjaftueshme për zhvillimin dhe transformimin e Forcave të Armatosura, duke u fokusuar në sigurimin e atyre burimeve që shkojnë për krijimin e kapaciteteve operacionale, që i bëjnë Forcat e Armatosura të afta për kryerjen e misionit të tyre kushtetues dhe të ndërveprueshme me forcat ushtarake të

NATO-s. Gjithë burimet materiale që vihen në dispozicion të FA-së, si nëpërmjet prokurimeve nga buxheti i mbrojtjes, ashtu edhe nga ndihmat e aleatëve dhe të partnerëve, synohet të jenë në përputhje me standardet e NATO-s. Sigurimi i sasisë së mjaftueshme të burimeve të mbrojtjes dhe standardizimi i tyre përfshin të gjitha fushat e mbështetjes logjistike të FA-së, armatimin, ushqimin, veshmbathjen, karburantin, shërbimet e trupës, transporti dhe mirëmbajtja janë fusha të rëndësishme që mbështeten në mënyrë harmonike me burime materiale. Një ndërthurje efektive e sektorit shtetëror me atë privat siguron burime materiale cilësore dhe në kohën e duhur për mbështetjen e objektivave të mbrojtjes.

Rëndësia e krijimit të rezervave strategjike / Furnizimi dhe funksioni i shërbimit

Procesi i Furnizimit me Materiale: (Burimi-Porosi-Marrje-Magazinim-Shpërndarje-Kthim).

Njësitë = Organizata Taktike, ku kërkohet gatishmëria.

Kërkesa = Nevoja për materiale dhe shërbime.

Gjendja = Gjendja e autorizuar e stokut në magazinat e Bat Mb të K K.

Depot / Magazinat = Depot kryesore të mirëmbajtjes dhe furnizimit. Logjistika e Kthimit = Kanalet e kthimit për riparim në nivelin e kabanoneve. Blerjet = Prokurimi i materialeve dhe furnizimeve të nevojshme (Klasat 1-5).

Në kuptimin më të plotë, logjistika mbulon të gjitha ato aspekte të operacioneve ushtarake që merren me përcaktimin, marrjen në dorëzim, magazinimin, transportimin, shpërndarjen, mirëmbajtjen, shpërnguljen dhe sistemimin e resurseve materiale të FA-së.

Rezervat materiale krijohen në funksion të misionit kushtetues të FA-së. Krijimi i tyre mbështetet në kapacitetet e disponueshme të komandave, në buxhetin e mbrojtjes dhe në burimet kombëtare. Ato përdoren gjithashtu për mbështetjen e Forcave të Armatosura dhe popullsisë civile në përballimin e situatave të jashtëzakonshme që shkaktohen nga forca madhore si tërmete, përmblytje, epidemi, ndotje të mjedisit etj., në kohë paqeje, krize dhe lufte.

Forcat e Armatosura evidentojnë burimet kombëtare (publike apo private) në interes të misioneve të tyre dhe në përputhje me legjislacionin përkatës, planëzojnë masa konkrete, për përdorimin e tyre në rast nevojë.

Rezervat materiale përshkallëzohen sipas kriterëve doktrinore dhe misioneve specifike të njësive. Struktura dhe niveli i rezervave materiale si dhe shkalla e gatishmërisë së tyre propozohen nga Këshilli i Ministrave të RSH. Planifikimi i rezervave për furnizim të FA-së, do të jetë sipas kërkesave, ndërsa gjendja e materialeve, transferimi, identifikimi i nevojave dhe ndjekja e ciklit jetësor do të jetë një proces i vazhdueshëm;

Hartimi i konceptit të rezervës materiale për situata të jashtëzakonshme si dhe planifikimi i rezervave për furnizim të FA-së, do të jetë sipas kërkesave, ndërsa gjendja e materialeve, transferimi, identifikimi i nevojave dhe ndjekja e ciklit jetësor do të jetë një proces i vazhdueshëm;

Menaxhimi i burimeve materiale do të vijojë të jetë pjesa më e rëndësishme e misionit të strukturave logjistike të FA-së, të cilat kanë si qëllim sigurimin e kapaciteteve logjistike të domosdoshme për mbështetjen e FARSH brenda dhe jashtë vendit, si dhe minimizimin e rrezikut të krijimit të stokeve. Ky risk luftohet duke

bërë një planëzim të saktë dhe të llogaritur mirë mbi bazën e normave të miratuara.

Burimet materiale në përdorim të FARSH-së do të përdoren me synim përmirësimin e kushteve të jetesës, punës dhe stërvitjes së personelit, në sigurimin e mbështetjes logjistike të domosdoshme për operacionet e FA-së brenda vendit, mbështetjen e trupave që angazhohen në misione/operacione jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, transportin strategjik (ajror, detar, tokësor dhe i kombinuar) për dislokimin dhe ridislokimin e trupave të FARSH-së, etj.

Mbështetja në operacione do të sigurohet edhe me marrëveshje me shtetet e tjera pjesëmarrëse në operacionet e përbashkëta, me agjencitë e mbështetjes të NATO-s, si dhe me kontraktorë vendas. Furnizimi do të organizohet dhe funksionojë si vijon:

Koncepti bazë i furnizimit bazohet në ditët e furnizimit (DF) për të gjitha klasat. Ai do të realizohet nga lart poshtë deri në nivel force (Komandë Mbështetëse - Komandë Force, ose deri në reparte që janë në vartësi të drejtpërdrejtë nga SHP/MM). Synimi kryesor do të jetë krijimi i kapaciteteve për të përballuar angazhimin e qëndrueshëm (me sigurim të rotacionit të nevojshëm) në kuadër të misioneve ushtarake të NATO-s, me një batalion këmbësorie të përforcuar me elementë mbështetës.

Në nivel Taktik (batalion) do të jetë i kompletuar si vijon: 3 DOS (Ditë Furnizimi) në kompani; 2 DOS (Ditë Furnizimi) në batalion; 2 DOS (Ditë Furnizimi) në Grup-batalion; 23 (Ditë Furnizimi) DOS në Elementët e Mbështetjes Kombëtare (NSE), e cila ngrihet si strukturë nga KM, rast pas rasti sipas misioneve.

Mbështetja në operacione jashtë vendit me kohëzgjatje mbi 30 ditë, do të sigurohet më anë të marrëveshjeve me shtetet pjesëmarrëse në operacionet e përbashkëta, me vendet që janë udhëheqëse (Lead Nation) për mbështetjen logjistike, si dhe duke përdorur marrëveshjet e lidhura nga agjencitë e mbështetjes së NATO-s në operacione.

Forcat e Armatosura mbajnë tre lloj rezervash materiale:

Niveli strategjik. Mbështet operacionet ushtarake të Forcave të Armatosura në nivelin strategjik që kushtëzohen nga objektiva dhe nisma të përcaktuara në strategjinë ushtarake, të cilat kanë për qëllim aritjen e objektivave strategjike politiko-ushtarake. Logjistika në nivelin strategjik merret me mobilizimin, marrjen në dorëzim, mbrojtjen, lëvizshmërinë strategjike dhe përqendrimin strategjik të aseteve logjistike.

Niveli operacional. Përqendrohet në krijimin dhe ruajtjen e linjave të komunikacionit, si dhe mbështetjen e forcës në operacion, sipas prioritetëve të komandantit. Gjithashtu krijon kushtet për shndërrimin e udhëzuesit të nivelit strategjik në sukses të nivelit taktik, duke siguruar lidhje ndërmjet këtyre niveleve. Ajo përfshin lëvizjen në rajonet e detyrave të reparteve dhe personelit, zhvillimin e infrastrukturës, shpërndarjen dhe menaxhimin e rezervave, kontraktimet, shërbimet dhe kontrollin e lëvizjes.

Niveli taktik. Mbështet komandantët e nivelit taktik për realizimin e misionit nëpërmjet sigurimit të mbështetjes me forcat e mjetet organike. Në këtë nivel, funksionet kryesore janë furnizimi, transporti, mirëmbajtja, mbështetja mjekësore, administrimi dhe shërbimet jetësore në mbështetjen direkte të trupës për t'i krijuar mundësi asaj të realizojë misionin e ngarkuar. Një logjistikë e suksesshme taktike duhet të sigurojë mbështetjen në kohën dhe vendin e duhur të reparteve që i janë caktuar asaj.

Sfidat e shefit të ri të NATO-s, Mark Rutte

Kur Mark Rutte të zhvendoset në zyrën e tij në NATO, ai padyshim nuk do të ketë një periudhë muaji mjalti. Fushata e kryeministrit holandez në largim për të qenë Sekretar i Përgjithshëm përfundoi të enjten, kur ai siguroi mbështetjen e të 32 aleatëve të NATO-s (me Rumaninë, që njoftoi mbështetjen e saj). Presidenti aktual, Jens Stoltenberg, do të japë dorëheqjen deri më 1 tetor.

Rutte, i cili ka drejtuar ekonominë e pestë më të madhe të BE-së për 14 vjet, vlerësohet gjerësisht si një ndërtues efektiv i konsensusit, duke treguar gjithashtu vendosmëri në mbështetjen e Ukrainës, duke përfshirë përpjekjet e fundit holandeze në trajnimin e pilotëve ukrainas për të fluturuar me avionë luftarakë F-16. Por edhe për një politikan me përvojë, kapitulli tjetër i karrierës politike të Rutte nuk do të jetë një shëtitje në park.

Ja cilat janë pesë sfidat kryesore me të cilat ai do të duhet të përballet.

Rikthimi i mundshëm i Donald Trump

Katër javë pasi Rutte fillon punën e tij të re, amerikanët shkojnë në votime dhe mund të rizgjedhin Donald Trump, një skeptik ndaj NATO-s.

Gjatë fushatës, Trump ka kërcënuar se do të shkurtojë ndihmën e SHBA-së për Ukrainën nëse ai kthehet në Shtëpinë e Bardhë. Nëse ai vazhdon, kjo mund t'i japë një goditje të rëndë kredibilitetit të aleatëve të NATO-s për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet kundër Rusisë, duke pasur parasysh se SHBA-ja ka qenë deri tani donatori më i madh i ndihmës ushtarake për Kiev.

Rizgjedhja e Trump pothuajse me siguri do të prishë planin e NATO-s për të përgatitur Ukrainën për anëtarësimin e saj të ardhshëm, duke përfshirë përpjekjet për të përfunduar “perëndimorizimin” e ushtrisë fillimisht të stilit sovjetik të Ukrainës. Vendet e NATO-s vitin e kaluar premtuan se “do të jenë në gjendje t'i bëjnë një ftesë Ukrainës për t'u bashkuar me aleancën kur aleatët të bien dakord dhe të plotësohen kushtet”.

Megjithatë, duke gjykuar karakterizimin e fundit të Trump për presidentin e Ukrainës Volodymyr Zelenskyy, ky angazhim duket i lëkundshëm.

Sulmi dimëror i Putinit në Ukrainë

Sapo Rutte të hyjë në detyrë, Ukraina do ta thërrasë atë për ndihmë me afrimin e dimrit.

Gjatë muajve të fundit, Rusia ka shtuar sulmet kundër termocentraleve



Çelësi, thotë shefi në largim i NATO-s, Stoltenberg, qëndron në më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore që mund të mbrojnë furnizuesit e energjisë, si dhe stafin e mirëmbajtjes që punon për riparimin e objekteve të dëmtuara.

dhe digave të Ukrainës, infrastrukturë që kërkon muaj, nëse jo vite, për t'u riparuar plotësisht.

Libri i lojërave të Kremlinit nuk është i ri. Gjatë dimrit të parë të kohës së luftës, midis 2022 dhe 2023, rrjeti elektrik i Ukrainës u sulmua rëndë.

Çelësi, thotë shefi në largim i NATO-s, Stoltenberg, qëndron në më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore që mund të mbrojnë furnizuesit e energjisë, si dhe stafin e mirëmbajtjes që punon për riparimin e objekteve të dëmtuara.

Vendet e NATO-s po luftojnë gjithashtu për të dërguar – ose, në rastin e vendit të Rutte, për të ndërtuar – sisteme të mbrojtjes ajrore.

Por Evropa nuk ka aq shumë për të dërguar, përparimi në SHBA u vonua në Kongres dhe vendet afër Rusisë janë më pak se të gatshme të heqin dorë nga mburojat e tyre ajrore në këtë kohë të rrezikshme.

Detyrimi i anëtarëve të NATO-s për të paguar

NATO-ja këtë javë festoi një numër rekord të aleatëve që arritën objektivin prej 2 për qind të PBB-së për shpenzimet e mbrojtjes. Në të vërtetë, Holanda sapo e kaloi atë prag këtë vit pas disa vitesh dështimi, por një e treta e aleancës ende nuk po arrin në shenjë.



Rajoni ka qenë një avokat i fortë për një qasje më të ashpër ndaj Rusisë. Megjithatë, më afër terrenit të Trump, gjërat janë po aq të këqija. Kanadaja, një anëtare e NATO-s që në fillim në vitin 1949, po angazhon vetëm 1.37 për qind të PBB-së, duke regjistruar 0.1 për qind rritje që nga fillimi i luftës së Rusisë kundër Ukrainës.

Ankesat e krahut lindor

Vendet në kufi me Rusinë nuk janë tifozët më të mëdhenj të Rutte. Ata ishin të zemëruar për shpenzimet e ulëta të mbrojtjes holandeze dhe janë veçanërisht të mërzitur që roli kryesor në NATO i ka shkuar gjithmonë një vendi evropian perëndimor ose verior, edhe pse vendet e krahut lindor kanë qenë në aleancë për një çerek shekulli.

Kryeministrja e Estonisë Kaja Kallas nuk hyri në garën për postin e lartë të NATO-s pasi iu komunikua se nuk do të mernte mbështetjen e vendeve të tilla si SHBA-të, Franca dhe Gjermania (ajo tani është kandidatja kryesore për të qenë shefja e ardhshme e politikës së jashtme të BE-së). Ata kishin frikë se emërimi i saj do të shihej nga Moska si një përshkallëzim i armiqësive.

Presidenti i Rumanisë Klaus Iohannis, i cili kandidoi për këtë detyrë, mori vetëm mbështetjen e Hungarisë, vetëm për arsye taktike, për ta mbështetur atë.

Vendet e krahut lindor tani ka të ngjarë të kërkojnë përfaqësim më të mirë në nivelin dytësor të NATO-s: zëvendëssekretarin e

përgjithshëm (DSG) dhe postet e ndryshme të ndihmës sekretarit të përgjithshëm (ASG).

Shpërndarja e vendeve të punës ka qenë një pikë e dhimbshme për vendet lindore për disa kohë. Ndërsa DSG që po largohet është rumun, të shtatë ASG-të janë nga Perëndimi dy nga SHBA, nga një nga Gjermania, Holanda, Britania, Italia dhe Franca. Një tjetër vend pune në ASG është vakant.

Në të vërtetë, një nga detyrat e para të Rutte si shef i NATO-s do të ishte të emëronte një zëvendës.

Nuk është vetëm Trump që Rutte duhet të bindë për ta mbajtur NATO-n gjallë dhe mirë. Në të gjithë Evropën, partitë e së djathtës ekstreme skeptike ndaj NATO-s dhe Putin-dashëse po lulëzojnë.

Franca, për shembull, është në prag të zgjedhjeve parlamentare që mund të shohë fitime të mëdha për Tubimin Kombëtar të ekstremit të djathtë, duke e detyruar Stoltenberg të bëjë një lutje të rrallë për Francën që "ta mbajë NATO-n të fortë".

Rutte, natyrisht, e di shumë mirë këtë histori. Në një farë mënyre, ai filloi të konsideronte detyrën kryesore të NATO-s, kur u bë e qartë se Partia e tij Popullore për Liri dhe Demokraci e qendrës së djathtë do të humbiste zgjedhjet holandeze ndaj Partisë së ekstremit të djathtë për Lirinë e Geert Wilders, gjë që ndodhi.



Kodikët e shenjtë të Beratit

Në fund të vitit 1943, një togë ushtarësh gjermanë u ngjitën në Kalanë e Beratit me qëllim përmbushjen e një misioni special. Të drejtuar nga një oficer që duket ishte edhe bizantinolog, ata kishin urdhër të gjenin dhe merrnin me vete disa libra të vjetër që i përkisnin kishës.

Të dhënat i kishin tepër të sakta. Thoshin me gojën e tyre se librat ishin shkruar me dorë në pergamenë me ngjyrë të purpurt dhe se datonin përmbi 1000 vite.

Për të shtënë në duar librat e rrallë, ushtarakët nazistë kishin dorë të lirë të kryenin edhe raprezalje, madje të shkonin në plumb të gjithë ata që do t'i pengonin në qëllimin e tyre, qofshin edhe njerëz në shërbim të Zotit.

Në fakt nazistët e dinin mirë se çfarë kërkonin në Kishat e kalasë së Beratit. Ajo që nuk dinin ishte se klerikët ortodoksë dhe banorët e lagjes Kala nuk përballeshin për herë të parë me një rrezik të tillë. Librat e vjetër, apo librat e shenjtë të Kishës, kishin qenë historikisht në shënjestër të ushtrive të huaja pushtuese.

Por çfarë ishin këta libra? Çfarë përfaqësonin për Kishën dhe shqiptarët?

I pari dhe më i rëndësishmi është i quajtur Kodeks Beratinus

1 – ose Kodiku i purpurt i Beratit, një ungjill prej 190 faqesh të shkruara me dorë mbi pergamenë, që përmban shumicën e teksteve sipas Shën Markut dhe Shën Mateut.

Libri daton në mesin e shekullit të gjashtë pas Krishtit dhe përfaqëson një nga tre apo katër ekzemplarët më të vjetër të Dhiatës së Re, duke qenë edhe një pikë e rëndësishme referimi për zhvillimin e letërsisë biblike dhe liturgjike në të gjithë botën. Libri tjetër, Kodeks Beratinus 2, ose Kodiku i Artë i Beratit, është më i ruajtur. Daton në shekullin e nëntë pas Krishtit, përbëhet nga 420 faqe dhe i përmban të plotë të katër ungjijtë. Edhe ky kodik është prej pergamenë, por ka një veçanti: është i shkruar, nga fillimi në fund, vetëm me shkronja ari.

Historia thotë se gjatë Mesjetës, edhe pse nuk ishte një fakt të cilit i ishte bërë publicitet që të tejkalonte kufijtë e zonave të populluara me shqiptarë, kodikët e Beratit janë vënë në shënjestër të pothuaj të gjitha ushtrive të huaja pushtuese. Francezët, italianët, serbët osmanët e kështu me radhë, që të gjithë do të kërkonin të merrnin kodikët e Beratit, pavarësisht koston, pavarësisht masakrave në radhët e popullsisë së këtij qyteti.

Dy kodikët e purpurt të Beratit do të bëheshin të njohur përtëj trevave shqiptare vetëm në pjesën e dytë të shekullit të 19, kur një Mitropolit i Beratit, i quajtur Anthim Aleksudhi dhe më pas një studiues belg, Pjer Batifol (Pierre Batiffol), do të publikonin studime të mirëfillta shkencore për dy kodikët.

Pikërisht këto studime do të bënin që interesi dhe gjahu ndaj kodikëve të shtohet. Gjatë Luftës së Parë Botërore klerikët ortodoksë dhe populli i Beratit arrijnë t'i ruajnë ata nga ushtria austriake, ndërkohë që ruajtja e kodikëve gjatë Luftës së Dytë, nga grabitja e ushtrisë nazi-gjermane, është e mirë dokumentuar. Kodikët murosën në dyshtet e një prej kishave të shumta të Kalasë së Beratit dhe kështu vijuan të mbeten në pronësi të shqiptarëve.

Ata dalin në dritë vetëm në vitin 1968, kur i gjallë kishte mbetur vetëm njëri nga priftërinjtë që ruante sekretin.

Përkundër një fushate të egër që kishte ndërmarrë regjimi komunist i Enver Hoxhës për shkatërrimin e objekteve fetare pas ndalimit të fesë më 1967-ën, si duket autoritetet shqiptare të kohës kishin kursyer kodikët e vjetër.

Sot, në Arkivin Qendror Shtetëror, përkatësisht në Fondin 488, ruhen 128 kodikë dhe fragmente. Ndër ta më të rëndësishmit


vitit 533, në kohën e Perandorit Justinian, i shkruar në pergamenë, e cila është një pergamenë luksoze pasi është ngjyer me ngjyrën e kuqe perandorake ose e purpurta perandorake. Një traditë që na vjen nga Roma, ku Perandori vetëm mund të vishej me të purpurta, kurse në Bizant Perandori i vetëm ishte ai, i cili mund të përdorte ngjyrën e kuqe në dokumente apo në libra.

Cila është veçantia e tij, që e dallon nga veprat e tjera të kësaj natyre?

Libri është prodhuar me shpenzimet e Perandorit dhe me kërkesë të Perandorit. Përmban tekstin e ungjillit të Mateut dhe të Markut, i shkruar i gjithë teksti me germa të argjendta kapitale "majuske" në dy kolona nga 17 rreshta për kolonë dhe i gjithë libri ka 190 fletë. Themi libër, mund të thuhet edhe kodik, nuk ka të bëjë, ose dorëshkrim është e njëjta fjalë.

Kur u restauruan?

Duke qenë se në vendin tonë kjo gjë nuk mund të bëhej, këto dorëshkrime u dërguan për restaurim në vitin 1971, në Republikën Popullore të Kinës dhe janë kthyer në Janar të vitit 1972, në Tiranë dhe që prej asaj kohe qëndrojnë në Arkivin Qendror të Shtetit dhe kanë lëvizur vetëm në raste ekspozitash brenda apo jashtë vendit.



janë dy kodikët e Beratit, Codex Purpureus Beratinus dhe Codex Aureus Anthimi.

Më i vjetri nga këta dy kodikë është Codex Purpureus Beratinus apo siç quhet ndryshe Kodiku i Parë i Purpurt i Beratit, i cili i takon shek. VI, kurse i Dytë i takon shek. IX. Rrugëtimi i Kodikëve të Beratit nis nga prodhimi pranë Konstandinopojës në periudhën e Perandorit Justinian, vijon në Berat me përpjekjen e beratasve për ta shpëtuar nga plaçkitja pushtuesve serbë në vitin 1356 e deri në luftën e Dytë Botërore.

Kodikë i Parë i Purpurt i Beratit?

Është një dorëshkrim i punuar në shek. VI pas Krishtit, diku pas

Kapakët prej druri, veshur me argjend të larë në ar, punuar me gdhendje dhe incizim, i janë vendosur pas një restaurimi të shek. XVIII. Janë përfunduar më 30 mars 1729 nga dora e Anastas Haxhifilipidhit në Voskopojë.

Ndërkaq, Kodiku nr.23, hirmolog (muzikë bizantine) është dorëshkrim në letër i vitit 1292, në 159 fletë, dekorat e të cilat janë punuar me bojëra uji. Është shkruar nga Mihail Slavopuli prej fshatit Krasnik.

Kopje digjitale të Kodikëve të Beratit u publikuan në Librarinë Digjitale Botërore të Librarisë së Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shërbimi i Shëndetësisë, pararoja e shërbimeve elitare të ushtrisë shqiptare



DR. ASLLAN ZEMANI

Në kohën kur Shqipëria ishte pjesë përbërëse, e pushtuara, e Perandorisë Osmane, kohë kur shqiptarët nuk kishin shtetin e për pasojë as Forcat e tyre të Armatosura, nuk mund të bëhej fjalë as për shërbim shëndetësor e spitalor ushtarak të mëvetësuar. Megjithatë në hapësirën mbarë shqiptare ishin bërë të njohur emrat e disa mjekëve ushtarakë, që shërbenin në forcat e armatosura osmane, për arsyt e mësipërme. Midis tyre ishte i përmendur doktor Ibrahim Temo nga Struga etj., që nuk mundën të shërbenin në ushtrinë shqiptare, e cila u formua vetëm pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në nëntor 1912.

Shërbimi Shëndetësor është një dukuri e kahershme në skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare pas vitit 1912. Lidhur me këtë shërbim mjaft të domosdoshëm e jetik për këtë ushtri, në një nga dokumentet më të rëndësishëm, të hartuar e miratuar qysh në prill 1913, me titull “Rregullore e Përkohëshme e Ministrisë së Luftës”, Vlorë, më 22 prill 1913, ku jepej përbërja e kësaj Ministrie dhe e Shtabit Madhor (Shtabi Madhnuer) të saj, midis të tjerëve përfshihej edhe “Shërbimi Shëndetësor”. Por natyrisht, kjo strukturë, ashtu si dhe disa të tjera, nuk pati kohë të përvijohet e të vihej në jetë tërësisht e plotësisht nga ana e Ministrisë së

Godina e parë e Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak, e ndërtuar më 26.09.1929, ka kushtuar 548.894.88 franga ari



Luftës e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, për vetë mënyrën dhe shpejtësinë me të cilat u zhvilluan ngjarjet.

Në vitet njëzet-tridhetë të shekullit XX, me organizimet dhe zhvillimet që pati Ushtria dhe, në tërësi Fuqitë (Forcat) e Armatosura Shqiptare, edhe ky shërbim erdhi duke u fuqizuar dhe përmirësuar cilësisht. Pikërisht në përbërje të këtij shërbimi tashmë shfaqet edhe një “institucion” me vlera të veçanta, siç është spitali ushtarak.

Njoftimet e para për ngritjen dhe ekzistencën e një spitali ushtarak i përkasin pikërisht këtyre viteve. Kështu e dhëna e parë, e deritashme, e dokumentuar, që bën fjalë dhe dëshmon për ekzistencën e një spitali ushtarak, na vjen nga gjysma e dytë e vitit 1924, është 17 qershori, kur në skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare të Qeverisë së F. S. Nolit, për herë të parë përmendet krijimi i një “...Spitali Ushtarak me qendër në Tiranë”. Kurse në vitin 1926, në organikën e përgjithshme të oficerëve të Ushtrisë, me 151 oficerë e aspirantë dhe 23 intendentë, bënin pjesë edhe 5 mjekë ushtarakë.

Por bazat e mirëfillta të mjekësisë ushtarake dhe të shërbimit spitalor ushtarak shqiptar, u hodhën më pas, në periudhën e viteve 1928-

1938, kur u ndërmorën disa reformime për riorganizimin dhe përmirësimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Plot katër vite më pas, më 24 qershor 1928 miratohet dhe hyn në fuqi “Ligji i parë organik i Ushtrisë dhe i Gjindarmërisë”, sipas të cilit, duhej të ngriheshin “...nga një spital ushtarak në Tiranë dhe në garnizone të mëdha”. Garnizonet e mëdha nënkuptonin qendrat e grupeve ushtarake, që përfaqësonin njësitë më të mëdha për Ushtrinë Shqiptare të asaj kohe, të barabarta me një regjiment. Me anën e këtij ligji organik përcaktohej edhe varësia e spitalit nga Komanda e Fuqive Armate, siç quhej në atë kohë. Pikërisht në qendrën e njërës prej këtyre grupeve, në Spitalin e Elbasanit shërbente mjeku ushtarak i njohur në atë kohë, major Petraq Popa, që kishte hyrë në Ushtrinë Shqiptare qysh më 30 prill 1921. Ky mjek i përkushtuar punoi e shërbeu në këtë spital, me një personel të kufizuar, që nga data 5 shkurt 1930.

Në të vërtetë “datëlindja” e Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak Shqiptar daton më 26 shtator 1929, kur në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, ai u ngrit dhe nisi veprimtarinë në një godinë të re dykatëshe, pranë rrugës së Dibrës, tek blloku i sotëm i Spitalit Civil “Nënë Tereza”. Këtë fakt e ndesh në shumë

dokumente dhe botime të kohës, madje edhe në fotografi. Ky spital ishte pronë shtetërore dhe për ndërtimin e tij qenë harxhuar 548.894.88 franga ari. Një gjë e tillë vërtetohet edhe përmes faqeve të “Ligjit për organizimin e Fuqive Armate”, të vitit 1929, sipas të cilit, tek kreu mbi “Fuqitë Tokësore”, pika “Instituta, Stabilimenta e Reparte të ndryshme” (Artikulli 23), bënë pjesë 4 spitale ushtarake, një prej të cilëve i “Përgjithshëm”, me qendër në Tiranë.

Ende pa kaluar dy vjet, në qershor 1931, pason një ligj për rregullimin e Ushtrisë Kombëtare, i cili konfirmonte gjithashtu, qenien e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak, në Tiranë. Dy ligje të tillë dolën njeri pas tjetrit edhe më 1934 e 1937 dhe në të dy, në përbërje të Forcave Tokësore të Ushtrisë Shqiptare afirmohej prania e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë. Ky spital bënte madje “shërbimin shëndetësi” nën drejtimin e një mjeku që ishte më i vjetri i garnizonit të kryeqytetit. Spitali varej drejtpërdrejt nga Komanda e Fuqive Armate. Ekzistenca dhe funksionimi i këtij spitali në shërbim të Ushtrisë Shqiptare është i lidhur pazgjidhshmërisht edhe me veprimtarinë e disa mjekëve ushtarakë, të njohur tashmë për botën mjekësore dhe krejt popullin shqiptar, që punuan me përkushtim në të. Një prej tyre, si përfaqësues ndër më të njohurit ka qenë edhe doktor Sinan Imami, i cili figuron në organikën e këtij spitali me gradën ‘toger’, qysh më 1933. Krahas tij shërbyen edhe të tjerë si kapiten i klasit të dytë, Dr. Selaudin Mborja (që prej vitit 1930); kapiten i klasit të dytë, Dr. Pavli Flloko, (që prej vitit 1933); kapiten i klasit të dytë, Dr. Shan Nush Gjoka (që prej vitit 1932); toger Avdul Nazmi Skënduli, (që prej vitit 1933); toger Spiro Prokop Prosi, (që prej 1933); toger Luigj Benusi, (që prej 1932); toger Kiço Karajani, (që nga 1934); nëntoger, toger Tare Quku, (që nga 1938); Dr. Shyqyri Basha, (që prej vitit 1938); nëntoger, Dr. Petraq Progri, (që prej vitit 1938); nëntoger, Dr. Bahri Kopliku (që prej vitit 1938) e të tjerë. Drejtor i parë i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak ka qenë nënkolonel Dr. Ismet Gega, patolog, që u pasua nga Dr. Selaudin Mborja. Fakti që në këtë spital shërbyen disa mjekë të shquar dhe shumë mjekë të tjerë e personel ndihmës, si dhe tema që lidhen me kapacitetin kurues, llojet e shërbimeve, me kualifikimet e personelit, me rregullat e trajtimit e të mjekimit, e të tjera, përbën pa diskutim një objekt me interes për studim



Përrumi i Spitalit Ushtarak të Elbasanit, më 05.02.1930, (i katërti majtas, major Dr. Petraq Popa)

të plotë nga historianë ushtarakë dhe pse jo, edhe nga specialistë të mjekësisë ushtarake shqiptare.

Kaq e vërtetë është ekzistenca e këtij spitali të përgjithshëm sa vet drejtori i tij në vitin 1945, tashmë koloneli Sinan Imami, kishte shërbyer si mjek pikërisht në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak të Tiranës, që nga 1 korriku 1933. Këtë gjë e vërteton më së miri “Lista e përshkallëzimit të oficerëve të përherëshëm”, që botohej nga Komanda e Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare pothuajse çdo vit deri më 1939.

Pas agresionit fashist kundër Shqipërisë dhe pas pushtimit të saj, më 7 prill 1939, fati i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak Shqiptar ndoqi atë të vet Ushtrisë Shqiptare. Ai u bashkua me strukturat e gjithë Forcave të Armatosura të të dy palëve. Gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare pranë Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare u ngritën e funksionuan disa “spitale partizane”, që kishin një natyrë organizimi dhe veprimi të veçantë, që është e shpjegueshme për kushtet e luftës partizane dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Vullnetare Shqiptare. Kurse pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj fashistë e nazistë, më 2 shkurt 1945, u ngrit në Tiranë, Spitali i Përgjithshëm (sot Qendror) i Ushtrisë me drejtues (drejtor) të parë ishte pikërisht një nga mjekët e ish-Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak të viteve njëzet-tridhjetë të shek. XX. Ky ishte mjeku ushtarak, koloneli Sinan Imami, që tani vinte nga radhët e mjekëve të Ushtrisë NÇ Shqiptare dhe qëndroi si drejtues i këtij

institucioni deri në shtator 1973. Më pas, mjekë të shquar kanë qenë drejtues si Dr. Veli Toto, (1973-1989); Dr. Perlat Hodo, (1989-1991); nënkolonel Dr. Ilir Kajo; nënkolonel Dr. Mihal Kërçi; koloneli Dr. Esat Duraku; koloneli Dr. Engjëll Mastori; nënkolonel Dr. Hajri Gërbi; koloneli Dr. Luan Nikollari.

Pas vitit 1945 e deri në ditët tona shërbimi spitalor ushtarak shqiptar, natyrisht ka njohur përmasa dhe nivele të reja zhvillimi, që përpiqeshin ta mbanin edhe këtë shërbim tepër të rëndësishëm për mbarëvajtjen e Forcave të Armatosura Shqiptare, në një hap me to. Kështu që mund të thuhet se vënia në punë e Spitalit Ushtarak, në atë ditë shkurti 1945, në të vërtetë, mund të quhet ringritje, në kushte të reja, e ish-Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak të viteve ‘20-’30 të shekullit të shkuar. Ky argument është më pranë të vërtetës historike ushtarake shqiptare.

Të përpiqesh të shkruash dhe të përkujtos me sa më tepër realizëm këto ngjarje, figura apo institucione për të ndriçuar dhe bërë të njohura ato, është veçse një mënyrë veprimi dhe gjest respekti për veprën e paraardhësve. Njëherësh ai përbën edhe një mesazh vlerësimi dhe njohjeje për ta dhe vet historinë ushtarake shqiptare, larg skemave shabllone dhe tabu, që i bëjnë të paragjyqueshme ato.

Madje, meritë do të ishte zbardhja dhe rindërtimi i plotë në pikëpamje historike i strukturave të tyre dhe përshkrimi e evidentimi i vlerave të personaliteteve të tyre drejtuese.

Veprimtaria e Shtabit të Përgjithshëm gjatë LANÇ-it



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Pavarësia e komandave partizane

Po mbushen 81 vjet nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm (SHP) të UNÇSH më 10 korrik të vitit 1943. Në vitet e demokracisë është shfaqur një dukuri që vihet re, edhe pse në raste të veçanta po synon të shmangë apo të zvogëlojë vlerat dhe rolin drejtues të SHP-së në organizimin dhe drejtimin e formacioneve partizane gjatë LANÇ-it. Dihet se në luftën partizane komandat e formacioneve ushtarake në veprimtarinë e tyre kanë pavarësi më të madhe, se ato që veprojnë në front të rregullt. Kjo për arsye se njësitë partizane përhapen në hapësira të mëdha, të shkëputura nga njëra-tjetra, shpesh me mjete ndërlidhje më të prapambetura në pikëpamje të teknikës së formacionet e frontit të rregullt, të cilat kanë komunikim të rregullt me njëra-tjetrën e me komandën eprorë. Ky fenomen vihet re sidomos deri nga mesi i shek. XX. Por, kjo në asnjë mënyrë nuk shmang rolin organizues e drejtues të shtabeve të tyre eprorë, e në rastin konkret të SHP-së të UNÇSH-së, në lidhje me komandimin e formacioneve partizane. Gjatë fazës së parë të formacioneve partizane, çeta e batalione, krijoheshin e vepronin brenda një qarku të caktuar dhe veprimtaria e tyre luftarake drejtohej nga Komiteti i Partisë i qarkut. Pati edhe raste kur 2-3 qarqe bashkëvepronin për plotësimin e një detyre të rëndësishme luftarake. Në kushtet e rritjes së formacioneve partizane dhe të përmasave të luftës, në verën e vitit 1943, krijimi i SHP bëhet një detyrë urgjente.

Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm

SHP u zgjodh nga Këshilli i Frontit Nacionalçlirimtar. Rëndësi të veçantë merrte përzgjedhja e anëtarëve të këtij shtabi. Njëri grup përbëhej nga ushtarakë të shkolluar e të karrierës. Anëtarë të tij ishin Spiro Moisiu, Abaz Kupi, Bedri Spahiu, Dali Ndreu. Këshilli i Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar zgjodhi nga ky grup, komandant të shtabit Spiro Moisiun, me gradën e majorit dhe funksionin e komandantit të batalionit në ushtrinë mbretërore. Ai vinte në këtë detyrë me përvojën e një karriere të gjatë, ku spikasin jo vetëm aftësitë e profesionalizmit ushtarak, por edhe dinjiteti e atdhedashuria. Intellektualët përfaqësoheshin nga Sejfulla Malëshova, Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi e Ramadan Çitaku. Enver Hoxha, që ishte sekretar i parë i PKSH-së, zgjidhet në funksionin e komisarit politik të SHP-së. Pastaj vinte treshja simpatike e prijësve popullorë: Haxhi Lleshi, Myslim Peza



e Mustafa Xhani. Me autoritetin e respektin që gëzonin në popull, i shndërronin krahinat e tyre Dibrën, Pezën e Martaneshin në baza të fuqishme të luftës së armatosur. Anëtarët e SHP-së formojnë një galeri portretesh, ku secili me veçoritë e veta, me tipare të ndryshme, dalloheshin në tërësi për aktivitet të pasur patriotik e mbartnin një varg kualitetesh në shumë pikëpamje.

Shtab drejtues në rang kombëtar

Krijimin e SHP-së e kushtëzonte, por edhe e favorizonte, si faktori i brendshëm, edhe faktori i jashtëm. Zgjerimi dhe zhvillimi i vrullshëm i luftës së armatosur, si dhe rritja e mundësive të formacioneve partizane për të kryer operacione të rëndësishme, kërkonte nga SHP, të plotësonte disa detyra, si dhe të parashikonte perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm të luftës. Në planin e jashtëm tërheqin vëmendjen fitoret e mëdha të arritura nga Ushtria Sovjetike në betejën e Stalingradit dhe nga forcat anglo-amerikane në Afrikën e Veriut dhe në Sicili. Në këto rrethana LANÇ-i, si pjesë përbërëse e luftës antifashiste botërore, mundi të bashkërendohej me luftën e popujve pjesëtarë të koalicionit botëror vetëm me pasjen e një shtabi drejtues në shkallë kombëtare. Detyrat e SHP-së ishin shumë-planëshe. Detyra e parë themelore e tij ishte organizimi i UNÇSH-së. Për këtë qëllim u përcaktuan disa parime themelore.

Rëndësi iu kushtua parimit të vullnetarizmit. Në kushtet e rritjes së ndërgjegjes kombëtare e të gatishmërisë së masave popullore për të luftuar pushtuesit, zbatimi i këtij parimi kishte baza të shëndosha, çka u shpreh në rreshtimin vullnetar në formacionet partizane të qindra e mijëra luftëtarëve.

Formacioni i brigadës sulmuese

Në kushtet e luftës partizane, të traditave luftarake të popullit tonë, e të karakterit malor të terrenit, SHP i kushtoi vëmendje ndërtimit të formacioneve të UNÇSH-së, zbatimit të parimit të autonomisë e lehtësisë në lëvizje. Kërkesat e këtij parimi i plotësonte formacioni i brigadës sulmuese. Brigada ishte njësi luftarake operative në dorë të SHP-së, e destinuar për të manovruar në varësi nga situata, e për të plotësuar detyrat luftarake në të gjithë vendin. E përbërë kryesisht prej forcash këmbësorie dhe një sasi të kufizuar artilerie të transportueshme me krahë e me kafshë, brigada kishte lëvizshmëri të lartë dhe i përshtatej terrenit malor. Njëherazi, ajo zotëronte forcë goditëse e mëvetësi veprimi.

SHP tregoi kujdes të veçantë për të gjitha problemet që lidheshin me krijimin e organizimin e brigadave. Anëtarët e SHP kryen drejtpërdrejt një veprimtari intensive për kapërcimin e vështirësive që lidheshin me krijimin e tyre. Kjo bëri të mundur që gjatë një periudhe tetë muajore, gusht 1943 - mars 1944, të krijoheshin shtatë brigada sulmuese të komanduara nga Mehmet Shehu, Beqir Balluku, Hulusi Spahiu, Nexhip Vinçani, Shefqet Peçi, Tahir Kadare e Gjin Marku, thuajse të gjithë me shkollim ushtarak e me përvojën e pasur luftarake të fituar në betejat e luftës partizane. Procesi vijoi më tej me krijimin gjatë tetë muajve të tjerë, prill - nëntor 1944, të 17 brigadave të reja, gjithsej 24 të tilla. Mbi bazën e këtyre brigadave u krijuan në fazën e tretë të luftës, maj-nëntor 1944, divizionet dhe korparmata, çka çoi në organizimin e plotë të UNÇSH-së. Nuk ishte e thjeshtë të krijoje e organizoje një brigadë sulmuese. Nuk përfundonte me caktimin e datës, vendit të grumbullimit dhe organizimin e përzemërimit të saj. SHP në bashkëveprim edhe me komandat e formacioneve partizane, në ecurinë e krijimit të brigadave, duhej të zgjidhte një varg detyrash. Duhej të sigurohej kompletimi i brigadës me efektiv, të zgjidhej problemi i kuadrit, sigurimi i armatimit e municioneve, një numër pajisjesh, të merreshin masat e nevojshme për stërvitjen, për përgatitjen fizike dhe edukimin e luftëtarëve.

Përpunimi i taktikës së luftimit

Një detyrë tjetër e rëndësishme e SHP-së, ishte përpunimi i taktikës së luftimit, me ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e veprimtarisë luftarake të formacioneve partizane. Para krijimit të SHP-së, ekzistonte një bazë e mirë e taktikës së luftës partizane. Taktika e luftës u përpunua e u zbatua në zjarrin e betejave me pjesëmarrjen aktive të luftëtarëve të thjeshtë e të kuadrove, të të gjitha rangjeve. Por, pa dyshim, një meritë të veçantë, ka SHP, i cili diti të nxjerrë nga përvoja elementët më pozitivë të taktikës së luftës, t'i përpunojë në rrjedhën e saj në një kod taktik tepër efektiv, e nëpërmjet udhëzimeve, t'i përgjithësojë e t'i përhapë në radhët e formacioneve të UNÇSH-së. Me organizimin e UNÇSH-së, SHP, jo vetëm përsosi më tej taktikën e luftës partizane të formacioneve të vogla, por përpunoi edhe metodat e përdorimit të grupeve partizane dhe të brigadave sulmuese, çka mundësoi plotësimin e detyrave më të rëndësishme, goditjen e garnizoneve të mëdha të armikut, ndeshjen me formacionet e tij, luftimin për pushtimin e rajoneve të fortifikuara, për mësymjen në qytet etj.

Duke ndjekur ecurinë e veprimtarisë luftarake me trupat gjermane, SHP vuri re aftësitë e këtyre trupave për të përdorur taktikën e luftës kundërpartzane dhe epërsitë që siguruan ata në operacionet e para. SHP reagoi me shpejtësi ndaj këtyre epërsive

të artit ushtarak gjerman, evidentoi mangësitë e shfaqura nga disa formacione partizane dhe përcaktoi rrugët për t'iu kundërvënë. Analiza e këtyre mangësive dhe kritika e të metave, ndihmonte të nxirreshin mësim nga të gjitha formacionet partizane. Krahas kritikës së mangësive, SHP bëri përgjithësime me vlera të mëdha për të përsosur më tej taktikën partizane, duke u mbështetur në përvojën që kishin fituar repartet e UNÇSH-së. Për të gjitha këto tipare pozitive të taktikës partizane, SHP jepte udhëzime që të rrënjoseshin fort në praktikën e organizimit e të drejtimit dhe në veprimtarinë luftarake të çdo komande e reparti partizan. Tërësia e urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna nga SHP, për taktikën e luftës partizane dhe zbatimi i tyre me krijimtari në fushën e betejës nga formacionet e UNÇSH-së, pati ndikim të fuqishëm në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë luftarake. U rritën ndjeshëm përmasat e veprimeve luftarake në kohë e në hapësirë. Luftimet e inkuadruara në një ide të vetme shpesh synojnë t'i shkaktojnë armikut humbje të ndjeshme e të arrijnë çlirimin e zonave e të krahinave të tëra.

Çlirimi i krahinave dhe sidomos lufta për çlirimin e qyteteve, shtroi çështjen e taktikës së luftës ballore, një formë lufte thuajse e panjohur për formacionet partizane. Përballë kësaj gjendje, SHP u tregua tepër i kujdesshëm. Në varësi nga situata dhe objekti i sulmit, SHP vlerësonte si më të përshtatshëm ndërthurjen e dy taktikave. Në operacionet mësymëse për çlirimin e krahinave malore, SHP porosiste komandat e reparteve se edhe pse po përdorreshin gjerësisht metodat e luftës partizane, duhet t'i kushtoni kujdes edhe përvetësimit të elementeve të taktikës ballore. Tipare më të qarta taktika e luftës ballore merre në veprimet luftarake për çlirimin e qyteteve. Mbështetur në detyrat e shtruar nga SHP për tu hedhur në mësymje për çlirimin e tyre, komandat e njësive përpunuan, përgatitën e stërvitën trupat për luftime në qytet, duke i kushtuar kujdes taktikës së luftës ballore. Goditjet koncentrike, mësymja në ballë të gjerë, ngushtimi shkallë-shkallë i unazës së rrethimit, luftimet vendimtare në brendësi të qytetit etj., sipas porosive të SHP-së u bënë veçori dalluese të veprimeve luftarake. Gjatë luftës për çlirimin e Tiranës, taktika e luftës ballore arriti shkallën më të lartë të saj. Kjo luftë u bazua në planin e hartuar nga komanda dhe SHP, i zbatuar me përpikëri nga komandat e të gjitha rangjeve. Efektivat e UNÇSH-së në një luftë dhëmb për dhëmb me armikun për 19 ditë rresht, manifestuan jo vetëm heroizëm e moral të lartë, por edhe aftësi e mjeshtëri në luftime të afërta, në veprimet luftarake për pushtimin dhe mbajtjen e ndërtesave, të kryqëzimeve e të rrugëve, të objekteve të fortifikuara etj.

Drejtim në formë direktive

Detyrë tjetër tepër e rëndësishme e SHP-së ishte drejtimi i drejtpërdrejtë i veprimtarisë luftarake të njësive të UNÇSH-së. Natyra e luftës partizane është e tillë që kërkon nga komandantët e formacioneve të UNÇSH-së të kenë më tepër pavarësi njësitë që veprojnë në front të rregullt. Për rrjedhojë, edhe urdhrat luftarake SHP nuk i jepte të prerë, por në formë direktive, komandantët e reparteve e të njësive udhëzoheshin të zgjidhnin vetë objektivat që do të godisnin, duke vepruar me shpirt krijues e duke gjetur rrugë e forma sa më efektive për zbatimin e detyrës së dhënë. Pavarësia që u lejohej komandave të formacioneve partizane ishte relative. Në urdhrin e veprimt, atyre u përcaktohej rajoni ku do të vendoseshin e objektivat e armikut në atë rajon, si dhe rrugët e komunikacionit që do të mbanin në kontroll. Segmentin e rrugës ku do të organizonin pritën apo goditjen, forcat që do të përdornin dhe kohën e zënies së pritës, i përcaktonin vetë komandat. SHP u jepte gjithashtu komandave të njësive edhe urdhrin e zhvendosjes në një rajon tjetër në vartësi nga perspektiva e zhvillimit të situatës.



Kontributi humanitar i trupave xheniere, vlerë e shtuar e FA-së

1 korrik 1968, krijohet Brigada Xheniero-Ndërtuese, edhe pse kontributi i saj është më i hershëm, ajo daton me 20 janarin e vitit 1921, ku me vendim të qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, u krijua kompania e parë xheniere në përbërje të Divizionit të parë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Aktualisht, struktura e trupave xheniere është një batalion xhenier, në përbërje të Komandës Mbështetëse. Më datën 24. 6. 1928, për herë të parë u krijua Komanda e Trupave Xheniere. Në vitin 1929 numëroheshin gjithsej 10 nënrepartet xhenierë. Gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, nga njësitë partizane u përdorën shumë elementë të sigurimit xhenier e të luftës me mina, edhe pse strukturat xheniere të paraluftës ishin shpërberë.

Më 10 prill të vitit 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ-së, urdhëroi ngritjen e skuadrave të para minatore, të cilat i dhanë një efikasitet të madh veprimeve luftarake të njëjësive, duke hedhur kështu bazat e ngritjes së strukturave xheniere pas çlirimit të vendit. Në korrik të vitit 1945, u krijuan nënrepartet xheniere në divizione dhe njësi e parë xheniere, e cila u vendos në Elbasan. Në vitet më vonë, repartet e njësitë xheniere u rritën e u modernizuan, duke krijuar njësi të reja si Brigada e Urave në Kavajë, Brigada e Xhenios në Tiranë, si dhe tre Regjimente Xhenierë, që merreshin kryesisht me ndërtimin e objekteve mbrojtës me përmasa të mëdha, si bazat detare Porto Palermo e Shëngjin, baza ajrore Gjadër, objektet në Poliçan, Mjekës, Gramsh etj. Aktualisht, struktura e trupave xheniere është një batalion xhenier, në përbërje të Komandës Mbështetëse, me këtë strukturë: komanda e shtabi, toga e ruajtjes, toga mbështetëse, kompania e ndërtimeve, nënreparti

EOD-i, toga e urave.

Kontributi humanitar i trupave xheniere

Ai filloi menjëherë pas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë me çminimin e bregdetit të minuar nga pushtuesit nazistë në ikje, nga Currilat deri te Karpeni i Kavajës, me një gjatësi rreth 20 kilometra. Minime ishin kryer gjithashtu në portin e Shëngjinit, në Portin e Vlorës, në Gjirin e Semanit, të Sarandës, dhe në shumë qafa malesh e lugina. Jeta ishte e rrezikuar dhe vdekja trokiste kudo ku shkelte këmba e njerëzve të pafajshëm, që donin të ndërtonin jetën e tyre pas një lufte shkatërrimtare. Kishte ura e rrugë të shkatërruara, banesa dhe godina të rrafshuara. Në këto kushte të vështira xhenierët e batalionit të parë minator çminuan rreth 200 mijë mina kt e kk, së bashku me R1Xh të krijuar në Elbasan.

Repartet xheniere ishin të pranishëm pas luftës në rindërtimin e urës së Kuçit, mbi lumin Osum, të urës së Semanit, të urës së Vjosës, urës së Matit, të Dragotit dhe Leklit në Tepelenë e shumë ura të tjera. U ndërtuan me dhjetëra ura mekanike "Bejli" të ardhura ndihmë nga UNRRA, si shpërblim për luftën e bërë ndaj nazifashistëve dhe si vend i dëmtuar shumë në Luftën e Dytë Botërore. Dhe vazhdoi pastaj pa pushuar asnjëherë me ndërtimin e rrugës Kukës-Peshkopi, Gramsh-Lozhan, Çorovodë- Frashër, dhe më vonë në rrugën e Malësisë së Madhe. Xhenierët kanë qenë të pranishëm në tharjen e kënetave, në ndërtimin e kanaleve të mëdhenj bonifikues, në ndërtimin e pritave dhe argjinaturave, të hidrovorëve dhe ujësjellësve, kudo ku kishte nevojë vendi.

Trupat xheniere nuk pushuan kurrë së vepruari në ndihmë të

komunitetit për kapërcimin e fatkeqësive natyrore, në raste përmbytje, zhbllokimin e rrugëve nga dëbora, eliminimin e pasojave të tërmeteve të rënë në Dibër, Tepelenë, Sarandë, e veçanërisht në Shkodër e Lezhë, ku dëmet ishin katastrofike, kontributin e dhënë nga xhenerët për fikjen e pusit të naftës e të gazit në Marinëz, në vitin 1974 etj. Pas viteve '90, në kushtet e ndryshimeve të mëdha demokratike në vend dhe në rajon, trupat xheniere, hoqën dorë nga punimet fortifikuese dhe u hodhën me vull në punime kryesisht në ndihmë të komunitetit si ndërtimi i një segmenti rrugor në Unazën e madhe të Tiranës, ndërtimi i fshatin Bulçesh, Kamëz, ndërtimi i ujësjellësit në Shupenzë etj.

Një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës në rrugët kryesore të vendit dhe me volum të madh punimesh janë: zgjerimi i rrugës kombëtare Llogara-Palasë në vitin 2000 (rreth 12 km), zgjerimi i rrugës kombëtare Bogovë-Çorovodë në vitin 2001 (19.5 km), ndërtimi i rrugës kombëtare Qafe Mejdani – Qafë Morinë në vitin 2002 (rreth 7.7 km), ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen, pjesë e Aksit Durrës-Kukës-Morinë në vitin 2003-2005 (10.5 km), zgjerimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Kthesa e Dajtit-Qafë Mollë në vitin 2005 (5.5 km), në interes të projektit të shkatërrimit të lëndëve kimike etj. Pjesëmarrja në emergjencat

civile ka qenë një tjetër medalje e shkëlqyer e trupave xheniere, krahas strukturave të tjera të FA-së, si zhbllokimi i rrugëve nga dëbora gjatë dimrit (dimri 2011-2012), eliminimi i pasojave nga përmbytjet, veçanërisht ajo e Shkodrës dhe Lezhës, ndërtimi e përmirësimi i shumë rrugëve në zonat rurale të vendit etj.

Ndër punimet më kryesore përmendim: Gërmim shkëmbi dhe dhera të ndryshëm rreth 21638 m³, ngarkim e transport dherash e zhavorri 5862 m³, përhapje e nivelim dherash e zhavorri 15265 m², rulum shtresë zhavorri 6590 m², prishje strukturë betoni 103.5 m³, punime betoni M-200, 64,2 m³, punime suvatimi 412 m², ndërtim muri 15,9 m³, punime bojatisje 3682.5 m², ngarkim e shkarkim materialeve të rëndë me vinç, 91 orë pune, ndriçim natën me agregat ndriçimi 25 orë pune, shtresë asfalto-betoni 1610 m² etj. Punimet e kryera nga batalioni

xhenier janë të shumta e të shumëllojshme. Nuk ka zëra pune që forcat dhe mjetet e tij të mos kenë kryer. Kjo falë edhe strukturës efikase të këtij reparti, por edhe të kapaciteteve të konsiderueshme inxhiniero-teknike dhe specialistëve që disponon, organizimit dhe drejtimit me rendiment të punëve nga komandanti dhe shtabi i batalionit dhe të nënrepartëve të tij.

Në zbatim të VKM-së Nr. 931, data 09.10.2013, "Për krijimin e Task-Forcës për marrjen e masave të ndërhyrjes emergjente për mbrojtjen mjedisore dhe rehabilitimin e territorit", batalioni xhenier është angazhuar në 14 objekte për pastrimin e mbeturinave inerte të krijuara nga ndërtesat e prishura dhe sistemimin e ambienteve, si dhe në realizimin me sukses dhe pa aksidente të rrëzimit të ndërtesave, ku janë angazhuar 161 forca, 37 mjete dhe 8 agregate xhenierë. Në këto angazhime, xhenierët kanë demonstruar profesionalizëm, disiplinë të lartë dhe ndjenjë sakrificë. Nuk kanë munguar gjatë vitit 2014 edhe ndërtimi dhe riparimi i urave "Bailey", kaq të nevojshme nga komuniteti, veçanërisht ai rural, ku

nevojat janë të shumta. Janë ndërtuar ura mekanike "Bailey në 4 komuna, ku janë angazhuar 43 forca, 19 mjete të ndryshëm dhe 3 agregate, me një gjatësi të urave të ndërtuara 68 metra dhe ura të riparuar 15 metra.

Duhet të ndalemi të gjithë e të shohim qartë çfarë po ndodh. Mos të trembem, por të rrisim vigjilencën.

Mësuesi dhe prindi duhet të jenë në gjendje alarmi. Shkolla të reagojë shpejt, shoqëria ta qepë gojën, media të japë modele...

Bota në kohët e fundit ka filluar të tërhiqet më shumë nga aparencja dhe fizionomia e jashtme. Vlera e njeriut sot fillon me pamjen e tij të jashtme. Kjo është diçka normale, duke ditur që globalizmi që po shtrihet kudo është globalizëm i aparencës.

Shumë nga problemet familjare mes prindërve dhe fëmijëve, lindin për shkak të aparencës dhe pamjes së jashtme.

A mund të themi se shumica e të rinjve tanë i mbajnë sytë nga moda dhe se kjo ndodh për faktin e zbrazëtirës së brendshme?

A mund të konsiderohet kjo si një varfëri kulturore?

A është e vërtetë se në raste dobësie, njeriu i mban sytë nga këto dukuri?”

Disa të rinj veshin rroba femrash, duke dashur të përngjasojnë me to. Kur i pyet mbi këtë, të përgjigjen se është e modës. Nuk e di se si e konceptojnë modën të rinjtë e sotëm?!, u japim rastin që të gjejnë një arsye dhe justifikim për këtë. Ne sot kemi nevojë që t’u paraprijmë justifikimeve. Nëse ne e dimë se po i pyetëm, përgjigja dhe justifikimi i tyre do të jetë “Moda”.

Është më e favorshme që të fitojmë simpatinë e të riut, sesa ta korrigjojmë dhe qortojmë. Një rregull thotë: “Të fitosh simpatinë e dikujt është më e vlefshme se të fitosh debatin me të”. Duke fituar simpatinë e dikujt, unë kam fituar dhe debatin mbi një çështje të caktuar. Ne duhet ta kemi të qartë që adoleshentët e kanë në majë të gjuhës përgjigjen dhe tentativat për të depërtuar në brendësinë e tyre në mënyrë direkte, nuk do të japë asnjë rezultat.

Të rinjtë dhe raporti i tyre me realitetin e kushteve ekonomike-sociale nga vijnë

Ata kanë pak para, por shije të shtrenjta. Vlerësojnë rehatinë dhe ndërgjegjen sociale. Duan që blerjet të jenë të lehta dhe t’u përshtaten nevojave personale.

Dëshirojnë autenticitetin ndërsa janë të zhytur vazhdimisht në një botë dixhitale. Ndërsa të rinjtë po fillojnë të shpenzojnë me zell, markat po përpiqen të kuptojnë se çfarë duan ata dhe si blejnë. Përgjigjet do të përcaktojnë epokën e ardhshme të konsumit.

Shifrat totale janë të frikshme. Bashkimi European është shtëpia e gati 125 milionë njerëzve midis moshës 10 dhe 34 vjeç (më i riu do të bëhet konsumator në vitet e ardhshme). Amerika ka 110 milionë persona të brezave “Generation Z”

(10 deri në 26 vjeç), sa një e treta e popullsisë.

Zakonet e blerjeve të të rinjve, ashtu si jeta e tyre, përcaktohen nga “ekonomia e vëmendjes”, blerja e gjërave në internet është shumë më e shpejtë dhe më e lehtë sesa të shkosh në dyqan.

Falë përhapjes së mediave sociale, ka shumë mënyra të reja për të tërhequr syrin e konsumatorëve. Blerësit e rinj nuk kanë njohur kurrë një botë pa celularë smartphone. Pritshmëria për rritjen e komoditetit shoqërohet me rritjen e popullaritetit të bizneseve që gëzojnë reputacion me emrin e markës së tyre...

Të rinjtë duan që blerjet e tyre të jenë krejt të lehta

Videot e krijuara nga përdoruesit e “TikTok” mund të nxisin edhe markat e vogla drejt famës së shpejtë virale. Aplikacione të tilla po shtojnë gjithnjë e më shumë veçori që i lejojnë përdoruesit të blejnë pa u larguar fare nga platforma. Bota e re e blerjeve i ka lejuar gjithashtu të rinjtë të jenë më të informuar për kompanitë ku blejnë. Mbingarkesa e informacionit nuk i ka zbehur ndjenjat e të rinjve, por duket se i ka bërë ata tepër të ndjeshëm, veçanërisht ndaj çdo marke që pretendon se është diçka që nuk është.

Në një botë ku imazhi dhe prezantimi janë të rëndësishëm, markat e njohura janë të pranishme si simbole të statusit dhe suksesit

Përplasja midis rritjes së kostos dhe dëshirës për marka të njohura sjell me vete edhe sfida të tjera. Ka një aspekt financiar, pasi për një numër të madh njerëzish, blerja e produkteve të markave të njohura mund të jetë një shpenzim që zë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit, duke sjellë sfida të vërteta për mbijetesën. Por sa merret kjo në konsideratë nga të rinjtë sot?

A “është turp të jesh i varfër”?

Tek fëmijët apo të rinjtë ndihet dukshëm investimi te pamja e jashtme, prindërit, duke qenë se kanë kaluar vetë një fëmijëri me shumë mangësi, prirjen t’ua plotësojnë kërkesat fëmijëve, duke hequr nga vetja apo duke lënë gjëra të tjera edhe më të nevojshme.

Të rinjtë marrin mesazhin se nëse je dukshëm i pasur, të tjerët të respektojnë më shumë dhe rritet prestigji. Megjithatë kjo në shumicën e rasteve realizohet me marka false apo ekzagjerime në veshje, të cilat tërheqin vëmendjen, por që nuk lidhen dukshëm me atë që ka brenda vetes personi.

Sado që të vishen këta persona, imitojnë apo ndriçojnë me bizhuteritë e tyre në publik, do vijë momenti kur do të përplasen me realitetin.

Jeta e secilit prej nesh zhvillohet në rrethana nga më të ndryshmet. Kjo e bën ritmin e saj dhe të përditshmen të ndryshme po aq sa dhe të sfiduese. Të lindësh në pamundësi dhe në përpjekje të vazhdueshme për të plotësuar nevojat bazë. Ndërsa vjen një çast kur ndryshon gjithçka dhe ke para syve jetën që ke dëshiruar. Njerëz, rrethana, momente, mosdorëzim që ndryshojnë drejtimin e jetës tënde dhe ke çfarë gjithnjë ke dashur. Por a e kthejmë kokën pas për të mos harruar çfarë ishim?!

Të jesh i ‘varfër’ moralisht, shpirtërisht, po, është shumë e turpshme.

Mall për vitet e bukura "Skënderbegase"



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Për shkollën "Skënderbej" dhe skënderbegasit janë shkruar dhe do të shkruhen shumë, pasi në gati 5 dekada ekzistencë, ajo ishte dhe mbetet një nga shkollat më të mira të vendit dhe një vatër e rëndësishme, ku nisin udhën e përgatitshin kuadrot e ardhshëm të ushtrisë shqiptare, duke zënë një vend të rëndësishëm në historinë e arsimit e mbrojtjes së vendit.

Nxënësit që përzgjidheshin për të studiuar në këtë shkollë mbi kriteret specifike ndër vite e dekada, kanë çarë me dinjitet rrugët e jetës, duke u bërë personalitete të fuqishme të vendit në shumë fusha, që nga letrat, diplomacia, arti, shkenca, pushteti, deputetë, ministra e presidentë.

Janë me dhjetëra e qindra skënderbegas që kanë lënë e po lënë gjurmë evidente në këto fusha të rëndësishme dhe në sektorë delikatë e prioritar të vendit.

Si të tillë, këto personalitete ish-skënderbegas, kanë merituar e meritojnë nderim e respekt tek shqiptarët.

Shumë prej tyre sot ndodhen përtej oqeanit, në "Tokën e Premtuar" apo Amerikën e largët, por kurrë nuk harruan vendin e tyre, shkollën ku u rritën dhe u formuan. Me shumë mall dhe nostalgji vijnë nga përtej oqeanit dhe vargjet e tyre poetike për shkollën "Skënderbej" për shokët, shoqet, profesorë dhe komandantë.

Një prej tyre është dhe ish-skënderbagsi, kapiten (P) Veri Talushllari, i cili larg atdheut por me shumë mall dhe dashuri për tokën, miqtë, shokët, kolegët bashkë-udhëtarët e tij në uniformën e gjelbër, sjell për gazetën "Ushtria" vargjet poetike, me të cilat shpreh nostalgjinë për vitet e arta që ai dhe breza të tërë krenohen me emrin e bukur "Skënderbegas".



USHTAR

Ushtar, Emër i ftohtë si metal i bombës,
Ushtar, Emër i nxehtë si tyta e pushkës,
Ushtar, Emër sintezë kontradiktash të botës,
Ç'të bësh me ty? Të të shkelësh? Të të puthësh?
Ka mijëra vjet që të urrejnë ty,
Ka mijëra vjet që të duan ty,
O qenie e dyzuar, që në sy ke urrejtjen,
Dashurinë ke në sy.
Të veshën sulltanët dhe mbolle ti vdekjen,
Të veshën hitlerët, Ti prapë ashtu.
Po ç' memorialë lavdie të ngritën ty popujt,
Kur Liria çeli në të tuat gjurmë!
Luftën s'e duam!
Por s'është e çuditshme që kundër luftës,
Armët nga dora s'i lëshojmë ne.
Ndryshe, me duar paqësore do ta mbysnim Ditën,
Kur emrin "Ushtar" do ta vëmë në Muze!

MARGARITËS

Ti në bronz, Bronz i ftohtë,
Unë të prek e ndihem ngrohtë.
Dorës sime Ja ndjen gjakun?
Po të rrjedhë do rrjedhë përflakur.
Si dhe yti Atë ditë,
Nga shtatë plumbat Margaritës.
Koha ime, Koha jote,
Bërë një dhe tek kjo tok je.
Hajde motër, Bronzin theyeje,
Ëndrrën tënde mes nesh gjeje.
Shpërthe bronzin. Ngrirë te buzët,
Hajd' t'u flasim njerëzve udhës.
Hajd' t'u flasim me gjithë zënë,
Fjalë lidhur tek një rrënjë.

NË STËRVITJE

Për studentet ushtarake
Kur rrezet dielli derdhi
Mbi grunjërat në kodrinë,
Me dhjetëra diej ndezi,
Në ballin tënd, Ermirë.
Rrëshqasin pika djerse,
Dhe diejt n' ato pika,
I fshin e buzëqeshesh,
"...Të lodh, të lodh taktika..."
Ç'më ngjan ashtu e bukur,
Moj uniformë e blertë!
Në sy pranverën futur,
Në sy dhe krismën vetë!



Lamtumirë, poeti, polemisti, zëri i potershëm, shpirti i temperuar në kudhrën e botës trazimtare

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Agim Doçi lindi më 9 maj 1948, në Shkodër, u arsimua në qytetin e lindjes deri në gjimnaz dhe vazhdoi më pas studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.

Punoi si inxhinier në Montimet Industriale, duke marrë pjesë në shumë objekte të rëndësishme si Fabrika çimentosh, Metalurgjik, Superfosfat Laç, Poligrafik Tiranë etj. Në fund të viteve '80 ka punuar pranë Kombinatit të Drurit "Misto Mame" si kryeinxhinier për energjinë. Në 1989 dënohet, duke u caktuar të punojë me tre turne në fabrikën e letër-kartonit. Përfshihet në lëvizjet e dhjetorit 1990.

Është autor i shumë teksteve të këngëve shqiptare, fituesi i mbi 50 çmimeve, ndër to dhe dy herë përfaqësues me tekstet e tij në Eurovizion.

Veçohet bashkëpunimi me kompozitorin Edmond Zhulali në shumë këngë të festivaleve në Shqipëri dhe me mbi 100 këngë për luftën e Kosovës.

Përmendim këngë shumë të njohura si "Marrshi i UÇK-së", "A vritet pafajësia".

Ka botuar disa libra me poezi si "Hajde dru me pre", "Rrëzuar mbi vetminë", "Rituali i kryqëzimit".

Por jeta shpesh të sjell "surpriza" të pakëndshme, nga ato që të ndalin frymëmarrjen dhe të shokojnë. Siç ishte mëngjesi i nxehtë i fund qershorit, kur mediat nisën edicionet informative me lajmin e trishtë: "Ndahet nga jeta poeti i madh Agim Doçi". A mund të "shuhet" një poet, një shpirt "rebel" që të vërtetën ka sinonimin e tij?

Poeti iku, iku në parajsën e tij, për të lënë mes tokësorësh shumë më shumë se çfarë do të mund të marrë me vete në këtë ikje. Iku pa e përmbytur misionin e tij... Nuk iu dresht asnjë përleshjeje, siç nuk i drehoi asnjë prite.

Luftoi me zë, me zemër e me shpirt, për të fituar, Agim Doçin dhe përjetësinë.


Dhe nuk ishte pak ajo çfarë ai arriti, çfarë ai bëri, çfarë ai dëshoi. Ndoshta la ndonjë gjë pa përfunduar, por ato që ai bëri, i bëri si deshti, duke bërë më të mirën dhe duke u shpërblyer, jo dhe aq me lavdi dhe merita, se sa me përmbyshje të shpirtit.

Na bëri të qeshnim dhe të mendonim, ta donim dhe urrenim. Ndoshta ai nuk kishte një doktrinë për të shpërndarë, por fjalën dhe qëndrimin e bëri tempull. Nuk zbriti nga Kryqi si një shenjtor, por nuk la kryq pa hipur e gozhdë pa provuar. Kishte flakë fjalën dhe zjarr qëndrimin.

Agim Doçi do të jetë përgjithmonë në kujtesën tonë, po aq sa poet dhe polemist, antikonformist dhe kontributor vlerash intelektuale. Zëri dhe mendimet e tij ishin gjithnjë të potershme, sepse vetëm kështu do të ishte e mundur të dëgjohej intelektual dhe veprimtari i vlerave, ai që e donte me mish e me shpirt këtë vend.

Erdhi dhe iku për të mbetur një fenomen poetik dhe mediatic. Agim Doçi nuk kishte një model krahasues, sepse ishte vetë identiteti i tij unik, ajo çfarë përfaqësoi dhe ngulmueshëm kërkoi të ishte aty, aty ku ai guxoi gjithnjë të ndeshej.

Po të kishte të drejtë fjale, Agim Doçi, me patjetër edhe sot do



të kishte diçka për të thënë... Ndoshta do të thoshte, se vdekja ishte zemëruar me të më shumë se sa ata që ai la pa gjumë, apo ata që ai i futi në pështjellime njëjtë si në mendime, me fjalën e tij të urtë dhe humorin e tij pikant.

Vargjet e tij, himn i jetës në të gjitha dimensionet e saj, do të mbeten të pavdekshme.

*Kisha shumë vite që kisha vdekur
Erdhën plot njerëz dhe në varrim
Sa fjalë të bukura që kishin gjetur
I kishin shkruar mbi varrin tim...*

*Sa turp më vinte, sa më peshonte
Rrasa e varrit me ato fjalë.
Ndonëse parajsa nuk më pranonte
Ndoshta dhe shpirti s'më kishte dalë...*

*Sa isha gjallë më ndenjën ftohtë
Nuk e kuptoja çfarë kisha bërë
Doja nga njerëzit një fjalë të ngrohtë
Vetëm më iku, jeta e tërë...*

*Tani që s'jam, mos u frikësoni!
Se larg prej jush vendin e gjeta.
Rri kuvendoj me Perëndinë
Ai s'paska frikë nga e vërteta!*

IN MEMORIAM

Ismail Kadare, testamenti i përherëshëm i kombit shqiptar

Faleminderit mjeshtër!

I madhi Kadare, ishe njeri, u bërë fjalë, pesha e së cilës nuk ka njësi matëse.

Faleminderit për artin e penës tënde, e cila na prezantoi në opinion botëror si një vend që nxjerr vlera, të cilat potencialisht konkurrojnë me pena që i kanë vënë vulën letërsisë botërore.

Faleminderit që gjuhës shqipe i lëvrove çdo pjesë të saj, për t'i kujtuar çdo skeptiku lashtësinë, vlerën dhe forcën e madhe që ka kjo gjuhë krijuar me njerëzimin.

Faleminderit mjeshtër që në romanet e tua skalite Shqipërinë dhe letërsinë shqipe në kanavacën e letërsisë botërore!

Ismail Kadare


Ismail Kadare lindi në lagjen Palorto në Gjirokastrë, më 28 janar 1936. Në itinerarin e jetës së tij, ai dha kontribute si akademik, politikan, ish-deputet i Kuvendit Popullor (1970-'82), zëvendëskryetar i Frontit Demokratik si dhe një ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë.

Si shkrimtar shquhet kryesisht për prozë, por kontributi i tij shtrihet edhe në dramaturgji, poezi dhe përkthime. Nisi të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar.

Deri më sot veprat e tij janë përkthyer në rreth 45 gjuhë të ndryshme, duke qenë kështu përfaqësues kryesor i letërsisë shqipe nëpër botë.

Në vitin 1996, Kadare u bë anëtar i përherëshëm i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Francë.

Është nderuar me shumë çmime ndërkombëtare, disa prej tyre janë: Çmimi "Man Booker International"; Çmimi "Prince de Asturias" për Artet; Çmimi "Jeruzalem"; Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit, Kosovë; "Prix mondial Cino Del Duca" Francë; Çmimi "Bokaçio", Itali; "Herder Prize", Gjermani; "Ovid Prize", Rumani; Çmimi "Man Booker International", Britani; Çmimi "Princi i Asturias për Letërsinë, Spanjë; Çmimi "Lerici Pea", Itali; Çmimi "Jeruzalem", Izrael; "Commandeur de la Légion d'Honneur" (C. LH), Francë, 2016; Çmimi "Letërsia shqipe", Kosovë; Çmimi "Nonino", Itali; Çmimi i karrierës akademike,




nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë; Çmimi "Park Kyong-ni", Korea e Jugut; "Neustadt International Prize", SHBA; "Prozart", Maqedoni e Veriut.

Viteve të fundit ai e ndau kohën e tij mes Francës dhe Shqipërisë.

Një korife si Ismail Kadare

Arti i Ismail Kadaresë është i papërsëritshëm, i dimensioneve dhe vlerave të jashtëzakonshme. Duke nisur nga thesari i pasur i gjuhës dhe dialekteve të shkrimeve të vjetra, historia shqiptare, kul-tura dhe miti, deri te pasuria unike e përvojave, që pa të nuk do t'i përjetonim dhe do t'i mungonin publikut perëndimor. Për shembull, romani i parë i Kadaresë, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", ku pasqyrohet jeta e përditshme e Shqipërisë komuniste me kujtime të historisë së Luftës së Dytë Botërore. Ngjarjet e "Kronikë në gur", të cilat zhvillohen në qytetin e lindjes së Kadaresë, Gjirokastrë dhe shpërfaqin kulturën e veçantë të lagjes në atë mjedis të kufizuar. "Prilli i thyer" na çon në malësinë e Shqipërisë me dukurinë e gjak-marrjes dhe kodet e kanunit, ndërsa "Ura me tri harqe" na sjell Shqipërinë mesjetare, para pushtimit osman,



duke i dhënë mundësinë Kadaresë të përsiasë se si do të ishte Shqipëria sikur të mos ishte pushtuar kurrë.

Gjatë fjalimit të Kadaresë në marrjen e Çmimit “Neustadt”, ai tha: “Të besosh në letërsi do të thotë të besosh në një realitet më të epërm. Të besosh në letërsi do të thotë se regjimi i errët i vendit tënd duket i zbehtë në krahasim me ritet madhështore letrare të vdekjes. Të besosh në këtë art do të thotë të dish gjithnjë se qeveria që të ka në dorë, policia që të mbikëqyr, parlamenti, shefat, administrata, vetë tirania, janë një makth kalimtar, materie e vdekur, krahasuar me urdhrin e madh ku ti bën pjesë si anëtar i tij”. Këtu ai pasqyroi mënyrën se si shkrimtari përdori botën tjetër, magjike të letërsisë, si një mënyrë për t’i shmangur tmerret e së vërtetës dhe për t’u dhënë atyre një formë të re dhe kuptim të ri në art.

Dimensionet e Kadaresë

Ismail Kadare shpesh ishte bërë pjesë e debateve dhe polemikave ndër vite, më së shumti si një figurë publike në Shqipëri, se nuk ka folur publikisht në një mënyrë apo në një tjetër, se nuk ka qenë ky apo ai lloj disidenti, se nuk ka qenë gjithmonë një person publik aktiv. Me artin e tij, ai vë në pah nevojën për ta përdorur penën e tij, për të ndërtuar mbrojtje psikike ndaj realitetit.

Pas krizës së vitit 1998 në Kosovë, kur trupat e Slllobodan Millosheviqit bënë spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës, i cili u pasua nga bombardimet e NATO-s në Serbi më 1999, Kadare shkroi ‘Tri këngë zie për Kosovën’. Në vend që të

shkruante drejtpërdrejt për tensionet e menjëhershme të së tashmes, ky rrëfim u përqendrua në betejën zanafillore të Kosovës në vitin 1389, ndërsa Kadare përsiat mbi tensionet e panevojshme që u krijuan midis popujve ballkanas për shkak të pushtimit turk. Ky ishte Kadare me optikën përtej së tashmes dhe me mesazh të vështirë për ta gjetur me shfletimin e parë të tij.

Arti i Kadaresë, ka aftësinë për të shprehur universalen përmes së veçantës dhe për të shprehur të veçantën përmes universale, letërsia e tij i ka dhënë trajtë njëres prej pikave më të thella të plotësisë së identitetit.

Kadare i flet historisë dhe të tashmes vetëm nga pozita e një shkrimtari të madh dhe pikërisht për shkak të kësaj pozite fjalët e tij do të jetojnë në të tashmen, do t’u flasin njerëzve në të gjithë botën dhe do të lexohen për shumë dekada dhe shekuj të ardhshëm.

Vepra e Kadaresë, letërsia e tij e madhe botërore, e lindur në një kohë shtypjeje të tmerrshme në Shqipëri, përkujton atë brez dhe humbjet e tyre. Edhe nëse nuk prek drejtpërdrejt humbjet, edhe nëse autori nuk është disidenti i përkryer, siç nuk ka mëtuar kurrë të jetë.

“Pallati i ëndrrave” nuk mund të lexohet ndryshe por vetëm si paraqitje therëse dhe brilante e një sistemi totalitar që kërkon të zhvesh qeniet njerëzore nga liria dhe imagjinata dhe nuk mund të mos kremtosh testamentin e përhershëm të lirisë së imagjinatës siç është vepra e Kadaresë.

IN MEMORIAM

Lamtumirë legjendë e futbollit shqiptar, Bejkush Birçe!

Bejkush Birçe lindi më 13.02.1943, në Bolenë të Vlorës.

Karriera si sportist: Vitet 1958-1962 not, basketboll, volejbolli e futboll në Vlorë dhe Tiranë.

Karriera si trajner:

“Partizani” 1971-1972, dhe 1978-1984.

“Naftëtari” 1972-1975.

“Flamurtari” 1975-1978, dhe 1996.

“Teuta” 1984-1987, dhe 1998.

“Dinamo” 1987- 1991, dhe

Ekipin Kombëtar 1991-1994.

Trofe të fituar: Me “Partizanin”, titullin kampion në vitin 1979 dhe 1981, dhe Kupën në vitin 1980. Me “Dinamon” dy Kupa 1989, 1990, titullin kampion 1990, dhe Superkupën në vitin 1990.

Karriera në organet drejtuese: Zëvendës President i FSHF-së, në vitet 1998 -2001, dhe në vazhdim Kryetar i.

Vlerësime: Medaljet “Nderi Futbollit Shqiptar” - FSHF dhe “Mjeshtër i Madh” -Presidenti Republikës.

Bejkush Birçe, gjatë kohës që ishte pedagog në shkollën ushtarake “Skënderbej”, dhe pas karrierës që kishte pasur si sportist i “Flamurtarit” dhe i “Partizanit”, mori një propozim të veçantë që ai nuk e besoi fillimisht.

Në një nga intervistat e dhëna i madhi Bejkush Birçe do të shprehej: “Në vitin 1971 më thanë se isha emëruar trajner i “Partizanit”. Kujtova se bënin shaka me mua. Nuk e besova për një farë kohe. Vetëm kur më merr në telefon Ministri i Mbrojtjes i asaj kohe, Beqir Balluku, pasi më uroi për detyrën e më thotë të shkoja te “Partizani”, e besova. Ishte një detyrë shumë e rëndësishme të ishe trajner i parë i “Partizanit”, në atë kohë. Por edhe një detyrë shumë e vështirë. Sapo kishte mbaruar sezoni dhe para kishim Kupat e Europës”.

Si çdo trajner në eksperiencën e parë, i gjendur në një ambient të ri, por jo të huaj, Bejkush Birçe u detyrua të përballej me vështirësi. Ishte koha e Panajot Panos, e Loro Boriçit etj. Ai tha se pati konfrontime me njerëz të klubit dhe me disa lojtarë gjatë ecursisë, apo drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes, pasi kishte nga ata që e kishin paragjykuar që në fillim, se si trajner pa përvojë nuk ishte ai njeriu i duhur për të drejtuar një ekip elitari, si “Partizani”.

“Ishin edhe këto arsye që Partizani nuk kaloi atë vit një sezon të mirë. Pas tërë peripecive që përjetova, për të shmangur



konfrontime, pa mbaruar ende sezoni shkova në Ministri dhe kërkova dorëheqjen. U thashë se disa gjëra nuk mund të fshihen dhe kam duruar që jam sot këtu, por isha i bindur se ishte momenti i largimit tim. Pasi mu pranua dorëheqja dhe nuk më është bërë asnjë vërejtje, u riktheva në detyrën e mëparshme, si pedagog te shkolla ‘Skënderbej’. Por u largova krenar se i solla “Partizanit” në atë sezon disa lojtarë që lanë gjurmë të thella si Kujtim Dalipi, Sefedin Braho apo Uran Xhafaj”.

Birçe i kishte spikatur si të rinj të talentuar në Vlorë apo Gjirokastrë dhe i propozoi ata që të vinin ushtarë në Tiranë, me qëllim që t’i merrte “Partizani”. Ata shkëlqyen edhe pas kthimit te “Luftëtari” dhe “Flamurtari”.

Bejkush Birçe pa mbyllur mirë ende një sezon largohet si trajner i “Partizanit” dhe vazhdoi detyrën e mësimdhënies, deri në vitin 1975. Dhe në këtë kohë një ofertë tjetër për trajner do t’i ndryshonte sërish rrjedhën e jetës së tij. Mori propozimin për të drejtuar “Flamurtarin” e Vlorës.

“U mendova gjatë, sepse nuk ishte i lehtë rikthimi. Por më bindën në Vlorë, edhe disa miq e vendosa të rikthehesha. Kërkova kohë dhe për tre vjet arrita të reformoja tërë skuadrën. Lojtarët që shkruan historinë e “Flamurtarit” në Kupat e Europës, në fund të viteve ’80, i pata seleksionuar falë një pune voluminoze. Në sezonin që “Flamurtari” po jepte frytet e para të punës, falë atij brezi të artë që krijuam, më vjen një thirrje për t’u paraqitur në Ministrinë

e Mbrojtjes”. Dhe për Bejkush Birçen në fund të viteve '70 ka ardhur momenti i një epoke tjetër. “Kur u paraqita në Ministrinë e Mbrojtjes, sipas rregullave që ata kishin, mu dha direkt urdhri: “Je emëruar trajner i ‘Partizanit!’”. I befashuar, ai nuk e pranoi detyrën e propozuar. Nga eksperiencia e tij e parë, Ministria e Mbrojtjes ndoshta për këtë arsye detyrën e re ia kishte dhënë edhe me tonin e një urdhri. Pas kthimit në Vlorë, i ndërgjegjshëm se “urdrat” e ushtrisë nuk mund të thyheshin, por edhe me sugjerimet e miqve pranoi të rikthehej sërish në Tiranë e të bëhej trajner i “Partizanit”, edhe pse jo me optimizëm. Kjo eksperiencë zgjati pesë sezona. “Pas kthimit iu futa punës. Gjeta një ekip të mirë dhe e rindërtova. Fitova dy tituj kampion radhazi ('79 dhe '81) si dhe një kupë. Eksperiencia e dytë shkoi shumë mirë”.



Përballjet e para Europiane dhe sukseset e Bejkush Birçes

Edhe pse ishte kohë e vështirë dhe Shqipëria ishte e izoluar prej regjimit, nën drejtimin e Bejkush Birçes, “Partizani” arriti të shkruante historinë në Kupat e Europës. Suksesi i parë ndërkombëtar ishte fitimi i Kupës Ballkanike, kur të kuqtë mposhtën skuadrat më të mira të gadishullit, përfshirë edhe ato të ish- Jugosllavisë. Në eksperiencën e dytë si trajner i “Partizanit”, Birçe përveç titujve të parë kampionë si trajner kujton përballjet Europiane me skuadra që ishin kampione të Kupave të Europës në edicionet e kaluara, si “Celtic”, apo “Malmö”, ndaj të cilave fiton dhe barazon në Tiranë, pavarësisht se eliminohet me shumë vështirësi në ndeshjet e kthimit. E njëjta histori përsëritet edhe në përballjen e tretë ndaj “Austriës” së Vjenës, skuadra që në atë kohë kishin shkruar historinë e tyre në kontinent. “Celtic” erdhi në Tiranë si kampione dhe “Malmö” nën-kampione e Europës, ose e krahasuar sot, sikur një ekip shqiptar të fitonte ndaj “Real Madrid-it”. Në eksperiencën e dytë si trajner i “Partizanit”, ai e riktheu ekipin kryeqytetas dy herë radhazi te titulli kampion dhe i siguron një trofe kupe, në finale me Labinotin e Elbasanit, ekipi që shkroi historinë në fillim të viteve '80, kur edhe siguroi titullin e parë kampion me një brez të artë lojtarësh.

1970, “Partizani” shpallet Kampion Ballkani; 1979 – 1980, Kupa UEFA “Partizani” - “Celtic” (1-0, 1-4); 1980 – 1981, Kupa e Kupave “Partizani” - “Malmö” (0-0, 0-1); 1981–1982, Kupa e Europës “Partizani” - “Austria”, Vjenë (1-0, 1-3)

Prapaskenat e humbjes së titullit në Kavajë..., lamtumirë “Partizanit”!

Në fillim të viteve '80, Bejkush Birçe po drejtonte Partizanin me sukses, si në garat kombëtare, ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Por si çdo eksperiencë tjetër, edhe ajo pati problemet e saj. “Partizani” po përgatitej për Kupën Ballkanike. Bejkush Birçe dërgon listën me lojtarë dhe me stafin, që do të pajiseshin me viza, për udhëtimin jashtë. Por lista e tij nuk miratohet. Në klub vjen një listë tjetër, ku i mungonin disa emra, nga stafi i propozuar prej Bejkush Birçes, mes të cilëve emrat e ndihmësit të tij në stol, ish-sulmuesi legjendar Panajot Pano, apo dhe mjekut të paharruar, Ali Kastrati. Bejkush Birçe refuzon të udhëtojë me ekipin për arsye

se nuk ndodheshin emrat që ai kishte propozuar dhe askush nuk kishte të drejtën të propozonte emra të tjerë. Alarm në Ministrinë e Mbrojtjes. Ai thirret urgjentisht në mbledhje nga ministri i kohës Manush Myftiu. “I sqarova arsyet përballë, përse refuzoja të shkoja me ekipin jashtë. Nëse kam unë probleme, apo kanë probleme njerëzit që unë kam propozuar, na shkarkoni nga detyra dhe na persekutoni më mirë, sesa të krijohen të tilla situata”, - ishte propozimi i Birçes në Ministri. Ministri i Mbrojtjes urdhëroi menjëherë që lista e Bejkush Birçes të miratohet dhe ata që ai ka propozuar të pajisen me vizë e të udhëtojnë jashtë. “Për shkak të afatit, vetëm Panajot Pano mbeti pa u pajisur me vizë dhe ne të tjerët, ashtu si edhe i tërë ekipi udhëtuam më tej jashtë”, - shprehet Birçe. Ishte gati një triumf guximi i tij heroik, por megjithatë, kundërshtarët e tij asnjëherë nuk do ta linin të qetë. Në fund të sezonit '84, “Partizani” rivalizonte me “Vllazninë” e Shkodrës, për titullin kampion. “Partizani” i duhej fitorja në Kavajë, ndaj “Besës”, pavarësisht rezultatit të “Vllaznisë” në Berat. Ekipi grumbullohet para një ndeshjeje shumë të rëndësishme, e cila vlente gati sa i tërë kampionati... “Në grumbullim, atë mbrëmje nuk u paraqitën 6 futbollistë të ‘Partizanit’. Ata ishin kthyer nga një ndeshje e Kombëtares, pra ishin lojtarët më të mirë të ekipit. Për këtë arsye, të nesërmen unë i pezullova. Shkova në Kavajë me pjesën tjetër të ekipit. U bë një ndeshje e jashtëzakonshme. “Besë”, edhe pse pa objektiva luajti si për finalen e Ligës së Kampionëve, dhe na ndali në barazim 1-1. Pas ndeshjes mësojmë se “Vllaznia” kishte fituar 2-1 në Berat.

Në autobus kuptuam se kishim humbur titullin kampion. Të gjithë e dinim se përveç zhgënjimit të tifozëve të shumë në Ministrinë e Mbrojtjes ishte bërë nami, por trajneri tashmë e dinte fundin e gjithçkaje të periudhës moniste dhe nuk i trembej syri për masat që sistemi diktonte.

E me gjithë peripecitë e kohës i madhi Birçe do të triumfonte falë punës dhe talentit të tij për sportin.

Birçe, një nga emrat më të mëdhenj të futbollit shqiptar, dha kontribut si lojtar dhe trajner i Kombëtares, ai do të kujtohet ndër breza për njeriun e mrekullueshëm, trajnerin model dhe sportistin shumë-dimensional.

Udhëtim të qetë në rrugëtimin e përhershëm profesor Birçe!

3 dimensionet e familjes së një ushtaraku

Në përditshmërinë e punës time, më duhet të takoj njerëz të ndryshëm në profesion, mentalitet, formim akademik, etj. Ajo që prej kohësh më jep emocion dhe më bën të besoj tek integriteti i familjes shqiptare, normave dhe vlerave morale, është njohja e familjeve ushtarake, ku partnerët aderojnë prej vitesh në Forcat e Armatosura të Ushtrisë Shqiptare. Të përkushtuar në misionin e tyre, me kujdesin e prindërve, në edukimin e qytetarëve të ardhshëm, janë dhe bashkëshortët Flora dhe Artan Dako, prindër të tre fëmijëve Joralda, Rozeta dhe Krisel.

Një familje e bukur, e realizuar, por që pa diskutim ka patur sfidat e veta, të cilat së bashku ja kanë dalë. Flora, ashtu si të gjitha gratë shqiptare me ngarkesat e profesionit, dëshirën për t'u kualifikuar, të qenit bashkëshorte, nënë, ja del falë dhe mbështetjes së saj më të madhe, Artanit, i cili ka mbaruar gjithashtu Akademinë Ushtarake "Skënderbej", dega "Zbulim".

Sot Flora mban gradën nënkolonel

Nënkolonel Flora (Ceraj) Dako ka lindur më 25 prill 1971, në Vaun e Dejës dhe është rritur në Velipojë, Shkodër. Ajo vjen nga një familje Mirditore me tradita dhe është fëmija i gjashtë, nga shtatë fëmijët e familjes Ceraj.

Shkollën e mesme Flora e ka mbaruar në shkollën "Nikoll Zagorjani" në Velipojë, me rezultate të shkëlqyera.

Gjatë shkollës së mesme, zhvilloheshin kurset dyjavore ushtarake, dhe nga këtu Florës i lindi dëshira e uniformës dhe e shërbimit në



uniformë. Pas përfundimit të shkollës së mesme, në vitin 1989, Flora aplikoi për ndjekjen e Akademisë Ushtarake "Skënderbej". Në rrethin e Shkodrës ishte vetëm një bursë e tillë për femra, dhe ajo që e fitoi ishte Flora. Dëshira e saj u realizua, por ajo nuk fsheh dot lumturinë e prindërve të saj dhe sidomos të babait të saj, Markut, i cili kishte dëshirë po aq të madhe sa Flora që ajo të vazhdonte shkollën ushtarake.

Nga viti 1989 deri në vitin 1993 Flora mbaroi Akademinë Ushtarake në degën "Plan-Financë". Nuk ishte aspak e lehtë për Florën të përshtatej me një jetë ushtarake, por dëshira dhe vlerat

e saj e bënë që të punonte me përkushtim e disiplinë të lartë gjatë katër viteve të shkollës.

Pas përfundimit të Akademisë, Flora emërohet në Brigadën e Këmbësorisë, Berat, si shef i shërbimit të veshmbathjes dhe ushqimit, e më pas duke kaluar si shef i Degës së Financës së kësaj komande deri në vitin





2001, ku transferohet në repartin e Policisë Ushtarake, Tiranë, si Shef Finance. Në këtë repart dhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (e porsa krijuar) Flora shërbeu për një periudhë të shkurtër, dhe në janar të vitit 2003, ajo emërohet në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, si Specialist në Sektorin e Buxhetit të kësaj drejtorie. Nga viti 2006-2009 Flora, duke patur një performancë dhe korrektësi të madhe në punën dhe kontributin e saj, u emërua shef i Sektorit të Buxhetit në këtë drejtori (J8). Pra, siç e shikojmë, karriera e Florës është e larmishme dhe e arritur shkallë-shkallë si në pozicione pune, ashtu dhe në gradë. Pas mbarimit të kursit themelor të oficerit, Flora promovohet në gradën e “majorit” në vitin 2006. Në vitin 2009-2010 Flora mbaron Kursin e Komandës e Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë së Mbrojtjes, me rezultate të larta. Po këtë vit Flora promovohet me gradën e “nënkolonelit” dhe emërohet shef i Degës së Programim-Buxhetimit (G8) në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, duke kaluar më tej si shef i Degës së Planifikimit po në këtë komandë, deri në emërimin e saj në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë në NATO si Oficer për Financën dhe Protokollin, nga korriku i vitit 2012 deri në korrik 2015.

Kontributi dhe eksperiencia duke shërbyer në këtë institucion ka qenë maksimale dhe e vlerësuar jo vetëm nga Ministria e Mbrojtjes, por dhe nga homologët tanë në NATO. Flora përfaqësonte Shqipërinë në takimet javore të grupit të punës së Buxhetit & Logjistikës që organizoheshin në NATO, duke qenë shumë aktive dhe e vlerësuar nga kolegët e saj ndërkombëtarë. Nga korriku 2015 deri në tetor 2016, Flora ka kryer detyrën e Përgjegjësit të Sektorit të Programimit dhe Analizës dhe njëkohësisht zëvendësudrejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J5/8) në SHPFA. Në tetor të vitit 2017 Flora fillon Kursin e Lartë të Oficerit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilin e mbaroi me rezultate të larta. Nga dhjetori 2017 deri në qershor 2018, Flora ka shërbyer me korrektësi e dinjitet në KFOR, Kosovë, në Grupin e Bashkuar Logjistik (JLSG) si Shef Shtabi i këtij grupi. Aftësitë e saj komunikuese dhe drejtuese të shtabit prej 35 vetave nga 15 vende të ndryshme të kësaj komande, tregohet qartë dhe në vlerësimin “Shkëlqyeshëm” i bërë nga komandanti i KFOR-it.

Në vitin 2022 sfidon veten me pjesëmarrjen e saj në misionin e KFOR-it, por këtë radhë si zëvendëskomandante e Komandës Rajonale Perëndimore me dislokim në Pejë. Ky ishte përfaqësimi

i parë për Shqipërinë në këtë pozicion, dhe Flora shtroi rrugën për pasuesit e saj në këtë pozicion. Punën e saj dhe vlerësimin e tregojnë edhe vlerësimet e eprorëve të saj në mision.

Pjesë e pandarë e karrierës së Florës kanë qenë dhe kërkesat personale të saj për edukim të mëtejshëm.

Në vitin 2003 Flora ka kryer kursin e Oficerit të Financës në SHBA, me rezultate të larta (Academic Excellence); në vitin 2007 ka kryer Kursin Ndërkombëtar të Oficerit të Shtabit në Holandë dhe Kursin



Ndërkombëtar të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në SHBA; në vitin 2008 ka kryer Kursin Ndërkombëtar të Partneritetit për Paqe; në vitin 2009 ka kryer Studimet Pasuniversitare në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Akademinë Diplomatike në Tiranë; Në vitin 2012 ka kryer Kursin e Lartë të Sigurisë në Gjermani.

Në vitin 2009-2011 Flora ka mbaruar Masterin Shkencor në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, në Degën Administrim Publik, me rezultate të larta dhe aktualisht është Doktorante pranë Akademisë së Forcave të Armatosura.

Nënkolonel Flora Dako ka mbrojtur gjuhët e huaja Anglisht dhe Italisht, si dhe flet Greqishten dhe Frëngjishten mirë.

Nënkolonel Dako është nderuar me tetë medalje, nga të cilat: dy medalje “NATO Balcans Medal” nga Komandanti i KFOR-it, Kosovë, me medalje të “Kryqit Përkujtimor” nga Ministria e Mbrojtjes Italiane, “Medaljen e Luftëtarit” nga SHPFA, si dhe me medalje shërbimi e karriere.

Përjetë mirënjohës veprës tuaj sublime!

LEJLA MALO

E plagosur e masakruar, e torturuar fizikisht, por Lejla Malo qëndronte kryelartë dhe e qetë përpara xhelatëve.

Ajo që ndodhi me partizanen Lejla Malo në Delvinë, mund të jetë një nga rastet më të rralla të egërsisë njerëzore që ka ndodhur ndonjëherë ndaj një vajze të re 15 vjeçare, e cila sakrifikohej për lirinë e Atdheut, duke u masakruar dhe shpërfytyruar fizikisht. Le të kujtojmë një shembull nga tragjedia “Iliada” e Homerit. Gjatë dyluftimit midis Akilit dhe Hektorit, babai i Hektorit, duke parë se përbindëshi Akili po e fitonte dyluftimin, iu lut kundërshtarit që të mos e shpërfytyronte Hektorin. Mbi egërsinë shtazarake fitoi arsyeja njerëzore. Akili e mundi kundërshtarin e tij, por nuk e dëmtoi fizikisht në fytyrë. Ndërsa nazistët dhe ballistët egërsira Lejla Malos i bënë çdo lloj torture dhe kur ajo kishte vdekur, e tërhoqën zvarrë nëpër rrugët e qytetit të Delvinës për të trembur njerëzit që të mos i bashkoheshin LANÇ-it.

Lejla Malo lindi në dhjetor të vitit 1929. Në moshën 15 vjeçare ajo doli partizane dhe u inkuadrua në batalionin “Thoma Lula”. Partizania më e re dhe më e vogël e batalionit, u bë shpejt e njohur, e dashur me të gjithë, megjithëse jeta e saj si partizane zgjati vetëm 10 ditë!

Me urdhër të shtabit të Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë, më 18 korrik 1944, grupit të katërt iu ngarkua detyra të sulmonte forcat gjermano-balliste që ishin dislokuar në Delvinë. Lufta ishte e ashpër. Lejla me skuadrën e saj luftonte në kalanë e qytetit. E rrethuan nga të gjitha anët. Ajo nuk e humbi kurajën, por vazhdoi të qëllonte si një luftëtare e regjur e u përgjigjej me zjarr thirrjeve të ballistëve për t'u dorëzuar. Por armiq të e kapën Lejlan të gjallë. E plagosur rëndë në një këmbë, ajo nuk arriti të tërhiqej.

Kriminelët ballistë u vërsulën kundër saj si ujçer të tërbuar dhe e masakruan barbarisht partizanen 15 vjeçare. Në



vend të ujit që kërkonte ajo për të njomur buzët e thara, ata i jepnin goditje me kondakët e pushkëve.

E plagosur, e masakruar, e torturuar fizikisht, Lejla Malo qëndronte kryelartë dhe e qetë përpara xhelatëve. Atë mëngjes korriku, populli i Delvinës pa një skenë të llahtarshme. Ballistët si bisha të etur për gjak, pasi nuk mundën ta thyenin vullnetin e saj të hekurt, u munduan ta shfrytëzonin këtë rast për t'i futur tmerrin dhe për ta larguar nga lufta për liri popullin patriot të Delvinës.

Pas torturave çnjerëzore që i bënë, ata e zvarritën në rrugët e qytetit, ndërsa në sytë e saj shkëlqente drita e pashuar e idealit dhe e besimit në fitoren e LANÇ-it.

RAQI QIRINXHI

Raqi Qirinxhi ishte me shtat mesatar, jo fort i gjatë, i bëshëm, por “dru thane”, siç thotë populli. Cilësitë e larta morale e shpirtërore, Raqi i kaliti dhe më tepër kur mori pjesë në LANÇ, si anëtar i orëve të para të PKSH-së. Raqi ishte dhe mësues i Liceut të Korçës dhe partizan. Nxënësve u mësonte shkencat në shkollë, ndërsa aktivistët i njihnte me parimet dhe nevojën e luftës revolucionare për çlirimin e Atdheut. I ashpër dhe i drejtë ishte ai në mësimin e matematikës dhe të shkencave të natyrës, por më shumë akoma në mësimin e shkencës së revolucionit. Në mbrëmje u kërkonte llogari “nxënësve” të vet për punën revolucionare që kishte zhvilluar me masat, të nesërmen ai i kërkonte llogari “shokut” të vet për sinuset e kosinuset. Raqin e thirri detyra e PKSH-së të dilte shpejt në mal si komisar i çetës së komanduar nga patrioti Riza Kodheli dhe pastaj si intendent i Shtabit të Qarkut të Korçës. Të ishte intendent i një ushtrie popullore, të cilën ku e zinte mbrëmja, s’e zinte mëngjesi, i një ushtrie pa kazerma, pa industri, pa armatim e pajisje, pa depo, pa mjete ndërlidhjeje, por vetëm me “koeficientin” më të lartë, siç thoshte Raqi, i besimit të patundur në drejtësinë e çështjes dhe në fitoren e popullit, nuk ishte as punë e thjeshtë dhe as e lehtë. Raqit i duhej të siguronte veshmbathjen, ushqimet, armët, municionet etj. dhe të lejonte harxhimin e çdo gjëje me kursimin më të madh. Sado i vështirë të ishte “polinomi” në algjebërën gjithmonë të ngatërruar të intendentit, Raqi dinte të zgjidhte çdo problem të matematikës. Atij i vinte keq për humbjen kot të gjësë më të vogël që mund t’i shërbente luftës. Njerëzit që kishin fjalë shumë e punë pak, ai i quante “qymyr i lagur” që kërcet, s’të ngroh dhe njerëzit që s’mendonin thellë për ruajtjen e mjeteve luftarake, i quante “dorë e mendje shpuar”. Sa i rreptë ishte me të tjerët, aq i rreptë ishte Raqi dhe me veten e tij. Nuk diti sa ishte gjallë se ç’ ishte gjumi i plotë, se ç’ ishte dreka e darka dhe se ç’ ishte pushimi. Tani ndodhej këtu pastaj atje, sot në mal, nesër pa gdhirë në fushë. Brenda një kohe të shkurtër përshkonte, kaluar apo në këmbë, ditën apo natën, në zheg apo në tufan, të gjithë rrjetin e gjerë të bazave të vendit. Gjithë kjo punë e vështirë, në kushte të vështira s’ia hoqi kurrë buzagazin Raqit. Ai sa herë që e takojë ishte shend e verë me të gjithë, i dashur me secilin, por i rreptë e parimor, kur e donte puna.

Ishte maji i vitit 1943. Voskopoja, kjo qendër partizane e krahinës së Korçës, gumëzhinte nga këngët partizane. Njësitë luftuese po bëheshin gati për udhë për të goditur armikun në qytetin e Leskovikut. Bashkë me partizanët atë ditë ishin dhe një numër i madh nxënësish të shkollave të mesme të Korçës. Ata kishin lënë librat për të kapur pushkën e lirisë. Tani nxënësit e Raqit ishin bërë shokët e tij. Asnjëri prej tyre nuk pranoi të mos merrte pjesë në aksionin kundër garnizonit armik të Leskovikut. Kjo e gëzoi Raqin, sepse këta nxënës ishin nga



ata që në shumë raste i kishte edukuar vetë. Ai i mblodhi të gjithë ata djem të rinj për t’u folur dhe nuk i lëshonte kot fjalët Raqi. Kur ishte puna për fjalë e thjeshtonte tek s’mbante më shprehjen algjebrike dhe priste shkurt. Prandaj, duke buzëqeshur e nisi dhe e mbaroi kështu fjalën e tij atë ditë: “Dëgjoni këtu! Në shkollë disa prej jush kanë marrë pesa në provimet e matematikës. Në notat unë kam qenë i rreptë, ju e dini mirë. I rreptë jam dhe tani, por ju e dhatë provimin shkëlqyeshëm këtu në mal!”

Raqi Qirinxhinë e donin dhe e nderonin jo vetëm nxënësit dhe shokët e tij, por të gjithë ata që kishin rastin ta njihnin, qoftë dhe pak. Atë e urrenin shumë armiqtë e popullit dhe ky ishte një plus tjetër për këtë nxënës, mësues dhe luftëtar të shquar.


AT SHTJEFËN GJEÇOVI - KRYEZIU, DËSHMOR I GJUHËS SHQIPE



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Me rastin e 150-vjetorit të lindjes së kolosit të Atdheut, Shtjefën Gjeçovit (12.7.1874 – 14.10.1929), dëshmorit më të ri të kombit shqiptar të shpallur me vendim nr.850 datë 21.6.2021, të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Shtjefën Gjeçovi është cilësuar një “makinë intelektuale” enciklopedike, që na ka lënë një trashëgimi të shkruar prej më shumë se dhjetë mijë faqesh, i cili njihet tetë gjuhë të huaja, që konsiderohet “Instituti shkencor gjeçovian”. Përjetësi dhe pavdekësi për dëshmorin e atdheut, dëshmorin e gjuhës dhe kulturës shqipe Shtjefën Gjeçovi!

Vatër atdhetarie që lindi një meteor të shquar të shqiptarizms
Shtjefën Gjeçovi, lindur dhe pagëzuar si (Mëhill) Hilë Gjeçi në Janjevë (Kosovë), më 12 korrik 1874, dhe i ekzekutuar nga dora gjakatare serbe në Zym të Hasit të Thatë, më 14 tetor 1929, ka qenë frat françeskan, arsimtar, mbledhës folklori, arkeolog, publicist shqiptar dhe mbi të gjitha përhapës i arsimit dhe gjuhës shqipe. Ai u shqua për punën e madhe kërkimore të mbledhjes së traditave dhe mënyrës së jetesës të shqiptarëve të veriut dhe veçanërisht për kodifikimin e përmbledhjeve të lëndës kanunore të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Veprimtaria e tij mbuloi gjithashtu përpjekjet e kohës për afrimin e Kishës Katolike me Uniatizmin dhe Kishën Ortodokse shqiptare, si dhe ka qenë pjesë e intelektualizmit përparimtar shqiptar kudo ku e kërkonte dhimbja therëse e Atdheut. Të dhënat bibliografike flasin se Hilë Gjeçi ka për origjinë Kryeziun e Pukës, Janjevën e Vilajetit të Kosovës, në kohën e Perandorisë Osmane. Trualli atdhetar dhe të parët, të zgjuar prej natyre e bënë Mëhillin një fëmijë tepër të zgjuar. Duke e parë këtë gjendje famullitari françeskan i Janjevës, u mori leje prindërve, dhe e mori një ditë për dore Shtjefënin 10 vjeçar dhe u nis bashkë me të për në Kolegjin françeskan që ndodhej në Shkodër. Kur i veshën zhgunin e murrme, të fratit iu duk vetja më i rritur dhe më i burrëruar. Arsimimin françeskan e mori në Troshan (1884-1888). Më 16.8.1888 u nis në kuvendin e Fojnicës për vitin e rishtrisë dhe vijoi studimet më tej në Derventë dhe Banja Luka, por ndoqi mësimet edhe në Kreshevë. Në këtë periudhë Bosnjë-Hercegovina ishte trualli ku përgatiteshin një pjesë e konsiderueshme e françeskanëve shqiptarë, në të njëjtin vend ku u arsimua edhe Gjergj Fishta. Studimet e tij vijuan deri në vitin 1896, kur edhe kthehet në atdhe dhe meshon për herë të parë në Troshan, vit që ndërron emrin dhe në regjistrat françeskanë quhet: Shtjefën Kostandin Gjeçovi. Shërben si famullitar në Rubik; në verën e 1897 në Pejë, ku emërohet famullitar në Zllakuqan, vendi që në korrik hap shkollën e parë. Nga 1899 deri më 1905



shërben në famullinë e Laç-Sebastes, ku rihap shkollën shqipe në Laç. Lidh shoqëri të ngushtë me Konicën dhe përmes tij siguron materiale mësimore për nxënësit. Në fund të dhjetorit 1905 punësohet mësues në Kroaci (Borgo-Erizzo), ku zëvendëson Pashk Bardhin, por dorëhiqet dhe pas disa muajsh është aktiv dhe merr pjesë në Kuvendin e Bajrakut të Kurbinit. Në gusht 1906 gjendet në Durrës dhe pas disa muajsh nga tetori 1906 deri më 1907, ngarkohet me kolegjet françeskane në Shkodër. Në maj 1907 caktohet në Gomsiqe, ku çeli edhe shkollën e parë në këtë fshat. Bashkë me Dom Nikollë Kaçorin kontribuon për kuvendet e Kurbinit, përshëndet punimet e Kongresit të gjuhës shqipe të Manastirit, (14.11. deri më 22.11.1908), për standardizimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Prushi atdhetar e rreshton krahas forcave më përparimtare të kohës si kundërshtar i pushtimit, bashkëpunues në futjen e armëve nga tregjet e huaja, kundër fushatave ndëshkuese radhitet me çetat komite. Përjeton me gëzim pavarësinë e 28 nëntorit 1912 në Vlorë. Më tej është pjesëmarrës me krerët e Pukës, Mirditës, Zadrimës e Lezhës, në kuvendin e 7 korrikut 1913 në Lezhë.

Vitet që pasuan emërohet në Troshan (1915) dhe pas një viti, më 1916, në Theth, Shalë e Shosh, ku kolera kishte pllakosur zinë e pandemisë dhe vdekja ishte fare pranë jetëve njerëzore. Në kohën e pushtimit austro-hungarez punon në Prekal dhe shtëpia ku u vendos banohej edhe nga komanda lokale austro-hungareze. Në shtator 1917 u jep mësim fëmijëve shqiptarë në dhomën-shkollë ku banonte, për 26 nxënës djem paradite dhe 11 nxënës pasdite, mësimdhënie që e kërcënuan me ndalim veprimtarie si mësues, duke e kushtëzuar furnizimin material me fenë. Pranvera e vitit 1920 e gjen Shtjefën Gjeçovin në kishën katolike të Vlorës,

ku takohej shpesh te Dom Mark Vasa, që kishte marrë mërinë e autoriteteve italiane. Bëhet njësh me patriotët më të zjarrtë të krahinës së Vlorës dhe merr pjesë në takimet për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë. Gazetat “Politika”, “Mbrojtja kombëtare”, “Drita” e cilësojnë Shtjefën Gjeçovin si “luftëtar i Njëzetës”, si mbrojtës të komunitetit vlonjat në periudhën e luftës, si hulumtues dhe njohës të traditave të Labërisë dhe të përbashkëtat zakonore të të gjithë shqiptarëve. Pjesëmarrës në të gjithë aktivitetet e komisionit organizator të fitores së Luftës së Vlorës. Më 7.6.1923 emërohet sekretar i Provincës Françeskane. Pas një viti, më 1924, gjendet në krahinën e Elbasanit, ku gjatë verës bashkë me Simon Shuteriqin zbulon në kishën e Shën Kollit të qytetit të Elbasanit kabanën e Sopotit të Bërzeshtës, që datonte që nga koha e Gjergj Aranitit. Më 1926 emërohet në famullinë e Zymit të Hasit të Thatë, ku aktivitetin e zhvillonin edhe në Pejë, Gjakovë e Prizren. Dora gjakatare ngrihet kundër At Shtjefën Gjeçovit 55 vjeçar, në vendin e quajtur Kodër Rrezina më 14.10.1929, duke i marrë jetën qarqe antishqiptare, por që nuk mundën të vrisnin idealet e tij patriotike atdhetare të shqiptarizms dhe përhapjes së kulturës kombëtare shqiptare. “E keqja”, që kishte bërë Gjeçovi është se për gjashtë muajt e fundit të jetës kishte punuar në Zym nga prilli deri më 14 tetor, ku u mësonte gjuhën shqipe fëmijëve dhe të rriturve, pa marrë parasysh se cilit besim i takonin. Pëllëmba për mësuesin serb të mbretërisë serbo-kroate slovene paguhej me plumb. Mësuesi i Kombit Shtjefën Gjeçovi është varrosur në Shëngjergj afër Zymit të Hasit. Në Zym të Hasit të Thatë gjendet qendra memoriale ndërtuar në nderim të tij.

Shtjefën Gjeçovi, përmendore e mençurisë shqiptare

Në memorien e kombit shqiptar është regjistruar një emër i shndritshëm dhe meteor i kulturës dhe gjuhës shqipe. Gjeçovi paralelisht me detyrimet e besimit për meshën, ai mblodhi si “zog pule i uritur”, traditat e Shqipërisë Veriore, të rrafshit të Mirditës dhe Alpeve Shqiptare, poezinë popullore të malësive, zakonet e të drejtës popullore dhe lëndë etnografike, por edhe arkeologjike. Ai i raportoi rregullisht kërkimet e tij, duke botuar materiale etnografike, arkeologjike dhe histori lokale nëpër të përkohshme të kohës. Ai ka qenë i pari folklorist shqiptar që ndërmori punë kërkimore në terren sipas kriterëve metodologjike të kohës. Përvoja e tij zë fill në periudhën studentore në Bosnje me një punim historik mbi Arqipeshkinë e Tivarit bashkautor me sivëllain Lovro Mihaçević, duke punuar të paktën gjashtëmbëdhjetë faqet e para me titullin në latinisht “Metropolis Antibarensis”. Botimet e para të Shtjefën Gjeçovit janë dymbëdhjetë poezi tek gazeta “Albania” e Faik Konicës me emër pende “Lkëni i Hasit”. Fakt është se punimi më i rëndësishëm i jetës së tij që përmbledhja e kodit zakonor shqiptar, botimi i të cilit u titullua “Kanuni i Lekë Dukagjinit. Mbledhjet e para të kanunit i botoi në vitet 1898-1899, tek gazeta “Albania” e Faik bej Konicës, më 1897-1898, dhe më pas tek “Hylli i Dritës” në vitet 1913-1924, ndërkohë që përmbledhja e plotë ka 1263 nene, të rendura në 12 kapituj, dhe që u botua nga françeskanët së pari, më 1933, vetëm pas vdekjes së tij, ose më qartë dhe më saktë pas vrasjes së tij. Metoda se si u bë mbledhja nuk është bërë tashmë e njohur për publikun, ndërkohë që vepra e Gjeçovit ndriçon si pishtarë i përjetshëm, për vlerën e madhe që kishte për dje, për sot dhe për të nesërmen e shqiptarizms.

Kompletimi me arsimim i françeskanëve në Austri dhe Italisë e zgjeroi dritën e dijes por edhe interesimin e Gjeçovit për historinë e shqiptarëve dhe vendin e popullit të tij krahas civilizimeve të tjera ballkanike e europiane, për fillimet e krishterimit, për arkeologji, etnografi, gjuhësi e letërsi. Provoi të shkruante vetë dhe të thellohej në shkencat humane, krahas detyrimeve që rrjedhin nga predikimi i Ungjillit të Krishtit. Në moshën 22 vjeçare më 1896, kur u kthye në Troshan si famullitar i ri i pajisur me dije

të thella me kulturë të gjerë, por edhe energji të shumta, krahas zhgunit të murrme të fratis fitoi aftësinë e mësimdhënies, aftësi që do ta vinte në veprim në interes të përhapjes së gjuhës dhe kulturës shqiptare. Shtjefën Gjeçovi predikoi ungjillin në Rubik, Pejë, Laç-Sebaste, Zarë, Sapë, Theth, Prekal, Vlorë, Shkodër, Gjakovë e Zym të Hasit (për kohën rrethinë e Prizrenit). Vitet që pasuan pas kapërcimit të shekujve, më 1900-ën, Gjeçovi pati angazhim të plotë në shumë fusha të kulturës dhe të arsimit. U konsolidua si shkrimtar, duke shkruar në të tria gjinitë letrare. Detyra e françeskanit e çoi në shumë vende dhe kudo ku shkonte mblodhi shkrime të rralla, këngë, mite, legjenda, përralla, doke e zakone popullore, por një ndër kryeveprat e tij është “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, i cilësuar pa rezerva monument i gjuhës dhe kulturës së Kombit Shqiptar. Vepra e Gjeçovit e formatuar në 1263 nene, nisi të botohej për herë të parë tek “Albania” e Konicës më 1897-1898, më mbura edhe në organin e shtypit të françeskanëve që nga dalja e “Hyllit të Dritës”, më 1913, deri më 1924. Botimi i plotë doli më 1933, pas vdekjes së autorit me parathënie të Gjergj Fishtës; ndërkohë që titulli u përzgjodh nga Fishta që ishte një fjalëformim Lekë (malësor, sipas kumtit parak, banorët e Malësisë së Madhe) dhe Dukagjin. Më vonë “Kanuni” u përkthye pjesë-pjesë, nga mikesha e shqiptarëve dhe e Egerem Vlorës, baronesha Marie Amelie von Godin, edhe me ndihmën e etërve françeskan. Ky punim bëri të mundur që më 1936, Universiteti 600 vjeçar gjerman i Lajpcigut në Drezden t’i akordojë titullin “Doktor i shkencave in honoris causa”, postum Shtjefën Gjeçovit për vlefën e Kanunit. Në gjuhën italiane, Kanuni u përkthye nga Pal Dodaj në bashkëpunim me Giuseppe Schiro dhe u botua nga Akademia e Arteve dhe Shkencave në Romë, më 1941. Shtjefën Gjeçovi ka edhe një seri veprash të tjera si, “Dashnia e atdheut”, drama “Agimi i qytetnisë”, “Shqiptari ngadhënyjes”, “Përkrenarja e Skënderbeut”, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, vepra “Trashëgime trako-ilire”, “Jeta e Shën Luçisë, Shna Ndou i Padues, Atil Reguli” – përkthim i lirë i dramës me 3 akte të Pjetër Metasatasit, “Vazja e Orleanit” ose “Zhan D’Ark” mbas A.F. prej Bergamos, punimi teologjik “Shpërbleti i botës ase Jeta e Jezu Krishtit”, e shkruar në frymën e gjuhës shqipe dhe në frymën e dashurisë për Krishterimin. Por shumica e veprave të Shtjefën Gjeçovit mbetën në dorëshkrim, si “Princi i Dibrave”, “Mojsi Golemi” (dramë), “Mnera e Prezës” etj., shumica e këtyre dorëshkrimeve ruhen në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Puna e Shtjefën Gjeçovit është në vazhden e veprimtarëve të Rilindjes për të mbledhur e për të dëshmuar traditat kombëtare dhe lashtësinë historike, kulturën e tyre materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve, duke lëvruar fjalën shqipe dhe ngritur ndërgjegjen kombëtare. Edhe vepra “Kanuja” u botua pas vrasjes së tij. Gjeçovit i janë kushtuar shkrime të shumta, si françeskani Atë Pashkë Bardhi, historian i fetërve që e njohu nga afër, por mbi të gjitha qëndron monografia “Shtjefën Gjeçovi, Jeta, vepra”, shkruar nga Ruzhdi Mata. Shtjefën Gjeçovi mbeti monument vlerash të pashterueshme, pishtar i ndriçimit të historisë, gjuhës dhe kulturës së kombit. Monumentale ka ngelur shprehja e tij: “Giuha e nji komit s’kaa t’ndalun, as nuk münd t’ndålet kurr”. “Sa münd t’mëndohet dielli pa dritë, aq mund t’mëndohet komi pa giuhë”. Vlerat e gjuhës dhe kulturës qëndrojnë në themel të kombit pasi “...giuha është nji gjaa sënd qi nuk münd t’blehet, nuk shitet e nuk ndrohet; nji sënd është, qi do t’ruhet si nji gur i çmue, do t’ruhet si nji dhantii e posaçme e Perendisë e si nji trashigim i t’parve tonë... do t’ruhet si drita e synit. Kjo dhantii... është giuha shqype”. Bashkëkohës dhe studiues të të gjitha kohërave përbashkohen në vlerësimin e figurës së Shtjefën Gjeçovit: Figurë poliedrike e historisë dhe kulturës shqiptare, që punoi fort në gjithë fushat e diturisë, që çuditi me kulturën e tij Faik Konicën, i cili e përshkruan me nderim e simpati të thellë; mrekulloi shkrimtarin e ri të shkollës letrare shkodrane, Dom Lazër Shantojën, i cili i kushtoi një portretizim të veçantë, duke e radhitur përkrah Fishtës e Harapit. Gjeçovi



është klasifikuar si historian, etnograf, arkeolog, mbrojtës i flaktë i sigurisë njerëzore gjatë Luftës Kombëtare të Vlorës.

Gjeçovi - dëshmor me dokumente juridike pothuaj një shekull pas vrasjes

Duke përkujtuar 150-vjetorin e lindjes së Shtjefën Gjeçovit, sjellim në vëmendje të lexuesit përpjekjet për shpalljen dëshmor i Atdheut të një figure që i ngriti vetvetes me vepra një monument të pavdekësie, pasi Shtjefën Gjeçovi ishte dhe mbeti pishtar i gjallë i ndriçimit të historisë dhe kulturës së kombit shqiptar. Ja vlen shumë të sjellim në vëmendje postulatit ndaj shqiptarizms: "Giuha e një komiti s'kaa t'ndalun, as nuk mûnd t'ndâlet kurr".

"Sa mûnd t'mëndohet dielli pa dritë, aq mund t'mëndohet komi pa giuhë". Ai i bën të ditur patriotëve të tij vlerat e gjuhës: "âsht një gjâa sênd qi nuk mûnd t'blehet, nuk shitet e nuk ndrrohet; një sênd âsht, qi do t'ruhet si një gur i çmue, do t'ruhet si një dhântii e posaçme e Perendiis e si një trashigim i t'parvet tonë... do t'ruhet si drita e synit. Kjo dhântii... âsht giuha shqype".

E mbyll paragrafin, duke vendosur në fund këtë aforizëm: "Sa mûnd t'mëndohet dielli pa dritë, aq mund t'mëndohet komi pa giuhë". Shtjefën Kostandin Gjeçovi, veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare, frat françeskan, etnolog, arkeolog, poet e shkrimtar i spikatur, filozof, përhapës i shkollave shqipe në Shqipërinë e këtaj Drinit dhe matanë Drinit, "Mësues i popullit", iniciator për unifikimin e gegërishtes me toskërishten, mbrojtës i paepur i sigurisë së qytetarëve të Vlorës përgjatë Luftës Kombëtare të Vlorës të 1920-ës dhe figurë me përmasa të madha kombëtare.

Mëhill Gjeçi-Kryeziu është quajtur për 22 vjet, nga lindja e tij, më 12.7.1874 deri më 29.6.1896, kur e ka ndryshuar emrin në Shtjefën Kostandin Gjeçovi, pasi përfundoi studimet e larta teologjike në Kreshevë të Dalmacisë dhe në regjistrat françeskan zhduket emri Hilë Gjeçi dhe zëvendësohet me Shtjefën Konstantin Gjeçovi. Faik Konica e ka cilësuar Gjeçovin si, "njeri nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria", ndërsa albanologu austriak Norbert Jokli e ka quajtur, "punëtor i palodhur në fushën e letrave shqipe". Gjeçovi bashkëpunoi me revistat e kohës: "Populli", "Hylli i dritës", "Albania", "Brezi i ri", ku ne e gjejmë me pseudonimet "Komnen Kanina", "Lkeni i Hasit", "Zana e Prezës", "A.Sh.K.Gj", "O.F.M", dhe nga ana tjetër la rreth 10 000 faqe dorëshkrime. Ai ishte si një "makinë intelektuale" enciklopedike, i cili njihte tetë gjuhë të huaja dhe që konsiderohet "Instituti shkencor gjeçovian". Gjeçovi ka ngelur përjetësisht në memorien e kombit edhe si rezultat i një nisme të djemve të fshatit të tij të origjinës Kryeziut dhe kryesisht mikut tonë zoti Bilbil Dervishi (bashkëfshatar i dëshmorit) si dhe Shoqatës Kulturore Atdhetare "Labëria" Dega e Tiranës, Shoqatës së Historianëve Ushtarakë Shqiptarë e kryetarit Profesor Bernard Zotaj si dhe Sekretarit të Përgjithshëm që formatuan një dosje voluminoze për fratin françeskan që jetën e dha për shqiptarizmin, për gjuhën dhe shkollën shqipe. Këtu nuk mund të lëmë edhe falënderimin për profesore Pranvera Dibra, ish-Drejtoreshën e Arkivit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, që mundësoi dokumente sipas origjinalit për vrasjen e Shtjefën Gjeçovit, por dhe për dokumentet e diskutimet në parlamentin e Shqipërisë të vitit 1929, ku për herë të parë përmendet termi "dëshmor", për një bir të madh të shqiptarizms. Shpallja 'dëshmor' është një ndërmarrje jo e vogël, megjithëse për këtë rast kemi pasur mbështetje nga Bashkia e Pukës, Këshilli Bashkiak si dhe Prefektura e Shkodrës. Fakt është se mësuesi i Kombit Shtjefën Gjeçovi është varrosur në Shëngjergj afër Zymit të Hasit. Në Zym të Hasit të Thatë gjendet edhe qendra memoriale e ndërtuar në nder të tij. Por pas daljes së Vendimit për shpallen e tij dëshmor i Atdheut, bazuar në ligjin e shtetit shqiptar Nr. 109/2018

"Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", Neni 13 i ligjit "Vendprehja e dëshmorëve të atdheut", që thotë: "4. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezën e dëshmorëve të atdheut "Nëna Shqipëri", në kryeqytet, bëhet me vendim të Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i atdheut", me kërkesë të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut, prefektit ose ministrit. 5. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qarqet përkatëse bëhet me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose të prefektit". Në nenin 14 të ligjit shkruhet: "Ceremonia e varrimit të dëshmorit të atdheut. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij bëhet me ceremoni zyrtare, me arkivol të mbuluar me flamurin kombëtar". Por për rastin e dëshmorit Shtjefën Gjeçovi i kapërcen përmasat lokale dhe është i pamjaftueshëm edhe përkujtimi që më 12 korrik 2024 i bëri Muzeu Historik Kombëtar At Shtjefën Gjeçovit për ditën e tij të lindjes. Gjykojmë se kërkohet një vendim i posaçëm dhe varrosja e eshtrave të tij gjykojmë se meriton të prehet në varrezat e dëshmorëve të kombit në Tiranë, ose në konsensus midis strukturave qeveritare të Prishtinës dhe të Tiranës. Në Tiranë dhe Prishtinë Shtjefën Gjeçovi meriton një nderim e vlerësim më dinjitoz për vlerat që përfaqëson sikurse meriton buste të tij në Janjevë të Kosovës si dhe një muze e monument në Kryezi të Pukës.

Burimet e studimit: AQSH, Fondi 58, Shtjefën Gjeçovi, Dosja 95/14 dhe 95/15, si dhe të dhëna të marra nga Arkivi i Ministrisë së Jashtme dhe Çështjeve Europiane



Almanaku i historisë Shqiptare në rrugëtimin e tij për liri dhe pavarësi

Në pikëpamje formale, qëllimi i Kongresit të Berlinit ishte të rishikonte dhe ndryshonte vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, me synimin e ruajtjes së paqes në Europë. Përvoja historike tregoi se ky Kongres e ruajti për disa dhjetëvjeçarë paqen por, po ashtu tregoi se ai nuk e kishte potencialin dhe as qëllimin e zgjidhjes në mënyrën e duhur të problemeve në Ballkan. Konfliktet që shpërthyen në Ballkan, në kuadër të krizës lindore ishin të reja, të panjohura dhe të pa imagjinuara për kohën dhe përmasat që mund të merrnin ato në të ardhmen.

Kriza e madhe lindore e viteve 1875-1878, e cila u kurorëzua me Kongresin e Berlinit, tregoi se, vakumi i pushtetit që po krijohet me humbjen e territoreve të Perandorisë Osmane nga Ballkani do të krijonte një vatër të re konfliktesh në Europë. Kongresi i Vjenës (18 shtatori 1814 - 9 qershor 1815) në një farë mënyre e kishte kursyer Ballkanin nga ndryshimet territoriale, e kjo më tepër për faktin se Perandoria Osmane nuk ishte e përfshirë drejtpërsëdrejti në luftërat napoleoniane dhe vazhdonte të ruante ende sukerenitetin dhe sovranitetin e saj në Ballkan.

Paralel me këto zhvillime dhe pak kohë para se të thirrej

Kongresi, edhe në Rajhun e sapokrijuar gjerman u përkeqësua situata e brendshme. Atentati i dytë ndaj Perandorit Wilhelm I, u krye një ditë para se të dërgoheshin ftesat zyrtare për fillimin punimeve të Kongresit. Po ashtu një ditë para se kongresi të fillonte punimet, Bismarck-u shpërnda Reichstag-un, si pasojë e mosmiratimit të ligjit të parë për socialistët. Kështu që Bismarck-u ishte në pozita politike të brendshme të pafavorshme, për më tepër që një tentativë e tij për të bërë një aleancë me Partinë Nacional-liberale kishte dështuar, Perandori 81-vjeçar Wilhelm I ishte i plagosur rëndë dhe po ashtu edhe vetë Bismarck-u kishte probleme shëndetësore. Vetëm pas ndërhyrjes së Carit Aleksandër II, Bismarck-u pranoi të drejtojë punimet e Kongresit.

Por cilat ishin interesat e shteteve pjesëmarrëse në këtë Kongres dhe çfarë synonin të arrinin ato?

Anglia kërkonte të siguronte rrugën detare për në Indi nëpërmjet Detit Mesdhe, kanalit të sapo ndërtuar të Suezit dhe Detit të Kuq. Këto synime ajo mund t'i arrinte, duke i ndërprerë Rusisë daljen nga Deti i Zi në atë Mesdhe nëpërmjet ngushticave detare. Nga njëra anë, Rusia, kërkonte daljen në Stamboll

dhe Ballkan. Ajo e shikonte veten të bllokuar nga Anglia, gjatë përpjekjeve të saj për të goditur Perandorinë Osmane nëpërmjet mbështetjes që i ofronte kryengritjes së popujve sllavë të Ballkanit. Nga ana tjetër, Anglia, ishte e interesuar në ruajtjen e statusit të Perandorisë Osmane në Ballkan, pikërisht për t'u ruajtur nga ekspansioni rus në Ballkan. Të njëjtën politikë ndiqte edhe Austria.

Franca kishte në Lindje interesa tradicionale si fuqi mbrojtëse katolike e vendeve të shenjta dhe si aleate qindrvajëçare e Perandorisë Osmane. Po ashtu, një faktor tjetër i qëndrimit pasiv që do të mbante Franca në këtë Kongres ishte edhe dobësia e saj ushtarak, që prej humbjes së saj në luftën me Gjermaninë në vitet 1870-1871.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në këtë Kongres, Italia, bëhej për herë të parë pjesë e vendimmarrjes politike europiane. Politika e ndjekur prej saj operonte ndërmjet patosit liberal të «Risorgimento-s» (Rilindjes), çka kishte të përbashkëta edhe me nacionalizmin e sllavëve të jugut dhe tentativave ekspansive kundrejt anës tjetër të Adriatikut, Shqipërisë. Madje, Kryetari i Dhomës së Deputetëve italianë, Francesco Crispi, i cili ishte me origjinë shqiptarë, jep një të dhënë për pretendimet italiane ndaj Shqipërisë dhe qëndrimin të Bismarck-ut për këtë problem. Sipas Crispi-t, Bismarck-u i tha atij në vitin 1877 se «...Nëse Austria anekson Bosnjën, atëherë edhe Italia duhet të aneksojë Shqipërinë ose ndonjë territor tjetër turk në detin Adriatik». Ndonëse kjo gjë është shkruar vetëm në kujtimet e Crispi-t, të cilat u botuan në vitin 1912 dhe mungojnë burimet e tjera për ta vërtetuar atë, nëse mbajmë parasysh politikën kompensuese që ndiqte Bismarck-u, mund të mendohet se një bisedë e tillë është zhvilluar.

Në këtë periudhë, në kuadër të politikës kontinentale, por edhe si pasojë e industrializimit, Rajhu gjerman nuk shfaqte prirje ekspansive jashtë kufijve të tij të vitit 1871. Në periudhën e krizës lindore, pra në vitet 1875-1878, Gjermania kishte në Ballkan pak interesa të drejtpërdrejta ekonomike, e aq më pak politike. Kështu që për këtë periudhë nuk mund të flitet për një politikë gjermane aktive përkundrejt Ballkanit. Gjithsesi Gjermania ishte e interesuar në ruajtjen e balancave. Ajo ishte sidomos e interesuar në ruajtjen dhe mos copëtimin e Perandorisë Osmane, sepse zbrazëtia që do të krijonte me rënien e saj do të plotësohej nga Rusia.

Megjithatë, pas luftës ruso-turke, në janar të vitit 1878, Perandoria Osmane u thye. Ushtria ruse ndodhej para Stambollit dhe flota angleze në ngushticën e Bosforit. Pra, duke mos e shpëtuar dot Perandorinë Osmane nga kapitullimi ushtarak, Anglia, Gjermania dhe Austria u munduan, por pa sukses, ta shpëtonin këtë Perandori të paktën nga shpërbërja politike.

Anglia dhe Austria iu përgjigjën Marrëveshjes së Shën Stefanit me një kërcënim serioz lufte ndaj Rusisë, sepse ata nuk mund të toleronin krijimin e një Bullgarie të Madhe, që shtrihej në Jug deri në detin Egje dhe në Perëndim deri në kufijtë e Shqipërisë.

Pavarësisht se, formalisht u parashikua që «Bullgaria e Madhe» do të ishte autonome dhe nën sukerenitetin e sulltanit, në të vërtetë, ajo përbënte majën e ajsbergut të ndikimit rus në Ballkan. Përveç kësaj, përfshirja e Maqedonisë së sotme në Bullgari do të ndante gjeografikisht Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën nga pjesa tjetër e Perandorisë Osmane, çka do të çonte automatikisht në ndarjen politike të këtyre vendeve nga kjo Perandori dhe sipas tyre, duke qenë se këto shtete do të ngeleshin të vogla, ato nuk mund të ishin në gjendje të siguronin ekzistencën e tyre.

Duke marrë shkas nga këto zhvillime, në datat 13 qershor – 13 korrik 1878, në Berlin u mbajt Kongresi i Berlinit. Në Kongres morën pjesë përfaqësuesit e Gjermanisë, Anglisë, Francës, Rusisë, Austrisë dhe Italisë. Po ashtu ishte i ftuar edhe një delegacion osman, i cili drejtohej nga Ministri i Jashtëm i Perandorisë, Kara Theodor Pasha. Gjithsesi, delegacioni i Perandorisë Osmane nuk kishte të drejta të barabarta me ato të Fuqive të Mëdha. Ai mund të diskutonte për çdo çështje të rendit të ditës, por nuk kishte të drejtë të votonte për vendimet e Kongresit. Gjithashtu, me ftesën e Fuqive të Mëdha u përfaqësuan në Kongres edhe Serbia, Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Mali i Zi. Ndonëse delegacionet e tyre kishin status vëzhgues, në seancat përkatëse atyre iu dha mundësia të mbrojnë kërkesat e tyre politike e territoriale.

Edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, i parashtrori Kongresit të Berlinit kërkesat e saj për t'i dhënë Shqipërisë disa të drejta autonome. Por Fuqitë e Mëdha, të mbledhura në Kongresin e Berlinit, nuk i morën parasysh këto kërkesa të shqiptarëve. Po ashtu, edhe një memorandum i hartuar nga atdhetarë shkodranë më 13 qershor, drejtuar Lordit Beaconsfield, ku në emër të kombit shqiptar kërkohej nga Fuqitë e Mëdha respektimi i tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe njohja e pavarësisë së saj të plotë, nuk u mor në konsideratë.

Madje, delegacioni shqiptar, i ngarkuar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, i cili shkoi në Berlin me nismën e vet për t'i parashtruar Kongresit të drejtat e Shqipërisë, nuk u përkrah nga askush. Kancelari gjerman Bismarck nuk pranoi të takohej me këta «malësorë turq» (Bergtürken), duke u shprehur se «nuk ka një komb shqiptar».

Megjithatë, në protokollet e mbajtura në gjithë seancat plenare (20 seanca 2-3-orëshe, të mbajtura pasditeve), nuk gjendet asnjë informacion i tillë. Po ashtu edhe shprehja, që mendohet se Bismarck-u ka thënë gjatë kësaj konference se «Shqipëria është një nocion gjeografik», nuk është e pasqyruar në protokollet e Kongresit. Ajo çka mund të vërtetohet është se Bismarck-u, gjatë mbajtjes së Kongresit, në cep të një letre që Cari i Rusisë i dërgonte atij nëpërmjet ministrit të tij të jashtëm Gorchakov, ku i kërkonte mbështetjen e politikave ruse, shkroi në tri gjuhët që ai zotëronte: «Who is Europe?», «Qui parle Europe a tort – notion géographique», «Redensart». Nëse jemi të prirë të besojmë këtë burim të panjohur nga historiografia jonë deri tani, Bismarck-u mendonte se Evropa ishte një nocion

gjeografik, një mënyrë të shprehuri. Parë në këtë këndvështrim, mundësia që Bismarck të krahasonte Europën me Shqipërinë është shumë e pamundur.

Madje, në asnjë çast, gjatë Kongresit, Bismarck-u nuk e ka përmendur me emër Shqipërinë. Si pasojë, çështja shqiptare nuk u përfill fare si çështje më vete nga Kongresi i Berlinit. Fuqitë e Mëdha morën përsipër të hartonin në Kongresin e Berlinit një hartë të re politike të Ballkanit, por siç u theksua edhe më lart, politika kompensuese mbizotëronte frymën vendimmarrëse dhe nuk u morën parasysh kërkesat e popujve të vegjël.

Kongresi u zhvillua nën një presion të dukshëm kohor që kancelari Bismarck ushtronte ndaj delegatëve të këtij Kongresi. Bismarck-u kishte menduar se Kongresi do të mjaftohej me disa seanca dhe duke qenë se ishte bërë gati për t'u nisur në llixha në Bad Kissingen (Bad Kisingen, qytet në Landin e Bavarisë), ai shfaqej tepër i paduruar. Madje ndaj delegacionit turk Bismarck-u u soll agresiv dhe arrogant. Ndërmjet seancës së tretë dhe të katërt, Kongresi rrezikoi të dështonte. Kështu që Bismarck-ut i duhej të negocionte me të gjitha palët në mënyrë të veçantë. Bismarck-u shkoi në takim me delegacionin turk i veshur me uniformë dhe me helm të në kokë, çka me të drejtë krijoi te delegacioni turk idenë e një takimi zyrtar të një rëndësie të veçantë, por në të njëjtën kohë edhe po kaq kërcënues. Për këtë gjë, ambasadori gjerman në Paris, Hohenlohe, e kritikoi hapur Bismarck-un për ngutjen e tij. Po ashtu edhe përfaqësuesi i Rusisë Peter Shuvalov e kundërshtoi ritmin e shpejtë të punimeve. Duke mos i marrë parasysh ankesat e kësaj natyre, Bismarck-u iu përgjigj kritikave se: "An Arbeit ist noch niemand gestorben" (ende nuk ka vdekur njeri nga puna).

Kjo sjellje do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në fatin e popullit shqiptar. Madje, Ambasadori Hohenlohe me të drejtë do të shkruante në kujtimet e tij: "Kjo mungesë durimi e kancelarit, të cilën e përligjte gjendja e tij jo e mirë shëndetësore, i cyt punimet të ecin me shpejtësi më tej. Por, më vonë, do të ketë pasoja. Disa çështje po trajtohen vetëm në mënyrë sipërfaqësore. Unë do të preferoja një punë me ritëm më të ngadaltë". Ky ishte një parashikim më se i saktë. Vendimet e Kongresit të Berlinit i cenuan rëndë interesat e popullit shqiptar dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë. Ashtu si Traktati i Shën-Stefanit, edhe ai nuk e pa Shqipërinë si një njësi politike të veçantë, por e trajtoi si një mjet kompensimi ndaj interesave të Fuqive të Mëdha dhe fqinjëve ballkanikë. Traktati i Berlinit nuk i njohu Shqipërisë asnjë të drejtë kombëtare, madje nuk e zinte fare në gojë emrin e saj. Ai nuk e respektoi as tërësinë e saj territoriale. Malit të Zi, përveç trojeve me popullsi të përzier shqiptare e sllave, iu dhanë përsëri disa vise shqiptare (krahinat e Plavës, të Gucisë e të Rugovës), sikundër edhe Serbisë (krahinat e Vranjës, të Trenit e të Pirotit). Bullgarisë nuk iu njohën viset e Shqipërisë Lindore, por, nga ana tjetër, iu dhanë Greqisë (e cila nuk përfitonte asgjë nga Traktati i Shën-Stefanit), viset e Çamërisë.

Midis vendimeve të tjera që mori Kongresi i Berlinit, dy prej tyre preknin, njëri tërthorazi e tjetri drejtpërdrejt, dy çështje që kishin lidhje me aspektin politik të trojeve shqiptare, që do të mbeteshin nën sundimin e Perandorisë Osmane.

E para trajtohej në nenin 23 të traktatit. Sipas këtij neni, Porta e Lartë detyrohej të hartonte për viset ballkanike (në original shkruhet Perandoria Osmane evropiane) që ndodheshin nën sundimin e saj të plotë, "rregullore organike" për një administrim autonom të vilajeteve, pak a shumë të njëjlojtë me atë që i ishte dhënë ishullit të Kretës më 1868. Me qëllim që këto «rregullore» t'u përshtateshin nevojave të vendit, Porta duhej të ngarkonte «komisione të posaçme» për hartimin e tyre, në të cilat "elementi vendas duhej të përfaqësohej në shkallë të gjerë". Projektet që do të hartoheshin për çdo vilajet, thuhej në po këtë nen, para se të hynin në fuqi, do të miratoheshin edhe nga Komisioni Evropian që u krijua nga Fuqitë e Mëdha për Rumelinë Lindore.

Problemi i dytë për Shqipërinë paraqitej në Protokollin Nr.13 të kongresit, në seancën e datës 5 korrik dhe kishte lidhje me venomet e Mirditës. Fillimisht çështja u ngrit nga përfaqësuesit e Francës dhe të Austro-Hungarisë. Këta kërkuan nga Porta e Lartë që ajo t'i respektonte edhe në të ardhmen "privilegjet dhe imunitetet" (venomet), të cilat "popullsia e Mirditës i gëzon ab antiquo".

Mehmet Ali Pasha e kundërshtoi këtë propozim, sepse respektimi i venomeve në këtë krahinë binte në kundërshtim me nenin 23, i cili e detyronte atë të zbatonte reforma administrative në vilajetet e Turqisë Evropiane. Megjithatë ai shtoi se Porta e Lartë nuk kishte ndërmend të zbatonte reformat e saj në krahinën e Mirditës. Fuqitë e Mëdha mbetën të kënaqura nga deklarata e përfaqësuesit turk, e cila u përfshi në Protokollin Nr.13, duke marrë kështu vlerën e një zotimi zyrtar.

Nëpërmjet Nenit 23 të kongresit, Shqipëria u cenua rëndë, sepse trojet shqiptare u destinuan të qëndronin përsëri të ndara administrativisht në katër vilajete. Reformat administrative autonomiste i kërkonin edhe vetë qarqet përparimtare rilindëse, por ato i kushtëzonin këto reforma me bashkimin e trojeve shqiptare në një vilajet të vetëm autonom. Për më tepër, e drejta që fituan me nenin 23 Fuqitë e Mëdha për të ndërhyrë në këtë çështje, u dha atyre mundësinë, siç shkruante pak më vonë Abdyl Frashëri, që t'u jepnin reformave në vilajetin e Kosovës, bullgar në atë të Manastirit dhe grek në vilajetin e Janinës, karakter joshqiptar, por serb. Si rrjedhim, me zbatimin e këtij neni rritej më tepër në të ardhmen rreziku i aneksimit të trojeve shqiptare nga shtetet fqinje ballkanike dhe vështirësohej më shumë lufta e shqiptarëve për bashkimin e këtyre trojeve në një vilajet të vetëm autonom.

Po ashtu, me Protokollin nr. 13 çështja kombëtare shqiptare u reduktua në një problem të popullsisë katolike krahinore. Ky vendim i hapte rrugë politikës së Vjenës, e cila gëzonte prej kohësh të drejtën e mbrojtjes së popullsisë katolike të Perandorisë Osmane. Në politikën e «depërtimit paqësor» që ajo ndiqte, një rol të madh luante «Kultusprotektorati», ndonëse e drejta e mbrojtjes së kultit dhe kishës së krishterë në Perandorinë Osmane, politikisht dhe juridikisht i përkiste Francës që nga koha e kapitulacioneve të vitit 1535.

Lufta që ndryshoi hartën e botës

Më 28 qershor 1914, trashëgimtari i fronit të Perandorisë Austro-Hungareze, Arkiduka Franc Ferdinandi, dhe bashkëshortja e tij, Sofia, u vranë në një atentat, gjatë vizitës që po kryenin në Sarajevë, kryeqyteti i Bosnje -Hercegovinës.

Vrasësit ishin pjesëtarë të një organizate sekrete serbe. Tensionet pasuese diplomatike midis Austro-Hungarisë dhe mbretërisë së Serbisë u përshkallëzuan, derisa mes tyre shpërtheu lufta. Aleancat e ndryshme tërhoqën shpejt në luftë Rusinë, Gjermaninë, Francën, Britaninë dhe perandoritë e tyre në konflikt.

Tridhjetë e shtatë ditë pas vrasjes, kishte filluar Lufta e Parë Botërore. Deri në fundin e saj, ajo do të shkaktonte 39 milionë të vdekur nga të dyja kampet. Por Lufta e Madhe, mund të ketë ndodhur vetëm për shkak të një gënjeshtre.

Lufta e Parë Botërore filloi në thelb kur Austria i shpalli luftë Serbisë. Kjo nxiti aktivizimin e një sërë traktatesh të nënshkuara më herët si premtime të bëra vite më parë nga fuqitë evropiane, që i detyronin ato t'i vinin në ndihmë njëra-tjetrës.

Sigurisht, ironia është se këto traktate ishin hartuar me synim

dekurajimin e fuqive evropiane për të hyrë në luftë kundër njëra-tjetrës, një lloj Shkatërrimi i Sigurt Reciprok (MAD) i epokës para-bërthamore.

Arsyeja madhore e Austrisë për të hyrë në luftë me Serbinë, ishte vrasja e Arkidukës Ferdinand. Njeriu që qëllloi mbi të ishte Gavrilo Princip, një anëtar i "Dorës së zezë", një shoqëri sekrete e nacionalistëve ushtarakë serbë. Ajo synonte shpëputjen e të gjitha vendeve sllave nga Perandoria Austro-Hungareze.

Pas vrasjes, Austria lëshoi një ultimatum ndaj Serbisë, duke kërkuar që qeveria serbe të denonconte dhe asgjësonte të gjitha grupimet terroriste nacionaliste në territorin e saj. Serbia nuk u pajtua me atë ultimatum, ndaj Austro-Hungaria i shpalli luftë.

Sipas historianit Tim Baçer, kjo është gënjeshtra që shtrihet në zemër të "luftës që do t'i jepte fund të gjitha luftërave". Ai argumenton se Austria i manipuloi faktet, për të krijuar një pretekst për të pushtuar Serbinë. Gavrilo Princip ishte në fakt boshnjak, dhe për këtë arsye një qytetar i Perandorisë Habsburgase.

Familja e tij kishte rrënjë serbe, por nuk kishte jetuar atje prej qindra vjetësh. Është e vërtetë se ai u zhvendos në Serbi, ku dhe





u radikalizua. Por urrejtja e tij ndaj Austrisë, u rrit kur Perandoria aneksoi në mënyrë të paligjshme Bosnje-Hercegovinën më 1908. Perandoria e zhvendosi vëmendjen nga Princi, tek njeriu që e trajnonte dhe e furnizonte atë: Majori Vojislav Tankosiç, një oficer në ushtrinë serbe, dhe një anëtar themelues i “Dorës së Zezë”. Nëpërmjet tij, zyrtarët në Vjenë mund të fajësonin inteligjencën ushtarake dhe mbretërinë serbe për vrasjen.

Në fakt, Serbia i druhej Austrisë, dhe Major Tankosiç shkeli politikën serbe, kur formoi “Dorën e Zezë”. Për më tepër, ambasadori serb e kishte paralajmëruar ministrin austriak të Financave se Arkuduka Franc Ferdinandi mund të vritej në Sarajevë.

Austro-Hungarezët e shpërfillën këtë fakt, kur dorëzuan ultimatumin e tyre në korrik 1914. Kjo për shkak se ultimatum i u hartua në një mënyrë të tillë që të refuzohej. Ministri i Jashtëm, Konti Leopold Bertold, sipas fjalëve të tij, bëri “kërkesa të papranueshme” në ultimatum.

Në listën e kërkesave, ai kërkoi që Serbia të shkatërronte menjëherë të gjitha lëvizjet propagandistike anti-austriake, të shpërndante të gjitha organizatat nacionaliste serbe, dhe të arrestonte të gjithë ata që ishin të përfshirë në vrasje në territorin serb, duke lejuar austriakët të merrnin pjesë në hetimin dhe gjykimin e kësaj çështje. Për habinë e Bertoldit, Serbia i pranoi të gjitha kërkesat me përjashtim të të fundit.

Austria u inkurajua nga aleatja e saj, Gjermania. Britania u përpoq të organizonte një konferencë ndërkombëtare për të parandaluar një luftë botërore, por Gjermania e refuzoi.

Ajo i premtoi Austrisë një mbështetjeje të gjerë ushtarake. Madje Ministria e Jashtme gjermane, e mbajti Kajzerin Vilhelm II jashtë vendit gjatë gjithë krizës, në mënyrë që ai të mos kishte mundësi të “ndërhynte me idetë e tij pacifiste”. Vrasja e Franc Ferdinandit, thjesht i dha Austrisë justifikimin që i duhej.

Perandoria e Habsburgëve donte të zgjerohej në Ballkan, dhe

Serbia ishte rivalja e saj më e madhe në rajon. Qeveria austriake, ishte në gjendje të shfrytëzonte një sulm të tmerrshëm nga një grup i vogël ekstremistësh për të justifikuar ambiciet e saj imperialiste, në emër të mbrojtjes nga terroristët.

Mjerisht, shumë gënjeshtra të tjera u thanë nga çdo komb. Kjo është natyra e propagandës, e cila arriti ekstreme të reja gjatë Luftës së Parë Botërore.

Britania, i mblodhi “baronët” e saj të mediave për të udhëhequr ministrinë e re të Informacionit. Përveç censurimit të lajmit të keq për dështimet ushtarake të Britanisë në frontin e luftës, ajo përhapi histori se gjermanët kryenin masakra, përdhunonin dhe gjymtonin gra dhe fëmijë.

Hetimet gjatë dhe pas luftës, nuk gjetën prova që t’i mbështesin këto pretendime. Kur një nëndetëse gjermane mbyti anijen “Lusitania” dhe vrau 1200 civilë, kjo u paraqit si një krim lufte.

Por SHBA-ja dhe Britania e fshehën faktin se ajo anije transportonte në fakt armatime, dhe Gjermania kishte paralajmëruar se ishte një objektiv i luftës.

Sikurse shkroi gazetari i luftës Filip Najtëll: “I gjithë aparati i shtetit, hyri në veprim për të shtypur të vërtetën”. Në vitin 1917, presidenti Udrrou Uillson tha se Amerika duhej t’i bashkohej luftës, për t’i dhënë fund tiranisë, dhe për të ruajtur demokracinë. Në vitin 1919 ai tha: “A ka ndonjë fëmijë që nuk e di se fara e luftës në botën moderne, është rivaliteti industrial dhe tregtar? Kjo është një luftë industriale dhe komerciale”.

Kjo është arsyeja, se përse lufta u përshkallëzua aq shpejt. Perandoritë e ndryshme të përfshira në të, ishin kaq konkurruese, sa që do të shfrytëzonin çdo mundësi që u jepej për të rrëmbyer territorin, dhe për të dobësuar njëra-tjetrën.

Ata nuk prisnin që lufta t’i dobësonte të gjithë deri në atë përmasë, sa që do t’i hapte rrugën Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për t’u bërë fuqia hegjemone në botë – dhe të hidhnin themelet për një Luftë të Dytë Botërore. Edhe atëherë, lufta mund të ishte shmangur.

Austro-Hungaria shpërfilli paralajmërimin për rrezikun që i kanosej Arkidukës në Sarajevë. Ajo fajësoi me dashje qeverinë serbe për veprimet e një grupi të fshehtë terrorist, vrasësi i të cilës ishte lindur në Perandorinë e tyre.

Ata manipuluan të vërtetën për të justifikuar luftën me rivalen e tyre. Të gjitha fuqitë kryesore, e fshehën të vërtetën, për të inkurajuar miliona njerëz të zakonshëm të luftonin dhe vdisnin. Fuqia shtytëse pas Luftës së Parë Botërore, ishte një seri e pafundme gënjeshtrash.



Në mes të Venecias mbi 5 shekuj jetësohet shkolla e gjuhës shqipe

Në qytetin e bukur të Venedikut (Venezia) në Itali u vendosën fisi ilir i Venetëve, rreth vitit 1200 para Krishtit, ku pas disa vitesh u hap dhe një shkollë shqipe (Scuola Albanesi) në kuptimin e një vëllazërie laike kushtuar punëve bamirëse në Venedik në vitin 1479, nga refugjatët shqiptarë të larguar nga turqit pas rënies së Shkodrës.

Madje, veneciaku i famshëm, artisti Viktor Karpaçi (Vittore Carpaccio), u mbajt për të pikturuar dekorimet e ndërtesës së tyre.

Ndonëse ndërtesa e shkollës, tashmë e pashënuar, ekziston ende si një godinë banimi, ajo ruan ende skulpturën e saj basoreliev mbi hyrjen e përparme që përkujton pushtimet turke të Shkodrës në vitet 1474 dhe 1479.

Piktorë të dalluar që dolën nga ai komunitet shqiptar i Venedikut ishin Mark Bazaiti dhe Francesco Albani.

“Scuola di Santa Maria degli Albanesi” ishte themeluar në vitin 1442 për të mirën e veçantë të komunitetit shqiptar. Pas rënies së Shkodrës nga turqit në 1479, një numër refugjatësh u larguan në Venecia, ku morën ndihmë nga Signoria (Qeveria e Republikës së Venedikut). Në vitin 1497 grupi vendosi të ndërtonte një shtëpi mbledhjesh pranë kishës së San Maurizio, duke vërejtur se



“madje edhe armenët kanë bujtinën e tyre dhe ne nuk kemi asnjë”. Kur bëhej fjalë për dekorimin e ndërtesës, Carpaccio ishte artisti i zgjedhur. Gjashtë skenat e tij nga Jeta e Virgjëreshës tregojnë, megjithatë, se porositë e tjera mund të kenë pasur prioritet në vëmendjen e tij.

Pikturat për shqiptarët janë të një cilësie të ulët në krahasim me

ato të Scuola di San Giorgi dhe me siguri janë realizuar në një masë të madhe nga punishtja e tij.



Rrethimi i Shkodrës, memoriali në Venecia nga Viktor Karpaçi

Një dokument i vitit 1503 vuri në dukje se shumica e anëtarëve ishin artizanë dhe marinarë, duke treguar se burimet financiare të Scuola-s ishin shumë të pakta.

Carpaccio duhet të ketë qenë në kulmin e famës së tij, gjatë viteve në të cilat ai pikturoi për dalmatët dhe shqiptarët.

Shkolla Arbërore në fillimet e saj i ishte kushtuar “Zojës së Këshillit të Mirë”, e quajtur edhe “Nostra Signora di Scutari”, si dhe Shën Galit.

Që në vitin 1447 selia e shkollës u transferua në famullinë San Maurizio, në zonën e Shën Markut, pjesë e qendrës së qytetit.

Godina e shkollës, që sot konsiderohet ndër atraksionet turistike të Venedikut, ishte ngritur midis kishës së Shën Mauricit dhe kambanarit, gjë që mund të vërehet fare lehtë edhe sot.

Ajo kishte një ballinë të ngushtë me proporcion shumë të thellë, e cila mbështetej drejtpërdrejt me kishën e Shën Mauricit.

Ballina e Shkollës, duke qenë në një linjë me kishën, shikonte sheshin Piovan.

Në mes të godinës, është gjendur oborri piktoresk bashkë me një pus në qendër dhe me një galeri druri, e cila rrethonte oborrin në tërësi me hardhi. Nga oborri kishte tri dalje për në shesh. Shkolla zinte pjesën e pasme të godinës së gjatë.

Në katin përdhes është gjendur i ashtuquajti “Albergo da basso” (Bujtina e poshtme), ku është vendosur një altar guri pak i ndriçuar, gjë që dëshmohej edhe nga radhonytë e Statutit ose Amzës së shkollës.

Kur është fjala për Statutin, respektivisht Amzën e bashkë-

vëllazërisë arbërore, është ruajtur vetëm kopja nga viti 1750, e cila sot ruhet në Arkivin Shtetëror të Venedikut dhe në “Biblioteca Nazionale Maraciana”.

Shkolla Arbërore ishte aktive deri në 1780, bashkë-vëllazëria shpërndahet në këtë vit dhe ndërtesa kalon në duart e korporatës “Dei Pistori”.

Shumë orendi dhe pajisje të brendshme me vlera të mëdha do të shiteshin apo do të humbnin. Në sallën e Shkollës edhe më tej do të ruhen 43 piktura. Gjashtë prej tyre janë të Karpaçit.

Elena Lucrezia Peshkopia është e para grua në botë që në vitin 1678 ka arritur të marrë doktoraturën në Filozofi. Gjatë shekullit ku jetoi ajo ishte grua më e ditur në Evropë.

Statuja e Elenës që u gjet në Universitetin e Padovës, një nga universitetit më të vjetër dhe më të njohurit në Evropë, dëshmon për vlerat e arritjeve të jetës së saj.

Elena Peshkopia lindi në Venecia në vitin 1646. Ajo përfundoi shkollën e shqiptarëve “Santa Maria dhe San Gallo”, në Venecia (Scuola di Santa Maria e di San Gallo degli Albanesi). Shkolla ku Elena mësoi është themeluar nga fisnikët e edukuar shqiptarë, më 22 tetor 1442, dhe për rreth 200 vite vazhdoi të funksionojë për arsimimin e shqiptarëve deri në fund të shekullit të 18-të.

Që prej fillimit, djemtë dhe vajzat e frekuentonin këtë shkollë së



bashku, institucioni financohej nga taksat që paguanin shqiptarët. Elena, e talentuar edhe në muzikë, vazhdoi studimet në Filozofi dhe Astronomi, duke ndjekur edhe programin e doktoraturës në Universitetin Padovës.

Ajo mbrojti teoritë e saj të doktoraturës, më 25 qershor 1678. Ajo u bë lektore në Matematikë në Universitetin e Padovës, ku qëndroi deri në fund të jetës së saj të shkurtër.

Elena Peshkopia ndërroi jetë nga tuberkulozi, më 26 korrik të vitit 1684, në moshë shumë të re, vetëm 38 vjeçare. Ajo prehet në kishën e “Shën Lukës”, në Padova të Italisë.

REVISTA MBROJTJA



[http://www.mbrojtja.gov.al/
index.php/publikime/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)